



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Kuvendi i Komunës
Nr. 001/060- 59340
Më: 20 maj 2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 43 të Ligjit Nr. 04/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 30 paragrafit 1 dhe nenit 35 paragrafit 2, të Statutit të Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643, dt. 15 tetor 2008, thërres mbledhjen e V/2026 (e pestë) të rregullt të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, e cila do të mbahet më: **02 qershor 2026 (e martë)**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, në “Shtëpinë e Bardhë”, me fillim në **ora 10:00**.

Prandaj, ftoheni që në cilësinë e anëtarit të Kuvendit të Komunës, të merrni pjesë në punën e kësaj mbledhjeje, duke ju përmbajtur orës, datës dhe vendit të caktuar.

Për punën e kësaj mbledhjeje, propozoj këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së rregullt të datës 30 mars 2026;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për subvencionimin e transportit urban;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Prizrenit;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-planit komunal për ri integrim të qëndrueshëm të personave të riadhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Prizrenit 2026-2028;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e grupit punues për hartimin e Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit;
8. Informatë mbi gjendjen e barazisë gjinore dhe realizimin e objektivave të strategjisë komunale për Barazi Gjinore 2024–2026 në Komunën e Prizrenit.



Kryesuesi i Kuvendit
Safir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Skupština Opštine Prizren

Br. 001/060- 59340

Dana: 20 maj 2026

Na osnovu člana 43 Zakona br. 04/L-040 o Lokalnoj Samoupravi, člana 30 stav 1 i člana 35 stav 2, Statuta opštine Prizren, br. 01/011-5643, dt. 15 oktobra 2008 godine, sazivam V/2026 (petu) redovnu sednicu Skupštine opštine Prizren, koja će se održati **02 juna 2026 (Utorak)**, u sali za sastanke Skupštine opštine Prizren , u "Beloj Kući", sa početkom od **10:00 časova**.

Stoga ste pozvani da u svojstvu odbornika Skupštine opštine učestvujete u radu ove sednice pridržavajući se predviđenog vremena, datuma i mjesta.

Za rad ove sednice predlažem sljedeći:

DNEVNI RED

1. Razmatranje i usvajanje zapisnika sa redovne sjednice od dana 30 marta 2026;
2. Razmatranje i usvajanje dnevnog reda;
3. Pitanja odbornika;
4. Razmatranje i usvajanje predlog-odluke za subvencionisanje urbanog transporta;
5. Razmatranje i usvajanje nacrtu Pravilnika za menadiranje otpada u Opštini Prizren;
6. Razmatranje i usvajanje opštinskog projekt-plana za održivu reintegraciju repatriраних osoba i integraciju stranaca u opštini Prizren 2026-2028;
7. Razmatranje i usvajanje predlog-odluke za formiranje radne grupe za izradu Pravilnika o Radu Skupštine opštine Prizren;
8. Informacije o stanju rodne ravnopravnosti i ostvarivanju ciljeva Opštinske strategije za rodnu ravnopravnost 2024–2026 u opštini Prizren;



Predsedavajući Skupštine
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Belediye Meclisi

No. 001/060- 59340

Tarih: 20 Mayıs 2026

Yerel Özyönetim Kanun'un 43.maddesi, 15 Ekim 2008 tarihli ve 01/011-5643 sayılı Prizren Belediye Tüzüğü'nün 30. Maddesi, 1. Fıkrası, 35. Maddesi, 2. Fıkrası gereğince **02 Haziran 2024 tarihinde (Salı) saat 10.00'dan** başlayarak "**Beyaz Evde**" Prizren Belediye Meclisi oturum salonunda düzenlenecek olan Prizren Belediye Meclisin V./2026 (beşinci) düzenli oturumunu çağırıyorum. Belediye Meclisi üyesi niteliğinde işbu oturum çalışmalarını için belirtilen saat, tarih ve yerde katılmanız üzere davetlisiniz:

İşbu toplantı için şu gündem noktaları belirlenmiştir:

GÜNDEM

1. 30 Mart 2026 tarihli SMK düzenli toplantı tutanağının görüşülmesi ve onaylanması;
2. Gündemin görüşülmesi ve onaylanması;
3. Meclis üyelerin soruları ve çeşitli konuların dile getirilmesi;
4. Kentsel ulaşımın sübvansiyonuna ilişkin öneri-kararın görüşülmesi ve onaylanması;
5. Prizren Belediyesinde atık yönetimi için taslak – Yönetmeliğin görüşülmesi ve onaylanması;
6. 2026-2028 dönemine ilişkin Prizren Belediyesi'nde Geri Dönen Kişilerin Sürdürülebilir Yeniden Entegrasyonu ve Yabancıların Entegrasyonu için Belediye Taslak – Planın görüşülmesi ve onaylanması;
7. Prizren Belediye Meclisin Çalışma Yönetmeliğinin tasarlanması için çalışma grubun oluşturulmasına ilişkin öneri – kararın görüşülmesi ve onaylanması;
8. Prizren Belediyesinde 2024-2026 yılı Cinsiyet Eşitliği ile ilgili Belediye Stratejisinin hedeflerinin gerçekleştirilmesi ve cinsiyet eşitliği durumu hakkında bilgi;



Meclis Başkanı
Simir Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tretë e Rregullt e Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Datë: 30 mars 2026.

Filloi në ora: 10:00.

Vendi: Salla për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në “Shtëpinë e Bardhë” - Prizren.

Në mbledhje morën pjesë këta anëtarë të Kuvendit të Komunës: Simir Krasniqi – Kryesues, Adem Shabanaj, Adrit Krasniqi, Agnesa Sinanaj Gavazaj, Alban Bislimaj, Albulena Balaj Halimaj, Arianit Berisha, Astrit Temaj, Dafina Alishani, Daut Panikaj, Dea Gavazaj, Driton Sallauka, Dzengis Saliji, Eldis Abazi, Endrit Zogaj, Haziz Hodaj, Ilir Gashi, Karanfil Haxhillari, Liridona Veçgishti, Mergiton Gavazaj, Mimoza Memaj, Nazife Kokollari, Nerimane Pllana Gashi, Onur Kovaçi, Petrit Hoxhaj, Qemal Krasniqi, Sefidin Islamaj, Selman Sokolaj, Sevil Kazazi, Sevilay Igci Hapçi, Shqipe Shatri Çoçaj, Shukri Quni, Tefik Tarashaj, Trëndelina Kastrati, Ymran Fusha, Zgjim Kryeziu, Zikreta Aliti.

Mungoi: Agim Muqaj, Drita Qenaj, Sulltan Badalli.

Pjesëmarrës të tjerë ishin: Nënkryetari i Komunës z.Bexhat Bytyqi, Nënkryetari i Komunës për Komunitete z. Furkan Bütüçi, drejtorët e Drejtorive komunale, zyrtarë komunal, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe përfaqësues të medimeve.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Simir Krasniqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, ku dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Jemi gati mund të fillojmë. Përshëndetje të nderuar anëtarë të kuvendit. I nderuar nënkryetar zoti Bexhat Bytyqi, i nderuar nënkryetar për komunitete zoti Furkan Bytyqi, të nderuar drejtorë të ekzekutivit, përfaqësues të mediave, shoqërisë civile dhe ju të pranishëm. Përshëndetje për të gjithë. I urojmë edhe drejtorit të ri të pronës marrjen e detyrës, i urojmë shëndet dhe suksese në punë. Për sot pra është thirrur mbledhja e tretë e rregullt e kuvendit të komunës. Konfirmoj se të pranishëm jemi 33 anëtarë të kuvendit. Konstatojmë se kemi kuorumin për të zhvilluar punët e kësaj mbledhje. Para se të filloj me rendin e ditës në këtë seancë, dua t'ju informoj se një anëtar i Kuvendit ka dhënë dorëheqjen nga anëtar i Kuvendit, Komisioni Qendror i zgjedhjeve KQZ-ja ka marrë vendim për zëvendësimin e tij. Konsideroj që anëtari i ri është prezent në sallë dhe pa humbur kohë do ta lexoj vendimin e KQZ-së dhe pastaj ftoj anëtarin e ri që të bëj betimin solemn para anëtarëve të Kuvendit. Në bazë të vendimit të KQZ-së me numër 01/352-2026 të datës 03.03.2026 për emërimin e anëtarit të Kuvendit Komunal zoti Onur Kovaçi emërohet anëtar i Kuvendit Komunal nga Partia Turke KDTP-ja duke e zëvendësuar zotin Furkan Bytyç. Ftoj anëtarin e ri të kuvendit të ngrihet në këmbë për dhënien e betimit. Betimi lexohet pjesë-pjesë nga unë kryesuesi i kuvendit dhe përsëritet nga ju. Ose betimin mund ta jepni në gjuhën zyrtare të komunës. Fjala për ju.

Onur Kovac: Faleminderit kryesues. Ben Onur Kovaç, Prizren Belediye Meclis üyesi olarak herkes için sakin yaşam koşulları sağlamak amacıyla yetki ve görevlerimi onurlu, sadakatli, tarafsız, vicdanlı ve hukuka uygun olarak yerine getireceğime ant içerim (veya beyan ederim)”.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Kërkojmë nga anëtari e kuvendit që pas dhënies së betimit ta nënshkruaj deklaratën e betimit. Urime dhe suksese. Ju priftë e mbara. Po ashtu në këtë seancë kemi edhe një emërim, pasi që kërkohet me ligjin për vetëqeverisje lokale, lidhur me zëvendëskryesuesin e kuvendit për komunitete. Paraprakisht po lexoj dispozitën e ligjit dhe më pastaj deklarojmë konstatimin sipas vendimit të KQZ-së. Sipas ligjit për vetëqeverisje lokale, neni 54, zëvendëskryesuesi i komuniteteve, neni 54.1, në komunat ku së paku 10% e qytetarëve i takojnë komuniteteve jo shumicë, posti i zëvendëskryesuesit të kuvendit të komunës për komunitete rezervohet për përfaqësuesin e këtyre komuniteteve. Neni 54.2 postin e zëvendëskryesuesit për komunitetet e komunës e mban kandidati përfaqësues i popullatës jo shumicë që ka marrë më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhjen në kuvendin e komunës. Sipas vendimit të KQZ-së të datës 21.11.2025 me numër të protokollit 01/3376-2025 sipas vendimit të KQZ-së disa prej anëtarëve të kuvendit nga komuniteti jo shumicë anëtari i radhës i kuvendit që ka më së shumti vota në listën e hapur konstatohet që është zonja Sevil Kazaz, zëvendës kryesuese e kuvendit të komunës për komunitete, urime dhe suksese. Ftoj zonjën Sevil Kazaz për një fjalë rasti dhe të ulet në ulësen e zëvendës kryesueses. Fjala për ju, zonja Sevil.

Sevil Kazazi: Teşekkür ederim Sayın Meclis Başkanı, değerli müdürler, meclis üyeleri, medya mensubları, tüm katılımcılar, hepinizi saygıyla selamlıyorum. Bugün Yenilikçi Türk Hareket Partisi Prizren Belediyesi meclis üyesi olarak yeni bir göreve başlamış bulunuyoruz. Bildiğiniz üzere meclis başkanımızın da söylediğini söylediği gibi yerel yönetim yasası gereği bu görev topluluklara aittir ve bugün de Prizren Belediyesi'nde bir Türk temsilcisi olarak bu görevi üstlenmekte gurur duymaktayım. Daha büyük bir sorumluluk gerektiren bir görev ve bu

sorumluluk bilinciyle buradaki meclis calismalarima devam edeceğimi sizlere bildirmekten memnuniyet duyuyorum. Tesekkür ediyorum, faleminderit, falla.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fillojmë me pikat e rendit të ditës që janë përgatitur për ditën e sotme, të cilat pikat e rendit të ditës janë shqyrtuar dhe rekomanduar nga Komiteti për Politikë dhe Financa për seancën e rregullt për këtë mbledhje.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme të datës 23 janar 2026 dhe mbledhjes solemne të datës 17 shkurt 2026;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Rendit të Ditës;
3. Pyetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin dhe përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi të Komunës së Prizrenit;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për Shoqatën “Zona e Pashtrikut”;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e komisionit dhe emërimin e anëtarëve të komisionit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në Komunën e Prizrenit;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit nr.001/011-60689, të datës 02 korrik 2020 për mënyrën e pagesës së taksës administrative për leje ndërtimore, leje rrërimi dhe tarifa për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.001/011-68302, të datës 29.05.2025;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përgjedhjen e këshillave lokale;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për emërimin e komisionit të ankesave për procesin e zgjedhjes së këshillat lokale;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për caktimin e tarifës për shërbimin e varrimit (Varrezat e reja të Prizrenit në Landovicë). - *Shtesë*

Në këtë seancë kemi një pikë shtesë që është shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, ku nga KPF-ja është dhënë rekomandimi që kjo pikë duhet të shqyrtohet dhe miratohet nga kuvendi në këtë mbledhje dhe kjo është pika, shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për caktimin e tarifës për shërbimin e varrimit, varrezat e reja të Prizrenit në Landovic. Materialet për këtë pikë i keni pranuar përmes e-mailit së bashku me rekomandimet e komitetit për politikë dhe financa.

Kalojmë pra tek procesverbalet.

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së jashtëzakonshme të datës 23 janar 2026 dhe mbledhjes solemne të datës 17 shkurt 2026.

Simir Krasniqi (Kryesues): Paraprakisht kisha kërkuar nga anëtari i kuvendit që sapo dha betimin, edhe pse tash ka të drejtë vote të mos votojë fare për procesverbalet. Meqë nuk ka qenë anëtar i kuvendit kur janë mbajtur këto dy mbledhje. Po ashtu, dua ta sqaroj se ende nuk i kemi pranuar fjalimet e anëtarëve të komitetit komunitetit boshnjak nga zyra e përkthimeve. Në momentin që i pranojmë ato fjalimet do t'ia bashkëngjesim procesverbaleve. Kemi ndonjë vërejtje

apo sugjerim rreth procesverbaleve? Atëherë që nuk kemi e hedhim në votim. Konstatojmë se 34 anëtarë të kuvendit janë prezent. Kush është për? 33 janë për. Kundër? 0 Abstenim? 0. Atëherë miratohen procesverbalet.

Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ashtu siç e sqarova më herët, kemi një propozim shtesë për sot. Për shkak të rëndësisë urgjente që ka kjo pikë e rendit të ditës, të cilën na sqaruan zyrtarët nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, ky propozim paraprakisht do të do të kalojë në votim që të hyjë si pikë shtesë në rend të ditës në mbledhjen e sotme. A kemi ndonjë propozim tjetër apo do ta merr fjalën dikush? Po, Dafina, fjala për ju.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesues. Në komitet për politikë dhe financat tek pika e çështjeve të varrezës e kemi kërkuar dokumentet shtesë dhe ju na keni bashkangjitur vetëm propozim-vendimin dhe kërkesën e operatorit ekonomik. Ndërkohë meqë ka një kohë e gjatë ku është bërë partneriteti publiko-privat, kontrata apo kushte të cilat duhet me i plotësuar komuna ndaj operatorit ekonomik, fatkeqësisht nuk ka mundur me i gjetur as në web-faqe. Edhe në komitet për politikë dhe financa është cekur që edhe kontrata do të dërgohet. Du me ditë arsyen pse nuk është bashkangjitur dokumenti edhe pse nuk po pajisem me dokumente të cilët na sqarojnë, sepse është një pikë tejet me rëndësi, është një pikë që ka ardhur aty për aty në Komitet për Politikë dhe Financa dhe do duhej që ta kemi edhe kontratën në mënyrë që t'i dimë përgjegjësitë e komunës, sepse është aty një vlerë e cila është e paraparë për pagesë nga komuna në operatorin ekonomik, por kushtet e kontratës nuk i dimë si asambleistë. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Dafina. Ndoshta zyrtarët nga Drejtoria e Shërbimeve Publike janë nisur nga ajo që kontratat janë në faqe të prokurimit edhe s'ka pasur nevojë. Po sido që të jetë ne kopjen do t'ia sigurojmë shefave grupeve të paktën nga një kopje do t'ia sigurojmë tash gjatë mbledhjes. Mbasi është si pikë e fundit e rendit të ditës. Do t'ia sigurojmë kopjet shefave grupeve që mos t'i bëjmë të gjitha për 41 kuvendarë këtu.

Dafina Alishani (LVV): Domethënë, prapë po shkojmë me vendime ad hoc, pa u analizuar, pa u diskutu me asambleistë? Ajo kontratë është e madhe, qysh u informuam nga zyrtari. Edhe tash një vendim kaq me rëndësi, unë e di që ka urgjencë, mos të keqkuptohem, sepse çështja e varrezave është çështje e cila secilit qytetar, secilit asamblistë po ja ngrit si shqetësim. Por tendenca e përshpejtimit ose e pa analizimit të çështjeve të cilët votohen në asamble, mua po më duket jo serioze edhe ndaj secilit asamblist edhe ndaj vendimmarrjes në këtë kuvend. Unë nuk e di pse hezitojnë zyrtarët me na pru një dosje e cila nga 2017 ekziston. Unë nuk kam pasur qasje as në veb-faqe, nuk kam mujt me e gjetë. Edhe në prokurim e kam kontrolluar. Tash ju duhet me i pas parasysh këto. Nuk mundet asambleisti me votu një çështje për të cilën nuk ka informata. Edhe ne e cekëm në KPF decitivisht që kontratën duhet me pas.

Simir Krasniqi (Kryesues): Zyra e kuvendit t'ia siguroj kopjet e kontratave, thashë është në fund kjo si pikë e rendit të ditës dhe mund ta shihni kontratën. Vazhdojmë pra, a kemi diskutues tjerë? Po, Shukri Quni.

Shukri Quni (BDP): Faleminderit kryesues, përshëndetje koleg kuvendar. Kryesues, ne vendosëm në mbledhjen për komitet dhe politikë e financa për këtë pikë që të na sigurohet materiali edhe për atë ne unanimisht e votuam këtë pikë. Të gjithë. Megjithëse edhe pa ne kjo kishte kaluar, po fjala ke që neve me na siguru materialin, jo vetëm shefave të grupit, po me ja siguruar materialet të gjithë anëtarëve të Kuvendit, sepse kur vjen fundi secili vendos për vetveten. Andaj qysh po e shoh që kjo pikë nuk është përgatitur ashtu sikurse që e kemi vendosur në Komitet për Politikë e Financa, nuk ka nevojë me u ngut. Këtë punë veç e ceku edhe kolegu Hazizi atë ditë në mbledhjet të Komitetit. Domethënë plot një dekadë është ky problem. Edhe e dimë që është problem shumë i madh tek Varrezat e qytetit. Po edhe kjo formë nuk po më pëlqen, ose nuk është mirë, të cilën po e bëjmë ne. Andaj, me kësi pika të papërgatitura, nuk është mirë me na shti në këtë ose me votu, sepse materiali ka pas me ardhë ditën e premtë. Nuk ka ardhë, tash e keni lënë për pikën e fundit atje.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po e përsëris edhe njëherë, arsyeja pse se të gjitha kontratat janë në faqet të prokurimit. Edhe keni, mund të keni qasje aty, ndoshta për këtë arsye pse nuk është sjellë kontrata, por kontrata është publike, nuk ka diçka që mund të fshihet ajo kontratë. Ne do t'jua bëjmë kopje, do t'jua sigurojmë tash kopjet pa problem shefave grupeve, se thashë 41 kuvendarë, kopje tash ndoshta. A do t'ju përcillet edhe në email adresat e juaja, që ajo është gjithçka publike? Ju, Arianit.

Arianit Berisha (PDK): Përshëndetje të nderuar kolegë. Një sqarim të vogël të paktën për kuvendarët e grupit të Partisë Demokratike. Edhe pse nuk e kemi kontratën dhe është shumë e rëndësishme me e dit se çka përmban ajo, por siç u deklarua, ajo është publike në faqen e prokurimit. Ne sot nuk do ta ndryshojmë kontratën, sepse nuk kemi kompetencë ta bëjmë një gjë të tillë. Ne sot do t'i përcaktojmë tarifat, sipas kërkesës të Drejtorisë të Shërbimeve Publike, është në diskrecion të secilit kuvendar që ta vlerësojë se a është pro apo kundër këtij propozimi. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që me qenë të vetëdijshëm se sa e rëndësishme është me i bë zgjidhje kësaj çështje me rëndësi për gjithë qytetin e Prizrenit. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Arianit. Fjala për ju Haziz Hodaj.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit kryesues. Përshëndetje për ju, për të gjithë drejtorët, për median tonë, anëtarët e kuvendit. Unë e thashë edhe atë ditë. Është problem që është duke u prolonguar rrumbullak që janë 14-15 vjet. Dhe tani të na vijë në mënyrë urgjent nuk është mirë. Sigurisht që do ta përkrahim edhe nuk do ta vonojmë. Mirëpo kjo le të jetë vërejtje për hera të tjera. Një problem i ndejshëm, një kontratë e ndejshme do të duhej me u debatuar pak më gjerë, pak më me thellësi. Kështu që nuk është mirë në mënyrë urgjente të na hyjnë pikat e rendit ditës pa u përgatitur, pa e pa anëtarët e kuvendit, pa u njoftuar me problematikën. Thashë që 14 vjet është kjo puna e varrezave. Sigurisht që ka qenë emergjente prej atëherë edhe sot e kësaj dite veç shtohet emergjenca për këtë. Mirëpo tash të vij për një seancë kështu pa u përgatitur, nuk është në rregull. Thashë, ne do ta përkrahim edhe do të vazhdojmë. Mirëpo kjo le të jetë vërejtje për herë të tjera

që pikat e rendit i ditës t'u servohen me kohë anëtarëve të Kuvendit dhe të debatohet ashtu si duhet. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Haziz. Kemi dikush tjetër që do ta merr fjalën?

Atëherë, nëse nuk ka, e hedhim në votim propozim vendimin për caktimin e tarifës për shërbimin e varrimit, varrezat e reja të Prizrenit në Landovicë që të hyjnë në rend të ditës. Konstatojmë se të pranishëm jemi 36 kuvendarë. Kush është për? 25 për. Kundër? 10 kundër. Absenim.? 0. Atëherë konstatojmë se hyn në rend të ditës kjo pikë si pikë e 11-të e rendit të ditës.

Atëherë e hedhim në votim rendin e ditës me pikën shtesë, pra, pikën e 11. Konstatojmë se të pranishëm jemi 36. Kush është për? 24 për. Kundër? 8 kundër. Abstenim? 0. Miratohet rendi i ditës me pikën shtesë, pra pikën e 11.

Kalojmë te pika e tretë.

Pvetjet e kuvendarëve dhe ngritja e çështjeve të ndryshme.

Simir Krasniqi (Kryesues): Urdhno Dafina.

Dafina Alishani (LVV): A mundeni me na informu a vjen kryetari në seancë sot apo jo? A ka ndonjë agjent? Veç me pas informatë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Më vonë do të vjen. Tash ka agjendën e vetë. Haziz Hodaj, fjala për ju.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit shumë. E kam një kërkesë se jam motivuar nga një emision para ja katër-pesë ditë e emisionit një opinion i Blendi Fevziut për rolin e Kukësit në pranverën e vitit 1999 dhe një fjalë e ish-kryeministrit Pandeli Majko që ndër të tjera tha, nuk e di çka do të bënim po të mos ishte Kukësi. Dhe i motivuam nga gjithë ky emision dhe t'u pa këtë neglizhencën tonë, por edhe të Bashkisë së Kukësit për një mosbashkëpunim dhe një pasivizim të çdo marrëdhënieje në mes Prizrenit dhe Kukësit. I drejtohem Kuvendit të Komunës së Prizrenit, kryetarit të komunës, zotit Shaqir Totaj, me këtë kërkesë, propozim dhe shqyrtim. Lënda nismë për përkujtimin institucional të rolit historik të qytetit të Kukësit gjatë pranverës të vitit 1999. Duke u mbështetur në përgjegjësitë tona institucionale për ruajtjen dhe kultivimin e kujtesës historike paraqes këtë kërkesë për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin Komunal të Prizrenit. Pranvera e vitit 1999, përbën një nga periudhat më të dhimbshme, por edhe më të ndryshme të historisë sonë të re. Në atë kohë, Kukësi ndonëse me kapacitete të kufizuara u shndërrua në strehë dhe portë shpërblimi për qindra e mijëra qytetarë të Kosovës, duke dëshmuar solidaritet dhe humanizëm të jashtëzakonshëm. Megjithatë, me kalimin e kohës ekziston rreziku real që kjo ngjarje me rëndësi të jashtëzakonshme historike do të zbehet në kujtesën tonë kolektive, veçanërisht tek gjeneratat e reja. Për këtë arsye konsiderojmë se është detyrim institucional. Që kjo sakrificë dhe ky solidaritet të përjetësohen në mënyrë të denjë. Andaj, propozoj ngritjen e një monumenti përkujtimor në Prizren me tematikë solidaritetin dhe mikpritjen e popullit të Kukësit gjatë vitit 1999 në koordinim me autoritetet përkatëse të Kukësit. Organizimin e një manifestimi vjetor kulturo-historik, i cili do të përkujtonte këtë periudhë dhe do të shërbente si platformë edukimi për gjeneratat të reja përmes

ekspozitive, dëshmime, aktiviteteve artistike dhe dokumentarëve. Krijimin e një bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet komunës së Prizrenit dhe Bashkisë së Kukësit, me qëllim realizimin e projekteve të përbashkëta në fushën e kulturës, historisë dhe edukimit, formimin e një grupi punues të përbashkët i cili do të hartojë planin konkret të veprimit, afatet kohore dhe implikimet financiare për realizimin e kësaj nisme. Kjo nismë nuk është vetëm një akt historik, por një detyrim moral dhe institucional ndaj historisë sonë dhe ndaj atyre që në momentet më të vështira dëshmuar vlerat më të larta njerëzore. Andaj kërkoj nga Kuvendi i Komunës Prizrenit që ta shqyrtojë dhe ta mbështesë këtë propozim duke ndërmarrë hapat e nevojshëm dhe konkret për realizimin e tij. Ju faleminderit për durimin. Këtë kërkesë po ta lë ty, ja përcjell një kopje edhe kryetarit edhe merrni si seriozisht mos e neglizhoni. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Do të merremi baca Haziz me këtë kërkesë. Fjala për ju zonja Nerimane.

Nerimane Pllana Gashi (LVV): Përshëndetje të pranishëm. Sot çështjen e parë që dua ta ngrej është më shumë një sqarim për qytetarët dhe për opinionin publik lidhur me mbledhjen e grupit joformal të grave kuvendare, e cila është mbajtur në fillim të muajit mars. Ftesën për këtë takim e kemi pranuar të gjitha gratë kuvendare nga përfaqësuesi i OSCE-së, zoti Islam Salihi. Qëllimi i takimit ka qenë prezantimi i punës katër vjeçare të grave kuvendare nën udhëheqjen e zonjës Ymran Fusha, si dhe zgjedhja e kryesisë së re të këtij grupi, duke u bazuar në funksionimin e këtij grupi si grup i grave kuvendare dhe jo në baza të subjekteve politike. Për mua ky ishte takimi i parë, i pranishëm ishte dhe kryesuesi zoti Krasniqi, pas prezantimit të punës katër vjeçare të grupit, filluan propozimet për kryesinë e re. Nga pozita u propozua zonja Trëndelina Kastrati për kryetare, ndërsa unë për nënkryetare. Ndërkohë nga opozita u propozova unë si kryetare. Ajo që më habiti më së shumti ishte këmbëngulja e ish-kryetares së këtij grupi që unë të mos vazhdoj si kryetare. Nga frika se mos po vazhdoj praktika e kaluar, ku për katër vite rreth 80% e aktiviteteve kishin karakter të fushatës, për kryetarin dhe subjektin e tyre politik. Derisa kryesuesi dhe ish-kryetarja e grupit insistonin të vazhdoj vetëm me propozimin e pozitës, edhe përfaqësuesi i OSCE-së, zoti Salihi, vazhdonte ta lexonte vetëm atë propozim, duke mos i dhënë hapësirë të barabartë propozimeve të tjera. Kjo mënyrë e zhvillimit të procesit tregon qartë mungesë të transparencës, mungesë të pabarazisë dhe një tendencë për ta kontrolluar një grup që duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe mbi baza jo partiake. Një qasje e tillë nuk i shërben as grave kuvendare dhe as qytetarëve të Komunës së Prizrenit. Për këtë arsye vendosa të tërhiqem plotësisht nga ky proces pasi nuk mund të jem pjesë e një vendimmarrje që nuk është e hapur dhe nuk është e drejtë e transparente. Po ashtu e konsiderova të nevojshme ta bëj këtë sqarim sot, pasi kam pranuar shumë reagime dhe mesazhe nga qytetarët pas publikimit të fotografive lidhur me këtë takim. I kam edhe disa kërkesa për drejtorët. Kërkesa e parë ka të bëjë me drejtorinë e punës dhe mirëqenies sociale. Ka të bëjë me çështjen e banesave për familjen e dëshmorëve. Bazuar në ankesat dhe kërkesat që më janë bërë nga familjet e dëshmorëve, ju drejtohem lidhje me çështjen e banesave të ndara nga kuvendi nga Komuna e Prizrenit për këto familje me 26 nëntor 2014. Konkretisht në lagjen Shtjefën Gjeçovi Jeni Mahallë afër ambulancës kryesore. Bëhet fjalë për 17 familje të cilave u janë dhënë dokumente të rregullta për posedim të banesave me të gjitha specifikat përkatëse, mirëpo tash e 12 vite nuk kanë mundur t'i shfrytëzojnë ato banesa. Kërkojmë nga ju, drejtor, të na informoni për statusin aktual të këtyre banesave, të ndërmerrni masa konkrete për zgjidhjen e këtij problemi dhe

funksionalizimin e tyre. Gjithashtu ka të bëjë edhe me banesat e njëjta të familjeve të dëshmorëve, mirëpo që gjenden në lagjen Petrova përballë gjimnazit Loyola, ku aty kemi gjithsej katër ndërtesa me nga 30 banesa. Dy ndërtesa janë shpërndarë. Një ndërtesë është e përfunduar, por nuk janë shpërndarë prej rreth vitesh për shkak të problemeve me regjistrimin e orëve të rrymës në emër të pronarëve. Një ndërtesë ende nuk është shpërndarë fare. Ju lutem na informoni cilat janë arsyt e këtyre vonesave dhe çfarë veprimesh konkrete do të ndërmerrni për zgjidhjen e këtij problemi. Kërkesa tjetër i drejtohet Drejtorisë së shërbimeve publike. Pas shumë ankesave dhe kërkesave që kam marrë nga lagja Dardania dhe Lubizhda për lidhjen e autobusëve lokal urban të kompanisë EFA Turizëm. Ankesat kryesore kanë qenë mosrespektimi i orarit të publikuar në faqen zyrtare të kompanisë. Përfundimi shumë i hershëm i qarkullimit të autobusëve, do të thotë lagjja Dardani dhe Lubizhd vijën e fundit të autobusëve e ka në ora 6:30. Duke pasur parasysh që shumica e punëtorëve e qytetarëve punojnë dhe përfundojnë orarin e punës në ora 6:00. Kërkesa e këtyre qytetarëve ka qenë që të zgjatet orari i qarkullimit të autobusëve së paku deri në ora 22:00. Të shtohen linja dhe frekuenca të qarkullimit, veçanërisht për lagjen Dardania, duke ditur se ajo lagje është në zhvillim dhe rritje të vazhdueshme të banorëve. Dhe kërkesa e fundit ka të bëjë me ndriçimin publik në rrugën Liman Shala, në lagjen Bajram Curri në Prizren. Në këtë lagje, ndriçimi publik është funksional vetëm deri tek xhamia. Ndërsa kjo pjesa tjetër e rrugës ka mbetur pa ndriçim me vite të tëra. Kjo situatë paraqet rrezik për sigurinë e banorëve dhe kalimtarëve, sidomos gjatë orëve të mbrëmjes. Gjendja është e përkeqësuar duke ditur që kemi të bëjmë tash edhe me praninë e qeneve endacakë. Për këtë arsye, qytetarët kanë kërkuar vazhdimin dhe kompletimin e ndriçimit publik në pjesën e mbetur të kësaj rruge, në mënyrë që të rritet siguria. Këtë kërkesë qytetarët e kanë deponuar kohë më parë, mirëpo përgjigje nuk kanë marrë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zonja Nerimane. Fjala për ju Karanfil Haxhillari.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesues. Të nderuar kolegë kuvendarë. Unë sot do kam një çështje për drejtoreshën e arsimit. Me 24 mars, pra në javën e kaluar në shkollën fillore Gani Saramati, ndaj një nxënës i është ushtruar dhunë nga kujdestarja e klasës Zinije Gurmani. Rasti tashmë po trajtohet nga organet e drejtësisë, po besoj që drejtoresha është në dijeni, por çështja është nga informatat të cilat i kam, kjo e nderuar është e punësuar me kontratë me kohë të caktuar që disa vite dhe nuk ka kontratë të rregullt si mësimdhënëse. A është e vërtetë kjo drejtoreshë? Dhe pse, edhe pse do të kërkoj qasje për këto? Nëse ja shtojmë faktin që personi në fjalë në dy vitet e fundit paska qenë rregullisht edhe në komisionin për rekrutimin e mësimdhënësve, do ta kisha kënaqësinë nga drejtoresha të dëgjoj se a ka qenë anëtare e komisionit për rekrutim edhe pse pa kontratë. Po ashtu këtë zonjë e shoh edhe në Këshillin për siguri dhe bashkësi, e cila na paraqitet si kryetare e Këshillit të prindërve. Pyetja është, me çfarë procesi zgjedhor është paraqit apo është kjo zonjë e nderuar si kryetar i Këshillit të Prindërve? A mund ta kemi një procesverbal të tillë ku e shohim cilët prind e kanë zgjedhur si kryetare të Këshillit të Prindërve dhe sot do ta kemi në pikën e rendit të ditës si anëtare e Këshillit të Prindërve apo e keni zgjedhur vetë me kryetarin si motra e shokut të ngushtë të kryetarit dhe normalisht për argallëkinë dhe vazhdimësinë e taktikave të juaja për përzgjedhjen në arsim që po ndodhin tash e sa vite. Kjo është pyetja.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Karanfil. Fjala për ju Shqipe Shatri. Le të përgatitet Liridona Veçgishi.

Shqipe Shatri Çoçaj (LVV): Faleminderit kryesues, i nderuar zotëri Krasniqi. Sot në këtë mbledhje të tretë parashtroj pyetje për drejtorinë e shëndetësisë, për drejtorinë e arsimit, gjithashtu përmes emailit kam dërguar pyetje edhe drejtoreshës së kulturës zonjës Shishko. I nderuar drejtori i shëndetësisë doktor Sylejman Baxhaku. Sot gjithnjë e më shumë qytetarë veçanërisht të rinjtë përballen me sfida të shëndetit mendor dhe rrezik nga varësitë. Për fat të keq mungojnë shërbime të mjaftueshme dhe të qasshme për këshillim dhe trajtim profesional. Pyetja ime është, a ka drejtoria e shëndetësisë ndonjë plan konkret apo strategji për hapjen e një qendër psikoterapeutike komunale në Prizren, ku do të ofroheshin shërbime pa pagesë për Këshillin Psikologjik dhe parandalimin e varësive, tu nis nga ajo mjetet, substanca, alkooli, pse jo dhe nga teknologjia. Faleminderit. Pyetja e radhës për drejtoreshën e Arsimit. E nderuara drejtoreshë zonja Veselaj Gutaj, i referohem udhëzimit administrativ numër 19 të 2012-ës. Konkretisht fokusohem te neni gjashtë cili parasheh themelimin dhe funksionalizimin e ekipeve për parandalim, reagim, regjistrim dhe braktisje të nxënësve në arsimin e obliguar. Kisha kërkuar përgjigje në këto pyetje. A është duke funksionuar ky ekip me shkurtesë e PRMB-ja në nivel komunal dhe në të gjitha shkollat? A mbahen takime të rregullta çdo tre muaj ashtu siç parashihen në udhëzim? Cilat masa konkrete janë ndërmarrë deri më tani nga ky ekip për parandalimin e braktisjes së nxënësve dhe a ekziston ndonjë raport i rregullt për rastit e braktisjes dhe cilat janë rezultatet konkrete nga ky ekip? Sepse fatkeqësisht duhet të them që përkundër udhëzimit në fuqi sot kemi braktisës, domethënë nxënës braktisës në arsimin fillor. Pyetja për drejtoreshën e kulturës i kam dhënë kohë me u përgjigj. A ka drejtoria e kulturës ndonjë plan konkret për sistemin e klimatizimit në shtëpinë e Kulturës Reshat Çoçaj në Gjonaj. Ju faleminderit për vëmendje.

Simir Krasniqi (Kryesues):Faleminderit zonja Shqipe. Për ju fjala Liridona Veçgishti.

Liridona Veçgishti (BDP): Përshëndetje i nderuar kryesues, ju drejtor dhe kuvendarë. Pyetja ime shkon për drejtorin e shëndetësisë, doktor Syleiman Baxhakun. Një kohë të gjatë në QKMF të Prizrenit nuk është duke funksionuar ashensori ku pacientët me sëmundje kronike, pacientët me aftësi të kufizuar, e kanë shumë të vështirë qasjen në katin e dytë, ku kryhen shërbimet laboratorike, që është një numër i madh i pacientëve. Me siguri për këtë problematikë, drejtor jeni të njoftuar, sepse edhe zyrat e Drejtorisë së Shëndetësisë qëndrojnë në katin e tretë. Kërkoj nga ju të ndërmerrni masa për rregullimin e ashensorit, pasi pika e parë për funksionalizimin e QKMF-së, është, nëse vjen te licencimi, kërkesa e parë është që nuk do të përmbushet kushti i parë, siç e ceka më parë, për t'u licencuar. Dhe pika e dytë, drejtor, Komuna e Prizrenit ofron shërbime për mbështetje financiare, ku e dimë të gjithë për të sëmundjet malinje për fëmijët me diabet deri në moshën 18 vjeç. Kam shumë kërkesa nga shumë qytetarë dhe prindër që në këtë pikë të mos hipet çdo vit kopje paste, i njëjti për përfitime nga 400 euro. Pse mos të kenë të drejtë dhe fëmijët me sindrom down dhe fëmijët me sindrom autik që të jenë përfitues pasi që për familjarët e tyre kjo kosto sadopak do ja zbuste shërbimet. Kërkoj nga ju që ta rishqyrtoni dhe njëherë këtë vendim, që së paku të futen dhe këto dy kategoritë për përfitime nga 400 euro. Faleminderit doktor Baxhak. Pyetjen tjetër e kam për drejtorin e shërbimeve publike. I nderuari drejtor, tashmë në qendrën historike të Prizrenit, përballë atëherë Therandës, muri mbrojtës i ka dhënë një pamje shumë të

bukur të qytetit dhe po ju përgëzoj për këtë që po investohet vetëm në sheshin e Shatërvanit, por mos ta harrojmë se përballë zjarrfikësve, besoj që keni dhe ju njohuri, te rruga William Voker, dhe përballë zjarrfikësve është ura. Drejtor, aty është më se urgjente një urë mbrojtës, para një muaji, një makinë, se është një park ku parkohen dhe makinat. Para një muaji ka ra në lum një makinë. Para një jave unë kam qenë prezent kur një fëmijë me biçikletë ka ra në lum. Por për fat të mirë pa pasoja në persona. Kjo është kërkesë e të gjithë atyre banorëve dhe është shumë urgjente drejtor. Besoj që do e qitni në terren, do e shihni se sa e nevojshme është përballë zjarrfikësve. Besoj që kjo punë duhet të kryhet ky mur, një mur mbrojtës do të jetë sa më e shpejtë e mundur që mos të shkojmë deri te një pasojë e ndonjë nga personat. Faleminderit drejtor.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zonja Liridona. Fjala për ju Trëndelina Kastrati.

Trëndelina Kastrati (PDK): Faleminderit kryesues, të nderuar kolegë. Kohëve të fundit kam qenë në komunikim të drejtpërdrejtë me banorët e disa lagjeve të Prizrenit për të dëgjuar nevojat e tyre. Kam mbledhur disa kërkesa konkrete që ndërlidhen me shëndetin publik, infrastrukturën dhe sigurinë në qytet. Si pjesë e shumicës qeverisëse, qëllimi im është që këtë zë të qytetarëve ta kthejnë në zgjidhje praktike. Për të mos e zgjatur në seancë me detaje teknike, listën e plotë me lokacione specifike do t'ia dorëzoj zyrtarisht drejtorëve përkatës menjëherë pas mbledhjes. Kështu që kërkoj nga ekzekutivi që t'i trajtoj me prioritet për të treguar se ne jemi një qeverisje që dëgjon dhe vepron. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zonja Trenelinë. Fjala për ju Sefidin Islamaj.

Sefidin Islamaj (BDP): Faleminderit zoti kryesues, të nderuar kolegë kuvendarë dhe ju të nderuar bashkëqytetarë të Prizrenit. Për sot kam dy kërkesa. E para, drejtorisë së drejtorive shërbimeve publike zotëri Ukimerit. Meqëse u zotua para disa ditësh për zgjerimin e ndriçimit publik, por ka akoma lagje në qytet që kanë mungesë të ndriçimit publik. Fjala vjen për lagjen ish-Medreseja e vjetër në rrugën Izair Berisha. Kërkesa për ndriçim publik për këtë çështje është bërë vite më parë pranë drejtorisë së shërbimeve publike, por asaj kohe përgjigja që ishte kthyer banorëve ishte paska qenë jo mjete të mjaftueshme për të ndërmarrë këtë iniciativë. Banorët e asaj lagje me të njëjtën me mjetet individuale, financiare kanë bërë të mundur vendosjen e shtyllave elektrike dhe kërkesën për shtrirjen e ledrit elektrik e paskan bërë vitin e kaluar. Por për ndriçim publik, përsëri vitin e kaluar është bërë kjo kërkesë, domethënë dy herë radhazi 2023-2024. Por në këtë lagje vërehet gjithashtu infrastrukturë e keqe rrugore, ku për vite në periudhat e dimrit shkaktojnë rreshje dhe shiu të dëborës hasin në probleme në vërshime. Kjo rrugë ka nevojë për ndërhyrje për shkak të ekzistimit të gropave dhe mungesë të pusetave për shkarkimin në ujë. Kërkesa tjetër ka të bëjë me drejtorinë e shërbimit publik edhe asaj të turizmit. Tashmë dimë se fshati Poslisht është atraksion turistik si nga vizitorët lokalë dhe ata të jashtëm, por gjithashtu ka raste të shpeshta ku nxënësit e shkollave nga të gjitha trevat e Kosovës kalojnë një pjesë të ditës tek burimi. Me kërkesë të kryesisë së fshatit dhe nevojës së vizitorëve, këtij vendi i nevojitet një banjo publike, që të jetë në funksion gjatë sezonit të verës dhe asaj të pranverës. Të gatshëm për mirëmbajtje të kësaj banjo publike janë shprehur kryesia e fshatit dhe pronarët e barakës që kushtojnë aktivitete afër. Kategori tjetër e vizitorëve janë njerëzit që kërkojnë shërim në burimin e ujit të ftohtë të Gurrës. Janë bërë disa investime në gurrë, por nuk është menduar asnjëherë për këtë kategori të njerëzve. Për shkak se ndërtimi i rrethojave dhe mureve mbrojtëse u jep shumë pak qasje ose pothuajse hiç që të futen në

ujë. Kërkojmë nga njëra nga këto drejtori që ta shqyrtojë si mundësi që së paku në njërin pjesë ku derdhën ujëvarat të bëjnë shkallë betonin në mënyrë që qasja e ujit të jetë më e lehtë. Mbetet me shpresë që të dy kërkesat të shqyrtohen sa më shpejt. Ju faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ju faleminderit. Fjala për ju Bajram Kastrati.

Bajram Kastrati (LDK): Faleminderit kryesues, përshëndetje ekzekutiv, koleg kuvendarë, pyetje për drejtorinë e shërbimeve publike. Kërkesë për herën e tretë drejtor. Rruga Xhem Gegollaj apo Tranziti që të dërgon në hyrje të autostradës, ku qytetarët e lagjes Arbanë dhe të tjerët për t'u qasur në rrugën që të shpie në qytet, duhet të kalojnë tri kors. Ku rrezikojnë seriozisht edhe jetën. Kërkesa është kjo, pasi që nuk plotësohen kushtet për ndonjë rrethrotullim, ju lutem të merrni masa për vendosjen e semaforëve që t'i shmangemi aksidenteve. Gjithashtu, një kërkesë tjetër, kemi shumë vende brenda qytetit që japin pamje jo të mirë, imazh të keq, organizim i bizneseve apo edhe prona publike të lëna pas dore. Ju lus të merrni masa qoftë për rregullimin e pamjeve apo edhe lirim të hapësirave të tyre publike. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zoti Bajrami. Fjala për ju Selman Sokoli.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit. Pasi në ekzekutiv komunal nuk ka vesh që po na dëgjojnë për pyetje, jemi dëshmitarë që edhe mandatin e kaluar edhe këtë mandat duke përfshirë edhe kryetari, kurrë s'kemi marrë përgjigje të sinqerta. Unë veç po ngris çështje. Derisa të mendojmë që drejtorët edhe kryetari, nënkryetarët janë përgjegjës dhe janë në nivel të detyrës karshi qytetarëve votën e të cilëve kanë marrë për na përfaqësuar. Ajo karrika e zbraz aty është për një person që tashmë i tërë qyteti edhe partia e tij e njeh si arrogant dhe gënjeshtar. Ai del nëpër emisione të kurdisura, shpifë për qeverinë, mirëpo ky person me keqkqeverisjen, me hajninë e tij pesëvjeçare e ka futur Prizrenin pothuajse në fajde. Nga hajnia e madhe, nga keqpërdorimet, nga paaftësia për të qeverisë, Prizreni po pëson edhe nga përmbaruesit. Nuk është e vërtetë që mjetet financiare komunës e Prizrenit, përmbaruesi i merr vetëm për kontratën kolektive. E vërteta është e konstatuar edhe në raportet e auditorit për vite me radhë, që mos zbatimi i kontratave apo mos pagesa e faturave ndikon që përmbaruesit ose bizneset, madje ju vetë po i thoni bizneseve që merrni mjetet me përmbarues për shkak se nuk kemi. Domethënë aq të aftë në planifikim jeni edhe aq serioz jeni në planifikim saqë veç tentoni me kry një punë edhe mjetet, përmbaruesit, mjetet e kompanive të ndryshme i thoni i merr përmbaruesi. Kur aktivizohet përmbaruesi, siç mund ta dini përqindja minimalisht 30% rritet çmimi i një kontrate. Paramendo çfarë dëmi po i bëhet komunës Prizrenit nga një arrogant dhe gënjeshtar si Shaqir Totaj. Tjetra, ju si pushtet i komunës së Prizrenit si ekzekutiv nuk po jepni edhe mjete financiare personave që vuajnë me sëmundje të rënda ose po e vononi shumë. Që në një moment ato dhe nuk kanë efekt ose dhe personat mund të mos jenë më në këtë jetë. Analizat në qendrën kryesore mjekësisë familjare janë pakësuar dukshëm. Gjithashtu edhe shtesat për fëmijë dhe nëna Lehona nuk po jepni në bazë të rregulloreve edhe vitin e kaluar nuk i keni dhënë hiç. Për fund kryesues nuk po e zgjas shumë. E kam marrë mesazhin përmes, kryesuesit të grupit tonë e kuvendarëve. Me sa di ju jeni doktor shkencë me gradë. Keni qenë edhe drejtor i institucionit shkollor. Edhe pse duke hulumtuar pak e më ka bërë përshtypjen një fjali ish-drejtorit Pranverim për ju, mirëpo nuk po e them atë atë cilësim që ja kanë bërë. Mirëpo në atë formë, të lutem ta di, nëse bash keni menduar me e realizu ato, unë po them kështu në prezencë të kolegëve e të mediave, të shoqërisë, e qytetarëve që na dëgjojnë, pushka top tu bëftë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju Albulena Balaj Halimaj.

Albulena Balaj Halimaj (NISMA): Faleminderit kryesues, i nderuar kryesues, drejtorë, koleg kuvendarë, të nderuar dhe shumë të respektuar qytetar. Sot po dua me fol për një çështje shumë serioze, e cila po ndodh në qytetin e Prizrenit herë pas here, pra në territorin e komunës sonë. Është te pjesa e fshatrave Petrov, Trepeticë e cila vazhdon pastaj në drejtim të Piranës. Është evidentuar një problem shumë serioz, i cili drejtoreshë e inspektorateve po ndodh zakonisht të shtunave. Po flas për një përrroskë e cila është në degën e lumit Topllu ose, siç njihet prej shumë qytetarëve lumit Jeglenica. Aty po derdhen mbetje organike që dyshohet që vijnë prej disa thertoreve e disa individëve të papërgjegjshëm. Pra, që kjo pjesë po ndodhet me këto mbetje, e cila është tepër shumë e rrezikshme për shëndetin e secilit qytetar dhe jo vetëm të Prizrenit. Që ky lum, lumi Topllu derdhet te Drini i bardhë. Edhe qekjo është pesha që i jep kësaj çështje. Përveç shëndetit të banorëve, ju e dini që me atë pjesë të përoskave ujitën tokat e shumë qytetarëve andej, por përveç këtyre të dyjave, sigurisht që është shumë e rrezikshme edhe për ekosistemin. Me asnjë legjislacion në botë e as me legjislacion të Republikës së Kosovës nuk lejohet asnjë derdhje e gjakut të kafshëve apo të thertoreve nëpër lumenj, sepse ju e dini sa është e rrezikshme kjo. Ne nuk kemi mekanizma për me, ose kemi mekanizma po nuk e di pse nuk përdoren shumë më shpesh në qytetin e Prizrenit, me pa cilësinë e ujit, a duhet të përdoret nga qytetarët ose jo kur kjo ndodh? Edhe me pa që, edhe me informu qytetarët kur ndodh kjo që nuk duhet me e përdor ujin e pijes. Po pse po ndodh kjo të shtunave, sigurisht ju drejtoreshë e dini. Unë po ju sugjeroj ose po ju rekomandoj që inspektorët të dalin në terren, të shohin, unë i kam me video edhe fotot, jua dërgoj edhe e shihni pjesën. Është një pjesë poshtë te tranziti i vjetër. E shihni që është shumë e rrezikshme dhe ju lutem të merrni masa të menjëhershme. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zonja Albulena. Fjala për ju, Petrit Hoxhaj.

Petrit Hoxhaj (Guxo): Faleminderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë. Kam sot një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike. Rreth çështjes së rrugës Tahir Sinani apo tek mbrapa tregut Fatoni. E di që ka pasur iniciativa të ndryshme edhe mes Bashkësisë Islame dhe mes Drejtorisë Shërbimeve Publike. Mirëpo sot e atëherë nuk është marrë asnjë iniciativë. Banorët, do të thotë, banorët për çdo ditë kanë kërkesë se çka është duke ndodhur me këtë rrugë. Mirëpo, nuk po kemi informata të sakta, sepse këndej Bashkësisë Islame thotë që ne jemi të gatshëm, këndej DSHP-ja, do të thotë, me sa di, vitet e kaluara kanë thënë që jemi të gatshëm, por ku ka mbetur problemi, pse nuk po rregullohet kjo? Ndërsa kam edhe disa pyetje për drejtorin e bujqësisë, mirëpo mbasi nuk është këtu, atëherë besoj që ja përcjell doktori Sylja, drejtori. Gjatë takimeve që po shkon me fermer, kërkesat e shumë fermerëve janë se kur do të lëshohen subvencionet e fermerëve për vitet e kalume. Dhe ku ka mbetur procesi dhe a do të lëshohen këto subvencione? Sepse komunat përreth veç kanë hapur thirrjet për vitin 2026, ndërsa komuna jonë ende nuk i ka mbyllur të vitit 2025. Ndërsa për drejtorin e shëndetësisë, i ndërruar drejtor, procesi i ndërtimit të objektit të ambulancës në fshatin Vlashnje ku ka mbetur, me sa e di që ish-drejtori i kaluar do të thotë t'i ka lënë të gjitha të gatshme, mirëpo ende nuk është marrë ndonjë ndonjë veprim. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Petrit. Fjala për ju, Eldis Abazi.

Eldis Abazi:

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju, Adem Shabanaj.

Adem Shabanaj (LVV): Faleminderit kryesues, i nderuar zëvendës kryesuese, urime për zgjedhjen në këtë pozitë, paq fatin tuaj në politikë, të gjithë këtu. Të nderuar drejtor, media, të dashur kolegë kuvendarë, kam disa çështje që kanë të bëjnë me infrastrukturë. Drejtori shërbimeve publike, ashtu siç e dimë të gjithë është hapur një rreth me kërkesë të disa kuvendarëve, ndoshta të 50% të kuvendarëve në lagjen Bajram Curr, rrethi që e lidh lagjen Bajram Curr të lagjes së Trimave, mirëpo derisa nuk ka qenë rrethi ka ekzistuar rruga, tash po ekziston rrethi e nuk kemi rrugë, është mbyllur për qarkullim, rruga që lidh lagjen e Trimave me lagjen Bajram Curri. E kemi parë një kod buxhetor i cili ka të bëjë me shpronësimin e disa pronave në komunën e Prizrenit. Dashta me ditë se kur do të fillojnë procedurat për shpronësimin e asaj parcele dhe kur do të hapet për qarkullim kjo rrugë. Derisa jemi te ajo rrugë, drejtoreshë e inspeksionit aty kanë filluar, është bërë pastrimi realisht në mandatin e kaluar prej materialeve të ngurta në pjesën ku janë duke u ndërtuar edhe shtëpitë sociale prej Drejtorisë së Punës dhe Mirëqënien Sociale. Edhe është Çerdhja dhe Qendra për Punë Sociale në atë vend. Kanë filluar përsëri që personat papërgjegjshëm të vazhdojnë të hedhin mbeturina në atë vend, e cila është pronë e Komunës së Prizrenit. Mbesim në lagjen e Trimave, te Drejtoria e Shërbimeve Publike. Në tri rrugët kryesore, drejtor, rrugën Bashkim Suka që lidh rrugën Hasim Berisha, rruga Xhevat Berisha që është rruga kryesore dhe në rrugën poshtë rrugës Xhevat Berisha, në rrugën Selajdin Berisha. Dëmtimet në infrastrukturë janë jashtëzakonisht të rënda. Kërkesat në rrugën Selajdin Berisha janë tash e sa vite prej kohës së kur ka qenë kryetar profesor doktor Ramadan Muja e deri sot. Aty nuk ka fare kanalizim, kur ka reshje atmosferike grumbullohet uji dhe rruga bëhet e paqarkullueshme. Kam pasur disa herë takime edhe me ish-drejtorin Çel Lama, kam pasur edhe takime me ish-drejtorët e qeverisjeve të kaluara. Mirëpo asnjëherë zgjidhje nuk është bërë. Kërkojmë nga ju që ta merrni shumë seriozisht çështjen e kësaj rruge. Çështjen e rrugës Xhevat Berisha, asfaltimi i cili ka ndodhur në vitin 2016, me të vërtetë është jashtë funksionit. Duhet manovra të mëdhaja me bë me ik, me iu largu gropave të cilat janë hapur në asfalt. Nuk e di se si qëndron puna me kontratën kornizë të asfaltimit të rrugëve, mirëpo kërkoj nga ju, si përfaqësues i asaj lagje që me të vërtetë të merrni seriozisht çështjen e gërmimit të asfaltit dhe shtruarjes së një shtrese të re dhe nivelizimit të pusetave në atë pjesë. Ndërsa në rrugën Bashkim Suka, e cila e lidh rrugën Hasim Berisha, ka ekzistuar një projekt për rregullimin e infrastrukturës në këtë pjesë, mirëpo nuk e di se ku ka mbetur. Në këtë projekt ka pasur edhe shtrimin e disa rrugicave në lagjen Tusuz, e që për momentin nuk po më kujtohet emri i kompanisë të cilën e ka pasur projektin, mirëpo është mirë që të shikoni në drejtorinë nga zyrtarët tuaj dhe të më informoni në seancën e ardhshme se si ka mbetur puna sepse me të vërtetë ka qenë e matur për pozicione edhe ka qenë pjesë e projektit të ndërtimit të infrastrukturës në lagjen Tusuz. Meqënëse drejtoresha e Kulturës nuk qenka këtu edhe nuk po zgjatëm shumë, kërkesën do t'ia dorëzoj me shkrim. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Adem. Që nuk jeni fotografuar, fotografisti është aty për faqet komunës dhe për ID kartelat, mundeni tash me shfrytëzu këto pyetje përgjigje në këtë kohën. Vazhdojmë me ju Ilir Gashi.

Ilir Gashi (LVV): Faleminderit zoti kryesues. E filluat seancën po nuk na njoftut me këtë zotëriun që po rrin atje kryet vendit. Kush është emri, mbiemri, çfarë pozite ka, ku është emruar? Nuk

dëgjova. Jo, jo, jo. Mirë, mirë kishte me qenë, mirë kishte me qenë. Urime drejtorit, suksese në punën, detyrën e re. Drejtori iki. Islami. Hajde t'ia përcjellim diqysh po. Javën që e kaluam ishte një javë për fat të keq e përgjakshme për Prizrenin ku disa persona humbën jetën tragjikisht në aksidentet e komunikacionit. Këtu fajtorin natyrisht nuk jemi për ta emëruar sepse janë organet kompetente që merren me këtë punë. Por ne si komunë sa jemi në krye të detyrës, sa jemi të përgjegjshëm në punën që po e bëjmë dhe në këtë rast Drejtoria e Shërbimeve Publike sa është e kujdesshme, sepse mandatin që e kaluar për katër vite nuk ka pasur seancë që dikush prej kolegëve kuvendarë nuk ka ngritur çështjen e ndriçimit publik, çështjen e semaforëve edhe të sinjalizimit horizontal dhe vertikal. Dhe kaluan katër vite nga ish-drejtori vetëm kishin fjalë për tre muaj, për gjashtë muaj, jo në mars, jo në qershor, jo në shtator do të rregullohet dhe kaluan katër vite pa u përmirësuar. Dhe tash po e shohim që sërish ka raste të rënda me fatalitete që rrugët e qytetit tonë për fat të keq po derdhet gjaki i qytetarëve tonë. Po humbin jetë njerëz të rinj e të vjetër nëpër rrugët tona. Ne këtu kur po marrim detyrën po betohemi se do të punojmë për sigurinë dhe për qetësinë e qytetarëve. Po kjo në terren nuk po shihet. Drejtoria e shërbimeve publike duhet të jetë më në krye e detyrës. Janë disa çështje që mund të rregullohen sikurse që është ndriçimi dhe rregullimi i sinjalistikës. Nuk ka shenja se në afërsi ekziston kalimi për këmbësor. Janë disa hapësira të gjelbërta mes dy shiritave të rrugës, ku rriten drujt, lulet, ç'kado që është mbjellur aty dhe e kufizon pamjen e vozitësve. Natyrisht kjo nuk do të thotë se vozitësi mund të vozitë me shpejtësi të madhe, por megjithatë krijon një lloj kutie sepse pengon pamjen çka ka në anën tjetër të rrugës dhe nuk vren shpesh kalimtarët që ecin në rrugën e dedikuar për ta. Po ashtu drejtoria e shërbimeve publike mund të vendosë edhe radar dhe tabela që tregojnë shpejtësinë se sa po lëvizin makinat dhe kjo ka efekt pozitiv sepse kur një vozitës e sheh veten që po ec shpejt, atëherë, besoj që e ngadalëson edhe ai, sepse edhe paralajmërohet që ka kalim për këmbësor, por edhe kur e sheh që është shpejt, e ndalon shpejtësinë e tij. Po ashtu edhe bashkëpunimi me policinë e rajonit të Prizrenit, do duhej të ishte më në nivel, që të ketë më shumë kontrolle policore, që në këtë qytet të vogël, me kaq pak banorë, ka aq shumë raste me fatalitete në komunikacion. Një çështje tjetër për drejtorinë e shërbimeve publike dhe inspektoratin, me 22 mars ditën ndërkombëtare të ujit, organizata joqeveritare “ec më ndryshe” ka publikuar një video me ujërat në komunë të Prizrenit, lumenj dhe liqeni i Vermicës dhe aty mund t'i gjeni të gjitha pikat se ku ka mbeturina që janë jashtëzakonisht shumë dhe ndotje jashtëzakonisht shumë e madhe. Pra është bërë një punë e mirë nga ta dhe është shumë e lehtë tash për për komunën që të ndërhyjë në pastrimin e këtyre ambienteve. Po ashtu në lagjen Nën Kala, në anën e djathtë të Kalasë, ku janë shtëpitë e fundit, gati nga çdo pozitë e qytetit vërehet është një vend ku janë grumbulluar në masë të madhe mbetjet inerte. Është një pamje shumë e keqe. Do të ishte mirë që komuna të ndërhyjë, ta rregullojë, ta pastrojë atë hapësirë dhe të ndërmerr masa që mos të hudhen mbeturinat në atë vend. Faleminderit për dëgjim.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zoti Ilir. Fjala për ju Zgjim Kryeziu.

Zgjim Kryeziu (LVV): Faleminderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë. Kam një kërkesë për drejtorinë e shërbimeve publike. Bëhet fjalë për rrugën Faredin Hoti apo me emërtimin e ri Abdurrahim Gërdellaj, e cila gjendet në lagjen 11 Marsi, ku një segment është i asfaltuar, ndërsa pjesa tjetër, konkretisht ajo që kryqëzohet me rrugën Tamil Shala, vazhdon të jetë e shtruar me kubëza dhe në gjendje mjaft të rëndë. Kjo pjesë e rrugës ka nevojë urgjente për rehabilitim ose

asfaltim. Pasi që gjendja aktuale po vështirëson qarkullimin dhe po paraqet problem për banorët, lus drejtorin e shërbimeve publike që të ndërmarrë masa dhe të intervenojë sa më shpejt që të jetë e mundur, për sanimin e kësaj rruge. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ju faleminderit Zgjim. Kemi diskutues të tjerë? Dafina Alishani ka fjalën, e përgatitet Alban Bislimaj.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesues. Edhe unë i them për hajër drejtorit të ri edhe i uroj suksese e sidomos për hajër PDK-së që ishin goxha të kënaqur me emërimin tuaj, ishin gëzuar goxha shumë. Inshallah delni faqe bardhë, edhe inshallah mundeni me i shërby më së pari strukturave që janë gëzuar për juve e mandej qytetarëve. Kërkesën e parë, me gjasë ju keni filluar tash me skanimin e gjendjes, po çështja emergjente që është me pronat komunale, është skanimi i gjendjes, sidomos çështja e uzurpimit të pronave komunale, e sidomos disa parkingje të cilët kanë uzurpuar dhe inkasojnë nga qytetarët. Unë ju kisha lutur me bë këtë skanime dhe me pa sa më shpejt një raportim në kuvend, por edhe te kryetari që si qëndron çështja e pronave, sepse edhe votimi i pronave ka ndodhur pa skanim të gjendjes edhe pa prezantim se cilat prej atyre janë të uzurpuara. Për keqardhje që nuk ka drejtoresha gra, edhe pse kryetari ka premtuar, edhe pse kryetari ka dhënë shumë fjalë, sidomos prapë atyre grave të cilët e kanë votuar, e shohin një farë ode burrave që është formuar këtu në këtë sallë edhe shpresoj që votuesit e shohin këtë çështje edhe i kërkojnë llogari atij i cili ka premtuar për barazi edhe për gjithëpërfshirje. Sa i përket çështjes së ndriçimit publik edhe pse nuk është drejtori këtu, unë sinqerisht dua me ditë kjo qeverisje sa milionë euro ka shpenzuar për ndriçim publik edhe sa përqindshi i ndriçimit publik është rregulluar. Sepse kontrata po ka shumë, shpenzime po ka shumë, por ndriçim nuk po ka. Banorët e lagjes Ortakoll i bëjnë thirrje PDK-së të bëjnë tubime sa më shumë, sepse kur po keni tubime po rregulloni ndriçime në lagje, sikurse që ka ndodhur në pjesën e tubimit ku e keni pasur. Kështu që ju kisha lutur, vazhdoni me tubime nëpër lagje, sepse kur po bëni tubimet e juaja, atëherë po rregulloni ndriçim. Pjesa tjetër e Ortakollit në hyrje tash ka jashtëzakonisht shumë nevojë për ndriçim, kështu që ju inkurajoj të bëni sa më shumë tubime edhe prezantimet partiake, sepse atëherë po punoni për të mirën e komunitetit. Mbetjet inerte në rrugën për në Tranzit janë për keqardhje. Unë e di që kjo është papërgjegjësi e qytetarëve, por është edhe mungesa e kontrollit, sidomos nga inspektoriatet. Ju kisha lutur që këto mbetje të cilat i gjuajnë ata njerëz të papërgjegjshëm të ketë një kontroll rigoroz edhe të ketë dënime sa më të mëdhaja për shkak që edhe duket keq edhe nuk i ka hije Prizrenit. Çështja tjetër për drejtorin e shërbimeve publike është për çështjen e pjesës së Keit në Shadervan cila është rregulluar, po çka kam observuar sidomos gjatë vikendit ku ka shumë fëmijë aty, është muri është tepër i ulët. Tash është edhe një pjesë tjetër mbrapa që është prej dheut ndoshta munden aty me vendos ndonjë hekur a diçka mbrojtëse, sepse jashtëzakonisht shumë është rrezik për fëmijët aty, është tejet e ulët dhe mundet me ndodhë ndonjë fatalitet. Edhe çështja e fundit është, çështja e infoqendrave turistike. Drejtor, unë e di që ju jeni, domethënë, tash të ri këtu në turizëm, po meqë ka shumë turista, të cilët vijnë me grupe dhe pa grupe, mendoj që duhet ta merrni shumë seriozisht çështjen e infoqendrave, infoqendrave aktive, sepse ato infoqendra ekzistojnë, po fatkeqësisht nuk operojnë. Edhe, a keni ndonjë plan për këtë aktivizimin e këtyre qendrave edhe ndonjë çështje që mundeni me na informu neve. E fundit është çështja e borxheve, çështja e pagesave, çështja e domethënë që kryetari vazhdimisht ka filluar një fushatë mediatike me bë, unë do të doja ta kishim këtu kryetarin edhe t'i diskutojmë këtu ato

çështje, sepse nuk është mirë me dalë në media ku je vetëm një person e nuk ke ndonjë kundërargument me i tregu qytetarëve se pse janë këto borxhe, ose pse kaq shumë mungesë të parave publike. Në këtu vazhdimisht kemi kërkuar, sidomos te pika e buxhetit, mos bëni kësi lloj planifikime se do të mbetet keq komuna. Tash po e shohim që këto keq planifikime, keq klasifikime po i kushtojnë vetë kryetarit. Nuk ja ka fajin qeveria që ai është deklaruar që është menaxher i mirë, po tash po del që nuk është menaxher i mirë. Unë i bëj thirrje kryetarit që mos dezinformon qytetarët, nëse ka ndonjë betejë me nivelin qendror, mirë kishte me qenë me dalë me kandidu edhe me shku atje ku i ka synimet, por jo nga niveli lokal me pas betejë me nivelin qendror. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Dafina. Fjala për ju Alban Bislimaj.

Alban Bislimaj (PDK): Faleminderit kryesues. Përshëndetje ekzekutiv, kolegë kuvendarë, media, qytetar. Kërkesa ime ka të bëjë me drejtorinë e urbanizmit. Është një kërkesë që ka të bëjë me një sigurim të hapësirës publike për poligon të autoshkollave. Këtë çështje e kam ngritur edhe mandatin e kaluar. E di që edhe kolegët kuvendar e kanë ngritur të partive të tjera, por nuk kemi marrë përgjigje akoma për një poligon të tillë. Arsyeja pse po e paraqes këtë kërkesë është sepse aktualisht autoshkollat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në dy vende. Domethënë është te stacioni i autobusave që mbahen provimet të kategorisë B dhe është qendra e biznesit që mbahen kategoritë e rënda, domethënë janë kategori C, D dhe CE. Në momentin që krijohet një hapësirë publike për autoshkollat, kishte me qenë një zgjidhje shumë e mirë, domethënë për autoshkollat sepse në momentin që funksionalizohet qendra e biznesit autoshkollat nuk kanë ku të ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Normalisht që autoshkollat kanë edhe poligon privat, por për kategoritë e rënda poligoni privat nuk është i mundshëm të realizohet një punë e tillë. Andaj një hapësirë e tillë kishte me qenë konvencione që për mendimin tim që të jetë diku në periferi të qytetit që mos të ngarkohet edhe qyteti pasi që ne e dimë që autoshkollat krijojnë edhe tollovi në trafik, e konkretisht rruga se ku bëhen provimet e ku ushtrojnë kandidatë autoshkollat është bash në zemër të qytetit edhe një rrugë e cila është shumë e ngarkuar domethënë është rruga që shkon nga Galeria Abi Çarshia që është një rrugë jashtëzakonisht e ngarkuar. Ideja ime është që ITP-ja është një vend shumë ideal tash me mund me bisedu me ta, ka hapësirë të mjaftueshme edhe vendi si vend është shumë ideal sepse nuk është larg qytetit, pasi që ushtrimet apo provimet duhet të realizohet një pjesë në qytet, një pjesë jashtë qytetit dhe jo veç jashtë qytetit dhe për sigurinë e autoshkollave është vend i mirë, pasi që rruga aty i ka dy shiritat dhe hyrja dalja domethënë e ka shiritin për kyçe dhe për shkyçe. Kështu që mendoj që vend më të mirë nuk ka në Prizren, por nëse s'realizohet aty është edhe te tranziti i moçën, që mendoj ka hapësira publike që me nda për autoshkollat. Është interes edhe i komunës mendoj, pasi që autoshkollat paguajnë qira aty në lidhje me atë poligon, e di sigurt se paguajnë edhe në stacion, paguajnë edhe privat. Për momentin që krijon komuna kushte të tilla, autoshkollat detyrohen me ju përgjigj komunës për me pagu një tatim, një qira për shfrytëzim të poligonit. Atëherë, mbesë me shpresë që kjo kërkesë të realizohet, sepse është me të vërtetë shumë e nevojshme, pasi që edhe njëherë po e potencoj, Qendra e Biznesit veç është, po mendoj që është në përfundim dhe në momentin që funksionalizohet, ata veç kanë me u blloku me provime dhe ka me u bë kauzë, domethënë, sa i përket punës së tyre. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, Alban. Fjala për ju, shefi i grupit të Partisë Demokratike, Arianit Berisha.

Arianit Berisha (PDK): Përshëndetje edhe njëherë. Një replikë për shefin e grupit të Lëvizjes Vetëvendosje. Foli në emër të Partisë Demokratike. Foli në emër të grupit tonë. Po unë jam i bindur, po se janë të gëzuar, të pagëzuar, kështu diçka, pak e rëndësishme. Unë jam i bindur me gjithë respektin Dafina, ti nuk je në gjendje me fol as për grupin tënd. Këtë e kemi parë shpesh herë prej reagimeve të juaja kur disa prej kolegëve tu kanë folur, edhe tek pjesa e keqinformimit që e përmendi kolegu më herët, por edhe ju për kryetarin. Keqinformim po bëni ju, për shkak se kryetari në atë intervistë ka konstatuar gjendjen se çka ka ndodhur. Tash ndoshta duhet me ju sqaru pak juve se nuk e dini, por me siguri e keni për propagandë, për çka jeni eksperta. Në momentin që përmbarusi po i merr mjetet nga kategoria e kontratës kolektive, ato mjete po janë të destinuar për x kontrate ose për x operatori. Atëherë, gjatë atij viti fiskal, ti po mbet pa të holla, ajo po bëhet borxh, kur ai po bëhet borxh është operatori po shkon po e merr te përmbarusi. Ky është zinxhiri, ky është sqarimi i drejtë për qytetarët se çka po ndodh. Pra, për atë nuk është që po ja lënë fajin atij ose këtij tjetrit. Kjo është konstatimi i gjendjes se çka po ndodh. Ne po e shohim. Edhe sikur kolegu ta kishte hallin e atyre kategorive që kanë mbetur pa i marrë ato subvencione, e kishit kaluar buxhetin gjatë mandatit të kaluar në muajin korrik, kur është thirrur seanca. Nuk e keni kaluar. Buxheti sivjet është vonuar më shumë se kurrë diku në fillim të këtij muaji kanë filluar me u transferu mjetet prej buxhetit qendror, prandaj kjo është konstatim i gjendjes reale se çka po ndodh. Keqinformim është ajo që ju po e bëni, por qytetarët besoj që deri në këtë nivel janë të vetëdijshëm me e kuptu propagandën që ju e bëni vazhdimisht. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjala për ju Dafina Alishani.

Dafina Alishani (LVV): Kolegu më duket e keqkuptoj përurimin tim, PDK-ja nuk është vetëm në këtë sallë. Edhe PDK-në nuk e përfaqëson vetëm asambleistët. Ka qytetarë të cilët e kanë votuar PDK-në edhe vijnë tash ankohen ose e bëjnë një pakënaqësi qoftë te ju, qoftë te ne. Njëjtë sikurse qysh vijnë edhe të Lëvizjes Vetëvendosje, bisedojnë me juve, e shprehin ndonjë pakënaqësi. Problemi është që ju s'e keni guximin me i tregu pakënaqësinë në kuvend ndaj kryetarit. Po shkoni nëpër kafe edhe i bëni i shfaqni pakënaqësitë që i keni brenda juve tek ne, që ne me fol. Ne e kemi guximin, ne e kemi pasur edhe mandatin tonë, e kemi edhe tani, nuk e kemi hall atë punë. Ju duani me u sqaru me veten që s'po keni guxim me diskutu çështjet e juaja. Që këtu, qekjo është halli juaj. Tash që atakon, që na na etiketon neve, ajo nuk është hiç problem se ne jemi të trajnuar prej kryetarit juaj edhe prej drejtoreshës të juaj, me u quajtë edhe shpifsa, edhe propagandues, edhe të gjitha. Sa i përket keqklasifikimit edhe buxhetit ne i kemi i kemi thënë komentet tona. Unë nuk mund me votu një buxhet i cili një kategori ose një linjë buxhetore që ka çmim 400.000 euro llogaritet ose inicohet me 10.000 euro, zotohet me 10.000 edhe pastaj mbetet ajo. Problemi është këtu. Ju i keni tejkalluar komplet planifikimet që i keni pasur. Jeni i keni përshpejtuar disa punime veç për hirë të fushatës. Tash e kemi edhe një pikë, e cila ka me qenë në rend ditës, është bërë busti, është bërë komplet lapidari, tash vjen puna me votu buxhetin. Ju duheni me u shqetësu për këto çështje? Duheni me u shqetësu qysh ky keq menaxhues, i cili këtu është thirrur për menaxhim të mirë, tash nuk po din me menaxhuar. Ju duheni me u shqetësr për një qeverisje që ka pasur suficit me vitet të tëra. E ka tejkalluar suficitin të cilën e ka përqeshur nëmandatin e kaluar. Normal

që qeveria qendrore ka me të marrë suficitin. Nuk ta le, se nuk ke ditë me e shpenzu. Çështja e kontratës kolektive është çështje tjetër. Po të ishit të kanë sinqertë me qytetarët edhe të kishin qenë për çështjet kolektive, në planifikim të buxhetit nuk kishit bërë qesi planifikimi fort shkep qysh ja keni bërë. Ju çështje të cilat kushtojnë miliona, ju e keni futur në buxhet vetëm me bë pazare me kuvendarë me ja u marrë votën. Qytetari këtë e din. Tash mos dilni me na ku ka këtu me thënë valla s'po kemi mjete. Keq menaxhimi, keq qeverisja ju ka pru këtu. Jo me dalë me bë propagandë në media. Pse nuk del kryetari jot, këtu me u ballafaqu? Sa herë që ka kritika e liron sallën. Është lehtë me dalë në media dhe me folë me veten. Është shumë lehtë. Unë mendoj që duheni edhe ju si parti edhe si grup pak me kërku edhe llogari prej kryetarit juaj. Nuk është keq me kërku llogari. Apo jeni komplet çka do që thuhet, ndoshta vazhdoni ashtu. Po nuk është çështja që unë flitem për PDK-në. Edhe inshallah kurrë s'më bëhet me fol për PDK-në.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju, Selman Sokoli, në të përgatitjet Arianit Berisha.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesues, në dy mandatet e fundit, shef i grupit parlamentar të kuvendarëve të Vetëvendosjes, ka qenë një aktivist për ne i zellshëm, sekretar shumë i suksesshëm një qytetari i Prizrenit, Karanfil Haxhillari. Edhe në këtë mandat e kemi një kuvendare për mandatin e tretë, një vajzë e qytetit Prizreni, një vajzë e respektume edhe e votuar shumë. Në mandatin në zgjedhjet e fundit ka qenë bartëse e listës sonë. Mirëpo dy mandate po i bëjnë në kuvendin komunal, PDK-ja e zgjedh shef një parashutist. Edhe në mandatin e kaluar edhe tash. Një person nuk e njohim ditën e parë në seancë, ditën e parë kryesues. Nuk është praktikë as në kuvend të Kosovës, as një praktikë demokratike parlamentare, këta nuk e njeh, veç PDK-ja nuk e njeh. Këtu sigurisht nuk ka mundur me i realizuar disa kërkesa të tjera dhe e përfillon. Tani lindin kësi probleme. Tjetra, jo vetëm për kontratën kolektive përmbarusi inkason të hyra mjete financiare prej komunës së Prizrenit. Jo vetëm prej kontratës kolektive, por që mos po përsërit, siç e tha kolegja, edhe nga keqplanifikimi, keqklasifikimi, keqbuxhetimi i buxhetit. Edhe normal ju vetë i inkurajoni përmbaruesit që me ju marrë mjetet përmes bizneset që me marrë mjetet përmes kontratës, përmes përmbaruesve. Tjetra, para disa ditësh e kemi pasur një aktakuzë për keqpërdorim, 18.000 euro vetëm në një miniprojekt. Paramendo sa fatura është fryrë në komunën të Prizrenit këto vite. Kështu që problemin duhet me gjetur aty. Vazhdimisht prapë kryesues ne jemi në pyetje, përgjigje te drejtorat, mundet me u çu nënkryetari i komunës, mundet me me na përgjigj, kryetari i komunës, ju jepni fjalën kuvendarëve të PDK-së, te te çështja, pyetje dhe përgjigje.

Simir Krasniqi (Kryesues): Nuk kemi dalë te përgjigjet e drejtorave.

Sekman Sokolaj (LVV): Pikërisht dhe pikërisht te pyetje dhe përgjigje, e bini fjalën këtij zotërisë. Edhe nëse e keni sinqerisht, drejtoresha e arsimit është kështu, sinqerisht nëse e keni. Nee dimë, drejtoresha e arsimit e din sa mësimdhënës dalin në pension. I kanë ditëlindjet ata njerëz aty ku kanë aplikuar, i kanë në kontrata. A i kanë ditëlindjet? Dihet sa dalin. Një ekonomist mesatar, Totaj është nën mesatar, në bazë sa e kemi parë kështu. Ne ekonomist mesatar e bën një llogari të thjeshtë. Kaq arsimtarë më dalin, paga jubileare, paga përcjellëse, kaq, kaq i merr përmbaruesi, edhe i ndajmë ato mjete, nuk i bëjmë probleme vetëvetes edhe komunës sonë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju Arianit Berisha. Le të përgatitet Adrit Krasniqi.

Arianit Berisha (PDK): Është e vërtetë që qytetarët e dinë. Edhe nëse keqmenaxhimi na ka pru këtu, opozita juaj konstruktive, a po e shihni ku ju ka pru? Ju e dini ku jeni kanë. Se po duhet me u kthy. Nëse qytetarët e dinë, qytetarët flasin me votë. Nuk di çfarë mesazhi tjetër doni prej qytetarëve për atë se çka ka ndodhur në mandatin e kaluar e se çka po ndodh. Unë ju kam thënë, ju vazhdoni me këtë qasje, mua personalisht më konvenon edhe Partisë Demokratike i konvenon kjo qasje. Po ju keni me pa në mandatin tjetër me këtë qasje se ku keni me mbërri. Sa i përket kolegut, veç ju kisha lutur një gjë. Le të ketë kujdes personalisht për cilësimet që i bën. Po të këqyri në sy Selman, të lutna cilësimet parashutist, i thuhet te shtëpia, me mu të lutem të kesh kujdes për cilësimet që i bën. Për çështje të tjera ne jemi këtu me diskutu edhe vazhdojmë të flasim. Faleminderit.

Selman Sokolaj (LVV): A t'ia përsëris se në mikrofon ma ka dhënë? Një person që për herë të parë vjen në kuvend komunal, është bërë shef i grupit. Po ja përsëris edhe një herë, parashutist mundet me u konsideru. Për shkak se nuk e ka një përvojë që e ceka grupi parlamentar i Vetëvendosjes. Sa i përket asaj ku jemi, ai personi që po mungon, pesë vite merret me Albin Kurtin. I treti në zgjedhjet nacionale ka dalë në fshatin e tij në Gjonaj. Kështu që edhe ne ju inkurojmë juve të vazhdoni në këtë metodë të bërit politikë. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Arianit Berisha, replikë.

Arianit Berisha (PDK): Kur të vjen dita me na shit mend se qysh me vepru si grup parlamentar, po detyrohem me u kthy, domethënë kemi arritur rekord në numrin e votave për shkak të përkrahjes, se me na shit mend ju se qysh me vepru, qysh me organizu grupin, se di.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, fjala për ju Adrit Krasniqi.

Adrit Krasniqi (PDK): Faleminderit kryesues, të nderuar koleg drejtor, të nderuar koleg asamblist. Nuk dashta me u kyç po mbasi një koleg më quajti parashutist në Partinë Demokratike, domethënë ky koka më herët në Partinë Demokratike se ne. Baza familjare e imja edhe shefit aktual të grupit kuvendarë të PDK-së daton qysh para luftës në këtë parti. Njëherë në UÇK, pastaj në PDK. E imja personalisht ka filluar para vitit 2010, pastaj 2018-ën si kryetar i i strukturës rinore të Partisë Demokratike. Sot jam mandati i dytë si kuvendarë i Partisë dhe shumë krenar i Partisë Demokratike. Por të kthehem te kolegu, ku e ka lënë partia e vetë? Një asamblist të thjeshtë. Ai nuk ka mundur me e kapërcyer këtë fazën e asamblesë. Sa na shikon dhe sa mirresh me PDK-në, mirë është me shiku partinë tënde dhe ku keni qenë ju mandatin e kaluar ku keni mbetur, se po më duhet me përsërit fjalën e kryetarit të LDK-së. Keni mbetur një grusht asambleista qaty.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjala për ju Karanfil Haxhillari.

Karanfil Haxhillari (LVV): Meqë. Për shitje mendsh po nisem, Arianit ka disa seanca që ju jeni duke shitur mend dhe po na shitni mend neve. Dhe në këtë rast unë jam, ky është mandati i tretë i imi. Asnjëherë nuk ka ndodhur që kuvendarët ta bëjnë zëdhënësin e ekzekutivit, por në këtë mandat po shihet që po. Dhe këtu është vërejtja jonë që ne të gjithë këtu jemi përfaqësues të qytetarëve, jemi me votë të qytetarëve. Dhe neve i delegojmë ankesat, kërkesat, çështjet e qytetarëve në pikën e rendit të ditës. Dhe për me shit mend seanca me radhë ju i nderuar keni shit mend, po jo ne. Ne i kemi trajtuar çështjet, kemi bërë kërkesa, kemi bërë dhe në këtë rast se çka, sa kemi mbetur ne?

U panë zgjedhjet e fundit parlamentare sa keni mbetur ju. Për ne, po, qytetari është ai që vendos. Por po ashtu në Prizren u pa edhe në zgjedhjet parlamentare se çfarë manipulimi i votave u bë. Edhe ku e di unë që nuk është bërë e njëjta gjë edhe në zgjedhjet lokale. Por sidoqë të jetë, prapë është ai qytetari që të na vlerëson bre, si për opozitarizmin tonë, si për qeverisjen e juaj. Do ta shohim, është qytetari, por ama këtu të bëjmë ne të marrim zëdhënsin e kryetarit, sepse nuk vjen kryetari me u ballafaqu. Unë i kam pas një mëri pyetje për kryetarin. Themelon drejtori pa ju pyet juve. Pa e pyet këtë asamble. Në kundërshtim me statutin e komunës, në kundërshtim me ligjin për vetqeverisjen lokale. Në kundërshtim me gjithçka dhe nuk vjen këtu me u ballafaqu. Nuk keni vend edhe për drejtorat që i keni sa i keni bë. Nuk keni karriga për komplet drejtorat. Dhe tash folim real, të bëhemi realistelista pak.

Selman Sokolaj (LVV): Kryesues shumë shkurt.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po edhe shkurt mundësisht se po dalim prej temës, kemi mikat tjera dhe për këtë duhet të ndryshojmë edhe përgjigjet e drejtorave.

Selman Sokolaj (LVV): Kjo që po flasin kolegët është liria e asociimit. Në cilën duash subjekt, në cilën duash organizatë mundesh me asociu. Unë fola për kuvendarë që ka një përvojë të caktuar edhe që zgjidheni në pozita të rëndësishme. Nuk fola për anëtarësinë të subjekteve. Po besoj nuk ka qenë ndonjë keqkuptim me qëllim apo e kanë keqkuptuar. Domethënë unë fola për kuvendarët që kanë përvojë. Ndërsa këto personale, zoti Krasniqi është punësuar në një vend punës kur ka qenë menaxher i kontratës për shkak se të qenit asambleistë i ka disa kufizime ligjore. Kështu që duhet me u marrë me veten para se me na dhënë neve si ligjëratë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Arianiti e ka kërkuar mandej Adrit, e ta sqaron. Arianit fjala për ju. Veç mundësisht sa më shkurt që t'i dëgjojmë edhe përgjigjet e drejtorave.

Arianit Berisha (PDK): Kryesues, tashmë po më duhet me të dhanë vërejtje se më i shkurt se unë s'di a është ndonjë kush i shkurt, duhet me ju thënë këtyre me këqyrë a po respektojnë kohën, me gjithë respektin. Sidoqoftë që të jetë, Karanfil, ideja është kështu. Ju po thoni PDK-ja, ju po thoni grupi i PDK-së, unë nuk kam çare pa reaguarr burrë kur të na përmendni këtë gjë. Tani pjesa e shitjes mend, ti a po e dëgjon edhe vetë që po na tregon se qysh me bë. Na bashkë, bashkë me ditë që pikërisht ajo është rruga e suksesit vallahi nuk e zgjedhi atë rrugë ja mbaj tjetër kah, kur të vjen puna me na tregu ju ç'me vepru. Për atë unë po detyrohem me reaguarr Karanfil. Karanfil është obligim i secilit, kur dikush del edhe keqinformon, sidomos nuk ka haber me atë fushë, me pjesën e buxhetit dhe të financave. Detyrohem o burrë me dhënë një sqarim për qytetarët, se po ju drejtohesh qytetarve. S'ka të bëjë këtu, avokati i kërkuajna, po na detyrohemi nganjëherë do fjalë me i thënë, po na shtini me zorë, se domethënë, hiç nuk e marr fjalën, kështu prej dëshirës. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Arianit. Fjala për ju Adrit.

Adrit Krasniqi (PDK): Faleminderit kryesues. Jam i detyruar me përsërit fjalën e shefit të grupit që le të kenë kujdes me etiketime personale.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po, Dafina në emër të grupit.

Dafina Alishani (LVV): Në emër të grupit të Lëvizjes Vetëvendosje. Edhe i bëj edhe thirrje kryesuesit, edhe kolegëve, fjalët, kritikën, nëse nuk jeni në gjendje me i pranuar, lirisht lironi sallën si kryetari juaj që po liron, lirisht. E para. E dyta, Ardit, nuk është mirë bre me na dhënë neve këtu moral. Mirë është me dalë me na tregu neve si ka mundësi që ti derisa ke qenë punëtor i komunës, ke qenë menaxher i projektit, tash për shkak të ligjit ke dhënë dorëheqje prej punës edhe je i angazhuar në operatorin ekonomik që ka pasur kontratën ku ti ke qenë menaxher. Kjo është puro konflikt interesi. Po i bie që ti paske pasur një raport shoqnor ku ky operator ekonomik ose ke bërë dhe favor, këtu duhet me u hetu kjo kontratë, duhet me u hetu edhe ky punësim i këtij asambleisti. Nuk bëhet me qenë përgjegjës për kontratën, me dhënë dorëheqje se s'po ta lejon ligji edhe me u angazhu prapë në komunë përmes operatorit ekonomik. Është gjynah prej asambleistëve të tjerë që kanë dhënë dorëheqje edhe i kanë liru punët e tyre. Nëse po mundeni me rehatu ish-shefin e grupit juaj, rehatoni edhe këta të tjerë që kanë dhënë dorëheqje edhe janë obliguar me qenë vetëm me një pagë edhe vetëm me një orarë. Çka kanë më pak se ish-shefi i grupit juaj? Përveç punësimit tij, ka punësuar dhe familjarë mandatin e kaluar. Edhe tash del këtu, na shet moral, kush është këtu i mençur e kush nuk është i mençur, kush ka kontribuar për shtet e kush s'ka kontribuar për shtet. Kontributin secilit ne ja respektojmë. Po jo me na bë budall kaq lehtë. Duhet me dhënë përgjigje për qytetarët. Qysh ka mundësi si menaxher i projektit të angazhohesh në operator ekonomik? Qysh s'të vjen marre prej kolegëve të tjerë?

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju, Ardit Krasniqi.

Adrit Krasniqi (PDK): E nderuar kolege Dafina, me më ardhë marre, unë s'kisha dalë këtu para juve, para qytetarëve. Nuk besoj që është bërë krim, që mu me ardhë marre për diçka. E për marre, mirë është me këqyrë nga oborri juaj. E para. E dyta, kushdo që t'i ka dhënë informatat sa i përket kontratës së Kosova Medit, t'i ka dhënë të gabueshme. Nëse ke diçka, mundem me të ftu për kafe edhe me t'i shpjegu legjislacionin në fuqi, çka e lejon dhe çka nuk e lejon. Nëse s'keni jurist në partinë e juaj ja sigurojmë edhe atë. Nuk është telash. Sa i përket punësimeve familjare të mandatin e kaluar, unë e ti s'kena çka me fol. Unë e kam punësuar gruan, ti e ke bërë rektor vëllaun, dikush tjetër ka punësuar gruan e të tjera e të tjera. Domethënë unë e ti s'kemi çka folim për këtë temë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Po e përfundojmë po i dëgjojmë përgjigjet e drejtorëve. Tash mos dalim në personale.

Dafina Alishani (LVV): Për punësim, vëllai im ka qenë i punësuar shumë më herët, kur edhe PDK-ja i ka pasur rojtë në universitetin e Prishtinës, në universitetin e Prishtinës. Punësimet në qeverisjen tënde qysh i ke bërë e dimë krejt. Kosova Medi, mbasi aq lehtë po mundesh me shprehë Kosova Medin, pse nuk çohesh me i vetë, pse punëtorët e Kosova Medit nuk kanë marrë pagë qe tre muaj? Ata nuk e kanë luksin me dal prej Kosova Medit ose me u angazhu brenda dika si qysh je angazhu ti. Pse ti nuk po del në emër të këtyre punëtorëve me ngrit si shqetësim? Mbasi po thuni nuk jemi zëdhënës i qeverisjes, dilni edhe kërkoni të drejtat e punëtorëve, jeni kolegë. Për punësimet nuk ki çka na flet, vetëm nuk je korrekt ndaj asambleistëve të cilët kanë dhënë dorëheqje dhe janë vetëm me pagën e asamblesë. Nëse prapë po them, nëse po mundeni ish-shefin me rehatu, ju bëj thirrje edhe këta asambleistë të tjerë që kanë dhënë dorëheqje, aman shikoni edhe këta. Nuk është korekte kjo çka po flitni. Edhe ju lutem, domethënë çka do që flitet në emër të grupit, vetëm shefi le të flet. Nëse filloni tash, ose nuk po mundeni me tejkalu veten, shefi i grupit është Arianiti,

ai flet në emër të grupit edhe kaq. Edhe sa herë që bëhet replikë për Vetëvendosjen kryesues, nuk je patjetër me leju PDK-në. E ke shefin, e respekton edhe në rregull je.

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdojmë, vazhdojmë që nuk kemi fjalime të tjera nga kuvendarët, vazhdojmë me përgjigjet e drejtorave. Drejtori i punës dhe mirëqenies sociale Fatmir Memaj do t'ju përgjigjet pyetjeve të juaja.

Fatmir Memaj: Faleminderit. Meqënëse s'po punon mikrofoni im, po detyrohem prej kojshisë me marrë me shfrytëzu. Faleminderit shumë. I përshëndes kuvendarët edhe të gjithë të pranishmit tjerë. Sa i përket pyetjes që e bëni zonja Nerimane, nuk i kam informatat tash për tash, nuk mundem me ju dhënë sqarimet e nevojshme. Do të mundohem në afat sa më të shkurt, qoftë përmes emailit zyrtar apo edhe në seancën tjetër me shkrim do t'ju përgjigjem. Më duhet pak me bë një, mos me thënë komentnjë diskutim lidhur me kërkesën që e bëni edhe Selmani edhe në seancën e kaluar edhe tash. Është breng me të vërtetë edhe për mua edhe për çdo drejtues, se ne këtu jemi për interesat e qytetarëve, subvencionet, pra nëna lehona, vështirë se do të mundemi ne si komunë me e marrë barrën e përbalimit të kësaj kostoje financiare, përballë këtyre problemeve. Nuk jam unë kompetent me tregu a është çështja te kontrata kolektive apo është çështja të ndonjë fakturë tjetër e operatorëve apo vendime gjyqësore se në këtë në procedura përmbartimore shkojnë me sa di unë edhe do vendime gjyqësore që nuk e di, nuk kam informata a ka pasur gjatë këtij mandati ose gjatë këtij viti fiskal që kaloi edhe a do të ketë gjatë këtij viti. Por sidoqoftë, nuk hezitohet me diskutu edhe me u përpyek edhe në forma të tjera me e kry këtë shërbim ndaj qytetarëve, sidomos ndaj nënave lehona. Ju kisha lutur nëse ka efekt, kuptohet. Meqënëse në qeverinë e Kosovës është formuar Ministria e Punës dhe Familjes apo si emërtohet, mundësisht jam dakord edhe me mandermjetësuar një takim me udhëheqësit e Ministrisë, qoftë me ministrin, qoftë me ndonjë person përgjegjës, edhe me prezencën e juv dikuj që mundet lirisht me qenë në atë takim, edhe do të shikojmë formën se a ka mundësi edhe Ministria me na mbështet. Nuk kam hezitime me bashkëpunu me cilindo institucion, pavarësisht kush e udhëheq, edhe gjithmonë në të mirë të qytetarëve. Pse mos me provu me i zgjidhë këto probleme? Do t'i kisha qenë falenderues edhe unë, por sigurisht edhe më shumë falenderues do të kishin qenë edhe nënat lehona që kanë pasur rastin e lindjeve gjatë vitit të kaluar, por edhe gjatë këtij viti që do të kenë rastin. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor për përgjigjet. Fjala për ju drejtoresha e arsimit, zonja Luljeta Veselaj Gutaj.

Luljeta Veselaj Gutaj: Faleminderit i nderuar kryesues, të nderuar kuvendarë, koleg drejtor, media, të nderuar qytetarë. Kisha disa pyetje, po mundohem t'i përmbledh sa më shkurt për ta marrë kohën. Filloj me pyetjen e Eldisit, mungesa e mësimdhënësve në gjuhën boshnjake. Realisht drejtorja e shkollës e ka proceduar në kohë dhe ne si drejtorja e arsimit kemi proceduar në zyrën e burimeve njerëzore për ta hapur thirrjen përmes sistemit. Në profilin në farmaci është hapur thirrja, por është anuluar në mungesë të kualifikimeve adekuate. Po ashtu më vonë ka pasur edhe kërkesë për stomatologë dhe doktor që kemi proceduar, por ende nuk kanë dalë në sistem. Po besoj që gjatë analizës së fundit që jemi duke e bërë dhe me përgatitjen e konkursit për fund vit do të jenë edhe këto kategori te shkolla e mjekësisë. Sa i përket EPBRM-së, në komunën e Prizrenit ka funksionuar shumë mirë ekipi i EPBRM-së, ka qenë i përbërë nga drejtuesit të shkollës, mësimdhënës, shoqërisë civile e të tjerë. Është udhëzimi i cili i rregullon të gjitha çështjet dhe operimet edhe

shkollat po ashtu punojnë jashtëzakonisht mirë. Për këtë punë kemi marrë edhe mirënjohje nga Ministria e Arsimit për funksionimin e drejtë. Kurse pas marrjes së detyrës në mandatin e dytë, unë kam filluar me revidime e e vendimet dhe se di nëse administrata e ka përcjellë vendimin të cilin e kam nxjerrë ditët e fundit për ekipin e ri. Sa i përket pyetjes së zotit Haxhillai, zoti Haxhillari, informacione të pasakta po ju sjellin ata individë që ja japin. Sa i përket çështjes së mësimdhënësit dhe rastit që ka ndodhur në shkollën Gani Saramati, nuk dua të interferoj sepse është i prezantuar, i paraqitur në organet kompetente dhe presmi aktin final, sa i përket veprimeve të cilat duhet t'i ndërmerrë shkolla dhe drejtorja, janë ndërmarrë të gjitha. Sa i përket a është kryetar, a ka qenë kryetar i Këshillit të Prindërve? Thënë të drejtën, e përdor shpesh një koment kryetari që e ka thënë edhe në publik, se në komunën e Prizrenit janë mbi 400 punësuar, po i kemi 100 punëtor. Dhe këtu ndonjëherë në ekipet të cilat janë përgjegjëse, për katër vite zyrtari i cili është rekrutuar në kohën e Vetëvendosjes, nuk ka arritur me zgjedh kryetarin e Këshillit Drejtues dhe nga këshillat e prindërve kemi diskutuar me disa përfaqësues, zonja në fjalë e ka marrë përgjegjësinë se mundet me udhëheq për me udhëheq, me qenë pikë referuese për takimet me Këshillin e Prindërve. Për çështjet e tjera në fjalë mund të kërkon qasje dhe çka do tjetër, sa i përket vendimeve të cilat merren në komunë, të gjitha janë publike dhe ato mund t'i shihni. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtoreshë. Fjala për ju, drejtori i shëndetësisë.

Sylejman Baxhaku: Falenderit kryesues, të dashur kuvendarë, koleg drejtor. Sa i përket pyetjes së zonjës Shatri lidhur me krijimin e qendrave për trajtimin dhe rehabilitimin e personave nga varësitë, dua ta informoj se në qendrat tona ku ofrojmë shërbime shëndetësore, të gjithë pacientët që vizitohen ose që kërkojnë tretman shëndetësor ju afrohet aq sa i lejon ligji në fuqi. Çka mundet me bë komuna është të themelojë qendra sociale rehabilituese që japin këshilla psikologjike, që i këshillojnë të rinjtë që janë trajtuar paraprakisht që të mos rikthehen në rrugë të njëjta, por të gjitha këto, sipas ligjeve në fuqi në Kosovë, ligjeve të Kosovës bien në kuadër të shërbimeve sociale dhe nuk i takojnë shërbimeve shëndetësore që i ofron Drejtorja e Shëndetësisë. Natyrisht, në kuadër të shërbimeve shëndetësore këto ofrohen në sistemin sekondar dhe terciar, në kuadër të Spitalit dhe Qendrës Klike Universitare të Republikës së Kosovës. Sa i përket pyetjes së asamblistes Liridona, lidhur me problemet me ashensor dhe analizat që nuk po realizohen në kuadër të QKMF-së. Ashensori është e vërtetë që ka pasur disa probleme, por kemi marrë një vendim për fillimin e procedurave dhe po presim specifikacionet nga drejtori i QKMF-së. Realizimi i analizave ka vazhduar gjithmonë, natyrisht jo me normën e plotë për shkak të problemeve buxhetore që i kemi pasur. Dy herë jemi detyruar me hap një tender me vlerë të kufizuar për t'i përmbushur nevojat e qytetarëve me analizat themelore që duhen. Natyrisht disa prej analizave nuk lejohen të realizohen më në sistemin primar, siç janë tumor markerët e tjerë, sepse i takojnë sistemit sekondar dhe terciar. Ndërsa sa i përket pyetjes lidhur me subvencionet, për t'i futur në këtë grup edhe personat që vuajnë nga autizmi dhe që vuajnë nga Down sindroma, do të kujdesem personalisht dhe të shoh si janë mundësitë që edhe këta persona të përfshihen në listën për subvencionime. Ndërsa sa i përket pyetjes së Petrit Hoxhaj lidhur me fillimin e punimeve në AMF në Vlashnje, kjo ka qenë e planifikuar që punimet fillojnë sivjet, por natyrisht të gjithë e dimë se këtë vit ka mungesë të fondeve për shkak, të gjitha këto lidhen me tërheqjen e parave që janë bërë nga përmbaruesi lidhur me kontratën kolektive. Na vjen keq Petrit, vitin e ardhshëm kismet.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor për përgjigjen. Fjalën e ka drejtori i turizmit Adem Morina.

Adem Morina: Faleminderit kryesues. Pyetjen e parashtruar nga kuvendarja Dafina Alishani në lidhje me infoqendrat, se si është situata. Realisht i kemi tri infoqendra, të cilat janë në Prizren, dy janë në infoqendra, njëra është e farkatarët, kurse tjetra është në kuadër të IPA-s, që funksionon në Prevall. Fatmirësisht nga këto dy qendra, dyja janë edhe guida apo udhërrëfyes të cilat shërbejnë jashtëzakonisht shumë. Kurse si pikë e tretë është vetë drejtoria e turizmit dhe zhvillimit ekonomik. Por fatmirësisht duke pasur parasysh që në këto vitet e fundit çdo vit po rritet vizitorët dhe turizmi në qytetin e Prizrenit, planifikohet që të rritet edhe të ketë më tepër infoqendra dhe gjithsesi udhërrëfyes. Po besoj që në vazhdim do të kemi edhe ngritje të kapaciteteve, ngaqë që Prizreni po shndërrohet thuajse qyteti apo kryeqyteti turistik i shqiptarëve dhe mbetet që në vitet në vijim t'i ngrisim edhe kapacitete, gjithsesi edhe investimet, si në aspektin e digjitalizimit dhe fushave të tjera investuese në Prizren. Urdhëro. Jo, nuk është. I përmenda, i kemi tre infoqendra. Është, thashë, një te rruga e farkatarëve, është një në privat, në kuadër të IPA-s që është edhe Drejtoria e Turizmit. Këto janë aktive këto tri qendra, kurse thashë që kemi nevojë akoma më tepër të kemi, po për momentin i kemi këto tri infoqendra. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Kemi drejtor të tjerë? Atëherë që nuk kemi, përgjigjet do t'i merrni nga drejtorat të tjerë me shkrim. A doni pauzë? E kemi, apo të vazhdojmë me pikat e rendit ditës? Atëherë 30 minuta ndoshta. Unë po them 30 po e di që vonon ja 30 minuta. Deri 45 minuta deri në ora 12:45. Dhe vazhdojmë me pikat të tjera.

PAS PAUZE

Simir Krasniqi (Kryesues): Kemi kuorum, jemi 21 në sallë. Pika e katërt është:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit vendimit për themelimin dhe përbërjen e Këshillit Komunal për sigurinë në bashkësi të Komunës së Prizrenit.

Ftojme të prezantohet kjo pikë nga iniciuesi i pikës. Këtu është pra iniciuesi, fjala për ju Idaim Kryeziu.

Idaim Kryeziu: I nderuari kryesues, të nderuar asambleistë, të nderuar ju të pranishëm këtu në sallë. Këshilli komunal për sigurinë bashkësi është një mekanizëm shumë i rëndësishëm për sigurinë publike. Andaj themelimi i tij është kompetencë e kuvendit dhe kompetencë e kryetarit komunal që të bën zgjidhjen dhe listën e përbërjes. Përbërja domethënë e Këshillit Komunal është në korniza ligjore dhe me institucionet relevante. Këshilli Komunal për Sigurinë në Bashkësi themelohet me mandat katërvjeçar me mandat të kryetarit të komunës dhe në bazë të udhëzimit

administrativ kjo listë domethënë është ardhur në kuvend për votim. Nëse keni diçka me shtu. Po, veç se këtu domethënë është bërë një plotësim-ndryshim në emrin të Këshillit të Prindërve. Pasi me vonesë e kemi marrë edhe vendimin që është themeluar Këshilli i Prindërve në nga Drejtoria e Arsimit. Nga Zihnie Gurmani në Hajrim Çengaj. Domethënë veç ky ndryshim ka me u bë, në vendim që do të jetë nga asambleja. Nëse ka diçka?

Simir Krasniqi (Kryesues): Mund të ulësh, në qoftë se kemi pyetje prej kuvendarëve. Karanfil Haxhillari.

Karanfil Haxhillari (LVV): Këtu e kemi edhe një anëtare meqëse ky mandat është katërvjeçar, për KKSBB-në, ne sipas sipas informacioneve që i kemi, zyrtarja për barazi gjinore, Mybexhele Zhuri, e dimë që këtë vit do të del në pension. A do të bëhet pastaj edhe një votim tjetër apo?

Idaim Kryeziu: Janë disa institucione këtu që me automatizëm shkojnë në këtë listë, pasi që veç është në ende në punë zonja domethënë ajo e vazhdon. Po pastaj shkojmë me një plotësim ndryshim të vendimit.

Simir Krasniqi (Kryesues): A ka pyetje të tjera?

Atëherë që nuk ka, e hedhim në votim me propozimin pra të Zihnie Gurmanit që të jetë Hajrim Qengaj. 30 janë të pranishëm. Kush është për? 29 pra janë të pranishëm. 29 Për. kundër a kemi? S'ka. Abstenim? Nuk ka. Atëherë miratohet pika e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e pesë të rendit të ditës:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për shoqatën Zona e Pashtrikut.

Simir Krasniqi (Kryesues): Para se të hapim diskutimin, një sqarim të vogël këtu. Kërkesa, pra, ju e kemi marrë materialin me kohë dhe kërkesa nga Zona e Pashtrikut është bërë më herët. Dhe për pamundësi buxhetore që t'ju kryhet obligimi i komunës së Prizrenit, këtu përveç komunës së Prizrenit kanë participuar edhe komuna të tjera, komuna e Rahovecit, komuna e Suharekës dhe komuna e Malishevës. Dhe prej korrikut ju e dini që mundësitë buxhetore kanë qenë të pakta ose s'kanë mund që t'ju kryhet obligimi në shtatoren ku është ndërtuar pra të Tahir Sinanit dhe komuna e Prizrenit e kryen pjesën e vet që e ka dhënë si zotim. A do dikush ta merr fjalën? Po, Karanfil, fjala për ju.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesues, në bazë të kësaj të cilët, të cilën e vërejtëm neve, domethënë tash neve do të votojmë ndarjen e mjeteve financiare për shoqatën zona e Pashtrikut për mbulimin e shpenzimeve lidhur me projektin e shtatores Tahir Sinani. Që i bjen, normal që nuk jemi kundër shtatores të komandantit dhe komandantit i zonës operative të pashtrikut Tahir Sinani. Nuk jemi kundër, mirëpo duhet ta sqaroj apo duhet të them diçka lidhur me këta. Kjo i bjen që kjo shtatore u ngrit në kohën kohë fushate. Dhe këtu participimi apo organizatori i ngritjes së kësaj shtatore ka qenë shoqata zona e Pashtrikut. Por që në fushatë është

bërë politikë dhe është tjetërsuar kjo si meritë e kryetarit për ngritjen e kësaj shtatore, sepse fort mirë e dimë që kur u promovua shtatorja, domethënë u bë edhe në suazat të fushatës. Dhe sot ne normal që do ta votojmë ndarjen e 30.000 eurove për shoqatën, sepse nuk jemi kundër shoqatës, por që i kemi kritikuar tona dhe vërejtjet tona, sepse me këta është bërë fushatë në kohën e fushatës nga ana e kryetarit të komunës. Pra, ta sqarojmë qytetarin e komunës së Prizrenit që shtatorja Tahir Sinani në parkun e qytetit është organizim i shoqatës Zona e Pashtikut. Kuptohet tek tash është ndërtuar ajo, është promovuar dhe është preh shiriti, kurse tek tash ne si kuvend votojmë për ndarjen e mjeteve për këtë shoqatë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Politikë nuk ka në shtatore Karanfil, po është puna, mundësia buxhetore nuk kanë mund komunat. Unë sa di që edhe komuna Suharekës ka problem, edhe pse është zotuar që do t'ia kryejë një pjesë dhe s'kemi çka të ngjasim këtu. Unë nuk e shoh që mundësia nuk ka qenë që të kryhet më herët pagesa. Që nuk kemi, e hedhim në votim. Konstatojmë që në sallë jemi 31 kuvendar. Sa jemi për? Unanimisht votohet pika e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e radhës:

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për themelimin e komisionit dhe emërimin e anëtarëve të komisionit për emërimin e rrugëve, shesheve dhe lagjeve në komunën e Prizrenit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Pasi që në planin e punës së kuvendit si iniciues ka qenë Bajram Kastrati që të futet në planin e punës pra që të zgjedhet ky komision, kisha kërku Bajram Kastratin nja dy fjalë rreth këtij komisioni. Për ju fjala Bajram Kastrati.

Bajram Kastrati (LDK): Faleminderit kryesues. Meqë herën e kaluar ishim në komision që kemi punuar në këtë drejtim dhe procedurat për plotësimin e listës së rezerve dhe procedura të tjera kanë mbetur në gjysmë për arsye të përfundimit të mandatit. Edhe propozimi ka qenë që të vazhdojë me ato procedura, propozimi për themelimin e komisionit tanishëm. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit zoti Bajram. Do dikush tjetër fjalën? Po, fjala për ju Karanfil Haxhillari.

Karanfil Haxhillari (LVV): Katër vjet është punuar nga ky komision edhe me metë në ngjys Bajram. Unë e kam thënë edhe kur është themeluar herën e parë ky komision. Ekziston një udhëzim administrativ në kuadër të agjencionit kadastral të Kosovës, ku e ndalon secilën komunë, jo veç komunën e Prizrenit, për ndryshime të rrugëve për 10 vite të ardhshme, që i bjen, ky udhëzim administrativ është nga 2019-ta, që i bjen deri në 2029-ën. Nuk, pavarësisht punës së mirë, vullnetit të mirë dhe angazhimit të mirë, por që kjo prapë edhe ky komision prapë do të, edhe në qoftë se punon katër vitet e ardhshme, që mundet prapë me mbet në gjysmë procedimet administrative, konsideroj që prapë për shkak të këtij udhëzimi administrativ nuk do të lejohet asnjë ndryshim apo ndryshim për emrimet e rrugëve dhe shesheve.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Karanfil. Fjala për ju Bajram Kastrati.

Bajram Kastrati (LDK): Po, është e vërtetë që na ndalon udhëzimi administrativ. Megjithatë, në vitin e fundit na ka lejuar që ta bëjmë listën rezervë të emrave, ta plotësojmë do thotë listën rezervë edhe kemi mundësi ta bëjmë emërtimin e rrugëve të reja që ka shumë rrugë të reja që presin me u emërtuar. Ndryshimin është e vërtetë deri në 2029-ën që s'mund me bë ndryshimin e emërtimeve aktuale. Përderisa tashë e kemi hapësirë e mundësi me bë emërtimin e rrugëve të reja edhe plotësimin e listës rezervë, ky komision sigurisht që do të ketë punë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Bajram. Don dikush tjetër fjalën? Atëherë që nuk ka, i marrim propozimet pra nga partitë politike. Përfaqësuesi nga subjekti politik PDK-ja, Arianit.

Arianit Berisha (PDK): Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, propozoj kuvendaren Trëndelinë Kastrati.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit shefi i grupit të PDK-së. Përfaqësuesi nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje.

Dafina Alishani (LVV): Lëvizja Vetëvendosje propozon Ilir Gashi.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, përfaqësuesi nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës.

Qemal Krasniqi (LDK): Grupi i kuvendarëve të LDK-së propozon Bajram Kastrati.

Simir Krasniqi (Kryesues): Përfaqësuesi nga Bashkimi Demokratik.

Sefidin Islamaj (BDP): Bashkimi Demokratik propozon Shukri Quni.

Simir Krasniqi (Kryesues): Përfaqësuesi nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Nazife Kokollari (AAK): Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës propozon Nazife Kokollarin.

Simir Krasniqi (Kryesues): Përfaqësuesi nga Nisma.

Albulena Balaj Halimaj (NISMA): Nisma socialdemokrate propozon Albulena Balaj Halimaj.

Simir Krasniqi (Kryesues): Përfaqësuesi nga lista Guxo.

Petrit Hoxha (GUXO): Përfaqësuesi nga lista Guxo propozon Petrit Hoxha.

Simir Krasniqi (Kryesues): Përfaqësuesi nga subjekti politik Vakati.

Eldis Abazi (VAKAT): Koalicia Vakati predlaži Eldis Abazi.

Simir Krasniqi (Kryesues): Përfaqësuesi nga subjekti politik SDU.

Dzengis Salihi (SDU): Socialdemokratska Unia predlaže Dzengis Salihi.

Simir Krasniqi (Kryesues): Përfaqësuesi nga subjekti politik NDS.

Zikrete Aliti (NDS): Zikreta Aliti

Simir Krasniqi (Kryesues): Përfaqësuesi nga subjekti politik YTHP.

Sevil Kazayzi (YTHP): Sevil Kazazi

Sevilaj Hapci (KDTP): Më fal kryesues edhe KDTP. Kosova Demokratik Turk Partisi, Onur Kovac.

Florent Ukaj: Nga Drejtoria e Urbanizmit Zana Belloda.

Simir Krasniqi (Kryesues): I lexojmë edhe njëherë pra, përfaqësuesi nga subjekti politik PDK-ja Trendelina Kastrati, përfaqësuesi nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje Ilir Gashi, përfaqësuesi nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës Bajram Kastrati, përfaqësuesi nga subjekti politik Bashkimi Demokratik Shukri Quni, përfaqësuesi nga subjekti politik AAK, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës Nazife Kokolari, përfaqësuesi nga subjekti politik KDTP Onur Kovaqi, përfaqësuesi nga subjekti politik Nisma Albulena Balaj Halimaj, përfaqësuesi nga subjekti politik Guxo Petrit Hoxhaj, përfaqësues nga subjekti politik Vakati Eldis Abazi, përfaqësues nga subjekti politik SDU Dzengis Salihi, përfaqësues nga subjekti politik NDS Zikreta Aliti përfaqësues nga subjekti politik YTHP Sevil Kazazi, përfaqësues nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Zana Belloda dhe përfaqësues nga shoqëria civile Prek Memaj. Këta janë propozimet që janë marrë.

Kush është për? Sa janë të pranishëm për momentin? 32 janë të pranishëm. Kush është për? Unanimisht kjo pikë votohet.

Kalojmë në pikën e radhës.

Shqyrtimi dhe miratimi, pika e shtatë, shqyrtimi dhe miratimi i propozimit vendimit për shfuqizimin e vendimit numër 001/001-60689 të datës 2 korrik 2020 për mënyrën e pagesës së taksës administrative për lejen ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifa për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ftojme të prezantohet kjo pikë nga iniciuesi i pikës, drejtori i urbanizmit, Florent Ukaj.

Florent Ukaj: Faleminderit i nderuar kryesues, të nderuar anëtarë të kuvendit, qytetarë dhe të nderuar ju media. Para ju sot paraqes për propozim vendimin për shfuqizimin e vendimit me numër 001/011-60689, të datës 2 korrik vitit 2020. Për mënyrën e pagesës së taksës administrative për leje të ndërtimit, lejen rrënimi dhe tarifa për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit, i cili është marrë në rrethana të veçanta gjatë pandemisë, me qëllim të lehtësimit e

qytetarëve dhe bizneseve përmes pagesës me këste. Duke marrë parasysh se ato rrethana tashmë kanë kaluar dhe duke u bazuar në përvojën praktike të zbatimit të këtij vendimi kemi identifikuar disa problematika konkrete që e bëjnë të domosdoshëm rishikimin e këtij vendimi. Kjo mënyrë e pagesës ka krijuar ngarkesë të panevojshme në drejtorinë e inspektoriatit duke bërë më të vështirë monitorimin dhe zbatimin e obligimeve. Unë besoj se Prizreni duhet të jetë vend ku projektet. Në rregull. Unë besoj se Prizreni duhet të jetë vend ku projektet milionëshe zhvillohen pa përmbushjen e plotë të obligimeve. Për këto arsye propozohet shfuqizimi i këtij vendimi dhe rikthimi në një formë më të qartë dhe më funksionale të pagesës. Dua të theksoj qartë. Ky propozim nuk paraqet rritjen të asnjë tarife. Nuk vendos asnjë barrë të re për qytetarët. Por vetëm heq një mekanizëm të përkohshëm që në praktikë ka rezultuar jo efikas dhe është marrë në kohë pandemie. Gjithashtu komuna e Prizrenit vazhdon të jetë ndër komunat me taksat më të ulëta në të gjithë Kosovën. Të nderuar anëtarë, ky është një vendim që sjell më shumë rregull, më shumë përgjegjësi dhe trajtim të barabartë për të gjithë, duke kontribuar dhe në një treg më të drejtë dhe më të qëndrueshëm në ndërtimin e qytetit tonë. Prandaj ju ftoj secilin që ta shqyrtoni dhe ta mbështesni këtë propozim-vendim. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor, e hapim debatin. Fjala për ju Petrit Hoxha.

Petrit Hoxha (GUXO): Faleminderit kryesues, i nderuar drejtor, rreth shfuqizimit të këtij vendimi kam disa pyetje se komuna të tjera si e kanë, do të thotë, a e kanë që mund të lejojnë pagesën me këste, apo veçanërisht komuna jonë e ka pasur në atë kohë? Dhe e dyta, nëse ne e shfuqizojmë këtë vendim, çka do të ndodhë me disa kompani të cilat ende nuk i kanë paguar këstet? Tani a do të dërgohen në përmbarues që të obligohen që t'i paguajnë këstet e mbetura apo ku do të jetë problemi me këto kompani? Dhe e treta ka të bëjë që ky vendim i shkon shumë më herët do të thotë me u shfuqizuar sepse ai që do me ndërtuar një objekt të madh ai normal që duhet me i paguar edhe obligimet komunale që duhet ndaj komunës. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues):Faleminderit Petrit. Dikush tjetër? Po, fjala për ju Karanfil.

Karanfil Haxhillari (LVV): Faleminderit kryesues. Kam pas disa takime me kompanitë ndërtuese, por unë do ta shtjelloj pak më ndryshe këtë çështje. Secili ndërtues i ndërtimit të lartë, domethënë, më herët me këtë vendim ka paguar me këste taksat komunale dhe lejet e tyre. Pra që ka qenë një lehtësim për biznese. Kurse tash çfarë po ndodh? Po ndodh që ky lehtësim t'ju hiqet bizneseve. A i bjen që ato biznese të cilët edhe na ju kanë ndihmuar në fushatat zgjedhore edhe jeni thirrur në lehtësim për biznese dhe tash po ndodh e kundërta, pra, po i hiqet këstet, lehtësimet dhe po i ngarkohet që përnjëherë me i pagu këto. Që unë konsideroj që nuk e besoj që ndonjë kompani ndërtuese, derisa e ka pasur me këste, nuk e ka bërë pagesën për këto. Dhe shtoja faktit që pothuajse shumica e ndërtimeve të larta edhe kanë kaluar edhe pa mbikqyrje. Mos ndoshta, në qoftë se kishim qenë më vigjilent si komunë, neve edhe në kërkesë të pagesave të kësteve dhe pak me i mbikëqyrë këto ndërtime. Në raport me që deri tash të gjitha ndërtimet pothuajse asnjona nuk është mbikëqyrë dhe nuk kanë edhe, nuk e di sa kanë pranime teknike këto. Prandaj unë konsideroj që ky vendim është thjesht për grumbullimin e të hyrave. Tashmë botërisht po dihet që komuna e

Prizrenit me buxhet është zero. Pra jo, përmbaruasi ja ka marrë paret, jo dhe kjo është forma më e lehtë për grumbullimin e të hyrave vetanake dhe për ngritje të buxhetit të komunës në kurriz të këtë rast të kompanive ndërtuese. Pra unë e shoh këtë thjesht grumbullim i pareve në formën më të shpejtë të mundshme për me e tejkalu këtë krizë financiare që ju ka kapluar si komunë. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. T'i marrim pyetjet njëherë prej të gjithëve edhe në fund të përgjigjesh drejtor. A kemi po, Selman Sokoli, le të përgatitet Dafina Alishani.

Selman Sokolaj (LVV): Faleminderit kryesues. Kjo politikë e ekzekutivit siç duket është në kundërshtim me ata çfarë proklamom, domethënë çfarë proklamojnë partitë e juve në nivel nacional që janë në opozitë. Edhe në Kosovë jemi dëshmitarë që shteti ka filluar me zhvendosur barrën doganore të bizneseve brenda Kosovës, ndërsa ju komplet barrën e ndërtuesve po doni me marrë vendim që me qit në fillim. Hala pa filluar puna me pagu miliona euro ndërtimtarët, që kjo në fund mundet me shkuar në dëm të qytetarëve normalisht si blerës të fundit të atyre banesave, për shkak se kjo mund të krijojë efekt zinxhir edhe të rriten shumë çmimet e banesave. Nëse flasim për rrethanat posaçme, rrethon më e posaçme si tani kur çmimi i naftës ka shkuar gati 2 euro për shkak të problemeve në lindjen e mesme, nuk ka. Mirëpo, për arsyet, secili mund t'i cekë disa arsye pse ka ardhur deri te kjo. Zoti Haxhillari i cekti disa nga ato, po unë kështu, shumë biznese në Prizren për shkak të qëndrimit të gjatë ndoshta në pushtet për shkak se gjatë sa keni qenë në pushtet edhe janë krijuar ato biznese e kanë përkrah këtu në komunën e Prizrenit, Partinë Demokratike të Kosovës dhe Lidhjen Demokratike të Kosovës. Madje, madje, kumbarë të koalicionit, për shkak se siç e dimë gjatë fushatës ka pasur shumë tallje, ka pasur shumë fyerje ndaj kundër kandidatit LDK-së për kryetar komune, mirëpo ai i ka përmbi të gjitha edhe ka nënshkruar koalicion me Shaqir Totën për të bashkëqeverisur komunën e Prizrenit në mandatin 2025-2029. Domethënë ata që kanë qenë kumbare, ata duhet me dit, me pas parasysh që ju çka po bëni për ta, kumbartë e koalicionit juve ju po i shpërbleni me një barrë shtesë. Për shkak se nuk mundem me marrë sytë këtu, nuk i ka paguar këstet. Këstet duhet me u paguar edhe nëse s'paguhen këstet ka metoda të tjera. Shteti gjithmonë ka mekanizma vetëm a do me i shfrytëzu. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju Dafina Alishani.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesues. Drejtori u sqarua edhe e arsyetoi këtë pikë që duhet me i ndihmu inspektoriatit. Nëse ka mbetur puna e inspektoriatit veç në këtë vendim, uroj që ka me u këndell inspektoriatit prej gjumit edhe ka me fillu me punu. Domethënë ju pa përgjegjësinë e inspektoriatave po e lidhni në këtë vendim që unë mendoj që nuk ka lidhje kjo. Inspektoriatin ose qeverisja juaj nëse ka në mendje me i ndalë ndërtimet pa leje, e ka terrenin. Nuk i duhet as këstet, as taksat, as kurrigjo. Ne kemi një neglizhencë totale të inspektoriatit. Edhe vetë fakti që e keni lënë në inspektoriat një parti tjetër e jo PDK-në, tregon shumë për qasjen e kësaj qeverisjes karshi ndërtimeve, e para. E dyta, me këtë vendim drejtor, a mos po i diskriminojmë bizneset e vogla, të cilët nuk i kanë kapacitetet si bizneset të mëdha që janë të afërt me pushtetin, e para. Edhe e dyta, a mos po i hapim derën më shumë bizneseve jashtë Prizrenit, që kanë

kapacitete të mëdhaja, edhe me e shkelë atë të voglin që është këtu, e që nuk ka mundësi e kapacitet me e bë pagesën e menjëhershme të lejes ndërtimore. Unë e di që ka mungesë të pagesave ose të kësteve, po këtu kemi problem me monitorim të duhur edhe me një qasje më aktive të drejtorive përkatëse. Nëse inspektoriati del në terren mbas secilës pllak me pa a është në rregull ndërtimi, atij ja lyp edhe dokumentin shtesë të pagesës e procedurave që i pret. Tash mos puna nga inspektoriatave po ja ngarkon edhe një përgjegjësi bizneseve edhe me i bë pagesën. Hallin e keni, qysh e tha edhe parafolësi, të hyrat vetanake me i rritë edhe me vazhdu ato pagesa të cilat po i presin me muj tana qytetarët edhe që nuk po mundeni me i dalë krahas borxheve që i keni bërë ju vetë. Mua po më vjen keq, ti je drejtor i ri e tash po mundohesh me vendime ad hoc me i ndihmu kësaj qeverisje që ka bërë borxhe pa nevojë. Unë mendoj edhe është dashur edhe qytetari me ditë këtë gjë, që nuk ka të bëjë hiç as pak ky vendim me punën në terren të inspektoriateve. E kisha mirëpritur ndoshta me rritur stafin e inspektoriateve, nëse njëmend e keni seriozisht për çështjen e ndërtimeve dhe kontrollin në terren, kjo është puro interes qysh me i rritur të hyrat vetanake edhe qysh me i paguar borxhet komuna.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit, fjala për ju Haziz Hodaj.

Haziz Hodaj (LDK): Faleminderit kryesues. Një vendim që është marrë në rrethanat të jashtëzakonshme dhe tani kërkohet të tërhiqet sigurisht që është shumë normale. Madje ne duhet të marrim shembuj se si bëhet në botë, si bëhet në komuna të tjera dhe gjithmonë kanë ndodhur, taksat komunale të ndërtimit e të gjitha të paguhen në fillim kur dihet leja ndërtimit gjithmonë janë paguar taksat. Dhe tash të krijohen gjithë këto kundërtënie, gjithë këto edhe thyerje, pse jo. Se ata qenka donatorët tonë e ne për shkak të donatorëve. Unë nuk e di, çka ka ndodh, po këtu zgjedhjet lokale i ka fituar Partia Demokratike, zgjedhjet nacionale, zgjedhjet të tjera i ka fituar Vetëvendosja. Tani nuk e di kush i shfrytëzon ata, ata donatorë më shumë, cila parti politike ka fituar më shumë nivel vendi dhe nivel lokal që i kanë donatorë? Ata donatorë realisht janë të gjitha partive. Dhe s'mundem me akuzuar asnjërën as tjetrën sepse ata për hir të biznesit të tyre bën vaki ju japin të gjitha partive, po dihet ku ju japin më shumë. Atyne që fitojnë më shumë, sigurisht ju japin më shumë. Andaj nuk është mirë këto demagogji këtu në kuvend sepse sinqerisht po bjen niveli edhe i debatit edhe i diskutimeve sa kanë herë po e ndinë veten njeri i keq që është pjesë e këtij kuvendi. Andaj mos e prolongoni shumë, se nëse nëse ka mbetur buxheti i komunës ose komuna me mbijetu me taksat e ndërtimit atëherë mos të ekzistojë hiç. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Fjala për ju Astrit Temaj.

Astrit Temaj (LDK): Faleminderit kryesues, të nderuar drejtor, të nderuar asambleistë. Faktikisht drejtori e e sqaroi shumë mirë, kjo është një vendim që u bëra në rrethana të jashtëzakonshme në kohë pandemie. Edhe shfuqizimi i këtij vendimi realisht e krijon edhe një filtër të parandalimit të problemeve eventuale në të ardhmen dhe probleme eventuale të investitorëve. Po ashtu të thuhet që kjo është pengesë për investitorët, është paksa absurde duke e ditur që mundësia e financimit tash është shumë e lehtë dhe kjo është barra e parë që i vendoset investitorit në mënyrë që ai pastaj të përfundojë projektin dhe është absurde të mendohet që një projekt milionësh, investim milionësh

mos me pas mundësi një shifër të vogël në krahasim me projektin me e pagu në fillim. Kështu që po na e përkrahim këtë propozim të drejtorit. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Adem Shabanaj e ka fjalën.

Adem Shabanaj (LVV): Faleminderit kryesues. Ashtu siç është marrë vendimi në kushtet të jashtëzakonshme në 2020-ën, po mendoj që ka qenë një vendim i mirë i Kuvendit të Prizrenit, për të pasur parasysh që ndërtuesve t'ju mundësohet një pagesë me këste. Një pyetje që e kam për drejtorin është, çfarë do të ndodhë me pagesat e mbetura me këste? Për lejet e deritanishme deri më sot, të cilat kanë pasur pagesat. Edhe a ka pasur ndëshkime për mospagesat e kësteve? A është ndërmarrë ndonjëherë ndonjë veprim nga Drejtoria e Urbanizmit për ndërtuesit të cilët kanë pasur vonesa në pagesat e kësteve? Fillimisht duket në shikim të parë që është një mënyrë më e lehtë për inkasimin e mjeteve për të hyrat komunale. Mirëpo është, po besoj që është një pengesë për investitorët, për ndërtuesit, sidomos të vegjël dhe të mesëm, sepse për ndërtuesit gjigand nuk po besoj që është problem ashtu siç e tha edhe parafolësi im, kur është një projekt gjigand, nuk është problem pagesa e lejes ndërtimore. Po mendoj që te ndërtuesit e vegjël dhe të mesëm rrezikon goxha shumë që të aplikojë për lejet e ndërtimit dhe kjo sigurisht që rrezikon edhe humbjen e vendeve të punës, rrezikon edhe zhvillimin ekonomik në komunën e Prizrenit. Po mendoj që bashkë me drejtorinë e inspektoratit do të kishte qenë më e udhës që të mbikëqyren dhe të penalizohen ata të cilët nuk i kryen pagesat, sepse nuk është që luan rol të madh të bëhet pagesa 100% apo të bëhet pagesa me këste. Ja cakton një kohë që po besoj që brenda një viti është më e kapshme të propozohet që një vlerë prej 50% të paguhet menjëherë për marrjen e lejes dhe pjesa tjetër të bëhet brenda një viti për pagesë me këste. Po mendoj që është propozimi më i mirë edhe për ndërtuesit, edhe për punëtorët të cilët punojnë në ndërtimet të larta. Mirëpo të bëhet mbikëqyrje pak më e rreptë prej drejtorisë së inspeksionit, për betonimin e pllakave. Kur bëhet betonimi i pllakave, nuk e di që inspektorët komunalë i kam parë ndonjëherë në vend punishte për të shikuar se si është vendosur armimi dhe si janë bërë punët e armaturës në objektet në fjalë. Të rishikohen lejet, sepse je drejtor që e ke marrë pozitën tash rishtazi, të shikohen lejet cilat janë dhënë deri tash e që nuk kanë filluar punë, ndoshta mund të ketë leje që duhet të rividohen, sepse janë dhënë në kundërshtim me ligjet në fuqi. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Adem. Po, Dafina.

Dafina Alishani (LVV): Më duhet edhe një detaj drejtor. Meqë po deklaroni që taksat e ndërtimit janë të ulëta, a keni plan me i rrit për me parandalu këtë çështje? Edhe a ka afat pagesës për domethënë nëse s'ka këste tash, si do të jetë afati i pagesës për lejen ndërtimore?

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Atëherë që nuk kemi diskutues të tjerë, japim fjalën drejtorit, pasi që drejtori mund t'ju jep përgjigje për çdonjërin që jeni drejtuar pra me pyetjet e juaja. Drejtor, fjala për ju.

Florent Ukaj: Faleminderit kryesues. Po lidhem, po shkojmë radhazi me Petritin. Petrit komuna të tjera unë sa kam mujtur me e kontaktuar së paku me komunën në Prishtinës dhe me disa komuna

që kemi bashkëpunim, të gjitha e kanë që pagesa e këtyre taksave bëhet në fillim para marrjes së lejes së ndërtimit. Kompani të cilat janë në procedurë, domethënë normal që vazhdon se me ata e kemi një, ja kemi lëshuar një vendim që duhet me u bë pagesa me rata dhe ato pagesa vazhdojnë me u bë me me rata. Te Karanfili që tha për grumbullimin, të jesh i bindur Karanfil, secili që unë si drejtor nuk jam, së paku unë si drejtor nuk jam nisur në atë në atë qëllim që të grumbullohet. Asi vetëm e kam pasur si goxha që problematikë na ka sjellë në drejtorinë e urbanizmit edhe unë nuk thashë që drejtoria e inspektoratit nuk mund, po është një barrë shtesë e panevojshme për drejtorinë e inspektoratit. Edhe për bizneset serioze dhe për bizneset ndërtuese të jeni të bindur që nuk është ndonjëfarë pengese. Unë edhe unë e kam pasur takime para me marrë vendimin edhe me biznese, edhe me grupe të ndryshme dhe nuk e kanë parë që ka me qenë një pengesë, ku me di çfarë pengesë e madhe që ata, përkundrazi, e qartëson tregun pak në qytetin e Prizrenit. Lidhje tjetër a ka pagesa, e kemi një afat Dafinë aty, deri në 30.000 euro është për 12 muaj, mbi 100.000 euro është për 18 muaj. Po ka, unë tash kur kam filluar me marrë me atë kam kërkuar nga secili zyrtar, që secili me ma bë nga një raport që sa kompani ka që nuk i kanë paguar ka këstet. Ka kompani që ka paguar këstin e parë dhe nuk ka paguar asnjë pagesë tjetër më. Ka ndoshta mbi 30 kompani janë. Edhe unë e kam kërkuar nga zyrtarët që të ma bëjnë një raport dhe ditën të vazhdim. Po sa të shfuqizohet kjo do të ndërmarrim hapat konkretë dhe ligjor ndaj atyre kompanive. Tjetra për këto të thjesht çështjet politike e kanë në vendin e fushatës kur të vjen koha aty Selman. I bëjmë edhe kumbarët e juv edhe kumbarët tanë, të përbashkët i kemi të gjithë. Nuk ke nevojë me u shqetësu a na hidhërohen neve ndërtuesit apo kush na kush na hidhërohet. Ju jeni ata që më së shumti i akuzoni ndërtuesit, ndërsa tash jeni ju ata që mundoheni me i dalë në ndihmë. Faleminderit.

Selman Sokolaj (LVV): A ban një pyetje drejtorit, pasi ma përmendi emrin.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor për përgjigjet, pasi tu ka përmendur emri mundësh me vazhdu.

Selman Sokolaj (LVV): Zotëri Ukaj, kështu për s'kthjellti, ju e merrni një vendim që praktikisht i rëndon bizneset. Praktikisht i rëndon bizneset. Edhe. Po ju e keni po biznesi nuk bën me u përzi me politikë, se tani lindin probleme të tjera edhe i bën pazaret. Qatë po them unë! E. Domethënë mirë që po pranon. Kështu që unë po them që jui keni marrë një vendim, më herët ka qenë me këste, po flas parimisht si qytetar. As nuk e njoh asnjë biznes ndërtimtar, veç po flas si qytetar, si asambleistë në këtë kuvend komunal. Ju e keni marrë një vendim për s'kthjellti që praktikisht i rëndon bizneset. Për shkak se nëse një shumë mundesh me e nda në disa këste, tash duhet me pagu përneherë, a nuk ju duket ky rendim? Edhe unë qëndroj prapa arsytiveve që i tha zotëri Haxhillari edhe Dafina. Se përndryshe nuk ka logjikë. Qysh çohesh në një mëngjes ti edhe thu, deri tash i ke pas më lehtë, nga sot e tutje unë kam me ta vështirësu. Sa i përket cilësimeve, sinqerisht ju kisha lut, cilësimeve kështu personale. Ne japim qëndrime për çështje të ndryshme. Ka asambleistë këtu pothuajse të gjitha legjislaturat. Janë model i servilizmit si koncept. Kështu që nuk ka nevojë me cilësu, me i fy kolegët kuvendarë, pa marrë parasysh a pajtohesh a jo. Për shkak se, e kam thënë edhe një ditë më herët, ky mospajtimi i juve me neve, a di çfarë do të thotë? Kryesuesi i kuvendit

komunal, përderisa është bërë drejtor, tërë kohën na bëjke presion, qysh duhet me qenë ne më të ashpër ndaj Shaqir Totaj. Qe sot e ke kryesues. Na bëjke presion qysh duhet me qenë më të ashpër, u bë drejtor edhe tash ne po flasim pa lidhje. Kështu që keni parasysh cilësimet se nesër hidhëroheni edhe ju keni me na thënë neve bravo bre, ashpërso pak kritikën. Kështu që ju kisha lutur pak respekt për kolegët edhe pak respekt për ata. Se edhe kur të flasim ne, anash nuk ka nevojë me me folur të tjerët kryesues. Secili e merr fjalën kur do, ju mundeni me ndal fjalën. Ne nuk kemi ndonjë mekanizëm tjetër përveç se me ndez mikrofonin, ju mundeni me fikë. Mirëpo këta anash duhet me qëndru të qetë edhe në vendet e tyre. Faleminderit shumë.

Simir Krasniqi (Kryesues):Do të ishte mirë me qenë në pikën e rendit të ditës e jo me dalë, me ra në qendër të vëmendjes me këtë debat. Nuk bjer në qendër. Votuesi nuk e kërkon këtë debat çfarë je ka e bën. Vazhdojmë me votim. Kush është për? Sa jemi prezent? 31. Kush është për miratimin e vendimit për shfuqizimin e vendimit numër 001/011-60689 të datës 2 korrik 2020 për mënyrën e pagesës së taksës administrative për lejen ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifa për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit. Kush është për? 22 për. Kundër? 6 kundër. Abstenim? Nuk ka. Atëherë miratohet pika e rendit të ditës pra pika e shtatë.

Kalojmë në pikën e tetë.

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit numër 001/011-68302 të datës 29.5.2025.

Simir Krasniqi (Kryesues):Ftojme prezantuesin e kësaj pike ose iniciuesin e pikës që ta prezantoj pra pikën. Fjala për ju drejtor Fatmir Memaj.

Fatmir Memaj : Faleminderit, kryesues. Sa i përket kësaj pike, duhet me thënë se kjo pikë lidhet me një vendim edhe me një vendim tjetër, që është marrë nga kjo asamble, përkatësisht nga përbërja e kaluar, ndoshta është me rëndësi, kuvendarët të cilët janë për herë të parë këtu me qenë të njoftuar, domethënë thjesht me qenë të njoftuar për këtë, lidhur me çfarë bëhet fjalë. Në mandatin e kaluar të kësaj asambleje është marrë vendimi për dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër organizatave të shoqërisë civile. Ky vendim ka të bëjë me një pronë, e cila është diku në pjesën e Tusuzit, andej nga rruga e varrezave në drejtim të Hoqës së Qytetit. Bëhet fjalë për ngastrën me numër 11048-17, zona katastrale e Prizrenit, në sipërfaqe prej 14 ari e 15 m2. Kjo është e parapamë, kjo ngastër për ndërtimin e objektit qendra e autizmit, që do të zhvillohen aktivitete të veçanta edhe do t'i ofrohen shërbime psikosocial e kësaj kategorie, nga aktivitete rekreative për personat me autizëm dhe personave të tjerë në nevojë. Atëherë, për sa i përket kësaj, është konfirmuar ligjshmëria nga ana e Ministrisë Adekuate në qeverinë e Kosovës dhe njëkohësisht është pezulluar zbatimi i këtij vendimi për shkak të se Kuvendi i Komunës nuk mund të merr asnjë vendim lidhur me dhënien e shfrytëzimit dhe këmbimin e pronës së paligjshme të komunës nga dita kur presidenti shpall zgjedhjet lokale. Kështu që në këtë kontekst këtë vendim e ka zënë afati i zgjedhjeve lokale që janë mbajt në nga për që për vërejen që jeni ju tani edhe sipas ligjit nuk ka të drejtë me i procedu më tutje këto procedura. Dhe në vendimin e ministrisë po ashtu

ceket se komuna pas konstituimit të organeve të komunës të dalura nga zgjedhjet lokale që do mbahen me datë 12 tetor 2025 mund të vazhdojë me procedurën mbi dhënien e pronës komunale. Pasi që për çdo vendim mbi dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, edhe njëherë harrova edhe diçka harrova me cekë një element se kjo pronë do të jepet në afat sipas procedurave mbi dhënien në afat shkurtër deri në 15 vite. Sa i përket kësaj pike, për secilin pikë që jepet, për secilin vendim që merret për dhënien e pronës në shfrytëzim, pronës komunale, do të formohet për secilin pronë nga një komision vlerësimi. Pastaj që zyra e prokurimit kur t'i udhëheq procedurat e ankandit, atëherë komisioni do t'i vlerësoj ofertat. Meqë në përbërjen e kaluar pothuajse asnjë përveç zotëri Ilir Gashi është që ka qenë në këtë përbërje, asnjë tjetër nuk është këtu në këtë as nga ekzekutivi as nga kuvendi i komunës i përzgjedhur, atëherë është shtruar nevoja e rishqyrtimit apo plotësim ndryshimit të këtij vendimi, duke i propozuar anëtarë të tjerë, për shkak se komisioni, domethënë, duhet të përbëhet nga anëtarë qysh e ka paraparë ligji, dy anëtarë nga kuvendi i komunës, dy anëtarë nga ekzekutivi, edhe një anëtar nga sektori joqeveritar, domethënë nga organizatat e shoqërisë civile. Edhe ky vendim ka qenë i pezulluar, domethënë njëjtë sikur vendimi që e cekëm paraprak më herët, mirëpo me zgjedhjen e kësaj përbërjeje të asamblesë, të këtij kuvendi komunal, atëherë mund të vazhdohet me procedurat. Kështu që, kryesues tani mund, nëse s'ka në pyetje dikush mund të merrni propozimet edhe nga kuvendarët edhe nga ekzekutivi ju që kush ju ka dhënë apo ju s'ju ka dhënë dikush. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor për sqarimet. A do dikush fjalën? Po, Selman Sekoli.

Selman Sokolaj (LVV): Shumë shkurt, drejtori atëherë nuk ka qenë në këtë pozitë. Të njëjtat argumentet që i përmendet ju drejtor, i kemi përmendur në asamblenë komunale. Edhe që të jeni në dijeni, çka kemi marrë është këto që po i dëgjoni nga krahu i majtë i imi. Kështu që edhe në të ardhmen mundet shpesh me ju përsërit situata të tilla. Faleminderit shumë për momentin. Besoj e kuptove shumë qartë.

Simir Krasniqi (Kryesues): A kemi diskutues të tjerë që nuk kemi, i marrim propozimet. Nga kuvendi komunal pra dy anëtarë, nga ekzekutivi dy anëtarë dhe nga sektori joqeveritar shqiptar. Atëherë shkojmë me propozimet nga Partia Demokratike.

Arianit Berisha (PDK): Propozoj kolegë Ymrane Fusha.

Simir Krasniqi (Kryesues): Nga lidhja demokratike.

Qemal Krasniqi (LDK): LDK propozon Astrit Temaj.

Dafina Alishani (LVV): Edhe pse nuk kemi pas nijet me propozu, po pse ky kalim kështu? A shkojnë grupet me numër të asambleistëve? Jo, nuk prish punë. Në çdo renditje i jep fjalë PDK-së, Vetëvendosjes, LDK-së, sipas numrave në kuvend, po sot paske vendos me shku kështu, pse po të konvenon. Komisionet kemi me ju lënë krejt. Kënaquni. Po veç renditjen të lutna mbaje qysh duhet me e mbajt. Së paku respektoj grupet që i kanë numrat e asamblistëve. Nuk mundet me qenë

një grup që i ka gjashtë asamblistë para grupit që i ka nëntë asamblistë. Të lutna mos e keqpërdor detyrën. Të lutna.

Simir Krasniqi (Kryesues): Vazhdojmë. Lëvizja Vetëvendosje ka propozime?

Dafina Alishani (LVV): Lëvizja Vetëvendosje tregoi. Krejt merreni. Krejt komisionet merrni, gllabroni.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Si grup parlamentar Bashkimit Demokratik, propozime?

Liridona Veçgishti (BDP): Nga grupi i Bashkimit Demokratik nuk ka propozime.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mirë, faleminderit. Atëherë, nga shoqëria civile është Ermal Morina, nga ekzekutivi Adem Morina dhe drejtori Fatmir Memaj. Nga kuvendi pra, zonja Ymrane Fusha dhe nga LDK-ja Astrit Temaj. Edhe njëherë, nga PDK-ja Ymrane Fusha, nga LDK-ja Astrit Temaj, nga sektori qeveritar Ermal Morina, nga ekzekutivi Adem Morina dhe Fatmir Memaj. Nga shoqëria civile thamë që Ermal Morina. Kush është për? 30 janë prezent. 23 për. Kundër? 5 kundër. Abstenim. Nuk ka. Atëherë miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës.

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për emërimin e komisionit, për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për përzgjedhjen e këshillave lokale.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ftojme të prezantohet kjo pikë nga iniciuesi drejtori i administratës. Për ju fjala zoti Bexhat Bytyqi.

Bexhat Bytyqi: Faleminderit kryesues. Përshëndetje ekzekutiv, të nderuar kuvendar, media, shoqërisë civile dhe të gjithë ata që punon dëgjojnë në këto momente. Në rend të ditës kemi paraparë edhe shqyrtimin dhe miratimin e propozimit vendimit, për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në teren për përzgjedhjen e këshillave lokale. Siç e dini edhe në mandatin e kaluar ka qenë ky komision, por me përfundimin e mandatit edhe ju ka skaduar mandati edhe atyre edhe komisionit të kaluar. Janë, në komisionin e kaluar janë përzgjedhur të gjithë kryetarët e bashkësive lokale, por tani qëllimi i këtij komisionit është që kryetarët të cilët në, kanë muj, kanë dhënë dorëheqje, të zgjidhen edhe njëherë, apo ndërkohë dikush prej tyre mund, mund të jep dorëheqje apo nuk ka dëshirë të merret me këto aktivitete dhe ky komision do t'i, përzgjedhë anëtarët e rinj të kështu këshillave lokal. Sipas rregullores, komisioni duhet të përbëhet prej shtatë anëtarëve, katër janë domethënë kuvendi, një nga ekzekutivi, një nga shoqëria civile dhe një është nga anëtar i përfaqësimit nga fshatrat apo vendbanimet urbane. Nëse nuk ka ndonjë pyetje, atëherë kryesues mundemi marrë edhe propozimet.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor për sqarime. A kemi pyetje? Po, Petrit Hoxhaj.

Petrit Hoxhaj (GUXO): Faleminderit edhe njëherë kryesues. I nderuar nënkryetar, sa është numri i kryetarëve të bashkësive lokale që nuk janë aktivë do të thotë ose që kanë dhënë dorëheqje? Dhe kjo ishte pyetja.

Bexhat Bytyqi. Po, Petrit, për momentin është vetëm një anëtar i cili ka dhënë dorëheqje. Është anëtar i lagjes 2 Korriku, Bazhdarhane. Ai ka dhënë dorëheqje. Berat Berisha, më falni. Po. Të tjerët janë të gjithë aktiv. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor, që nuk kemi diskutime atëherë i marrim propozimet pra. Po, Haziz Hodaj.

Haziz Hodaj (LDK): Për kryetarët në rregull, po brenda këshillit të fshatrave ka raste që janë tërhequr, këshillat e fshatrave po mendoj, domethënë anëtarë të tjerë të këshillit, jo kryetari po anëtarë të këshillit të tjerë. A mundet ata me i emëru, me i përzgjedhë vetë kryetari apo prapë duhet procedurë për zgjedhjen e tyre?

Bexhat Bytyqi: Normal që merret fshati apo lokaliteti ku janë ata i përzgjedhin jo ne. Ne vetëm i përzgjedhim kryetarët.

Simir Krasniqi (Kryesues): Fjala për ju Karanfil Haxhillari.

Karanfil Haxhillari (LVV): Meqënëse jam qenë anëtar i komisionit për përzgjedhjen e bashkësive lokale në mandatin e kaluar, zakonisht në çdo bashkësi lokale kur e kemi zgjedhur këshillin edhe dy janë në rezervë në listën e përzgjedhësve të këshillit, ku në qoftë se tërhiqet ndonjëri nga anëtarët e këshillit, ata dy rezerv i zëvendësojnë me automatizëm pa pasur nevojë për zgjedhje të reja.

Haziz Hodaj (LDK): Nëse edhe këta shfrytëzohen edhe këta rezerv dhe edhe këtë tre i jap dorëheqje, qysh zgjidhet çfarë i tregoj unë?

Karanfil Haxhillari (LVV): Jo, atëherë duhet me mbajti proces të rregullt zgjedhor. Atëherë me mbajti proces të rregullt zgjedhor.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mundësisht mikrofonin që për procesverbal.

Haziz Hodaj (LDK): Po në rast që kryetari i fshatit ma bëni një pyetje kur e dëgjoj që e kemi këtë pikë të rendit ditës, tha ai është tërhequr një apo dy anëtarë të këshillit, qysh mundet me u plotësu këshilli? Kaq. Po tash Karanfilin e tregoi. Po mirë do të ishte që ajo lista, nëse jo dy, po lista me u vazhdu atëherë sipas numrit të votave me u plotësu, jo proces zgjedhor ti me pasur për një anëtar të këshillit apo për dy.

Bexhat Bytyqi: Rregullorja e përcakton këtë dhe duhet me vazhdu sipas rregullores në fuqi.

Simir Krasniqi (Kryesues): Atëherë, i marrim propozimet që nuk ka diskutues të tjerë. Nga kuvendi i komunës, pra, nga PDK-ja, Arianit Berisha, propozimet.

Arianit Berisha (PDK): Propozoj kolegun Adrit Krasniqi.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Nga kuvendi i komunës anëtar, nga Lëvizja Vetëvendosje.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit që e morët parasysh kërkesën. Propozimi i Lëvizjes së Vetëvendosjes, Selman Sokolaj.

Simir Krasniqi (Kryesues): Edhe këtu do ta tejkaloj pra, nga Bashkimi Demokratik propozimi.

Liridona Veçgishti (BDP): Nga Bashkimi Demokratik, Sefedin Islamaj.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mundësisht edhe kuotën gjinore ta plotësojmë. Po, nga kuvendi i komunës anëtar komunitetit boshnjak. Kuotën gjinore mundësisht që boshnjak.

Zikrete Aliti : Zikreta Aliti.

Simir Krasniqi (Kryesues): Nga ekzekutivi, pra, drejtori i administratës, Bexhat Bytyqi. Nga shoqëria civile Eroll Shabani. Këto janë dhe përfaqësuesit nga fshati, pra, vendbanimet nga ato fshatra apo vendbanimet ku zgjedhën këto këshilla lokale të fshatrave. Edhe njëherë pra, përbërja është kjo, nga kuvendi i komunës, anëtar PDK-ja Adrit Krasniqi, nga Lëvizja Vetëvendosje Selman Sokoli, nga Bashkimi Demokratik Sefedin Islamaj, nga komuniteti boshnjak Zikreta Aliti, nga ekzekutivi, drejtori i administratës Behxhat Bytyqi, nga shoqëria civile anëtar Eroll Shabani. Mundësisht Bashkimi Demokratik se duhet me plotësu na kthejnë, duhet ta plotësojmë kuotën gjinore.

Sefedin Islamaj (BDP): Në rregull kryesues, Liridona Veçgishti është.

Simir Krasniqi (Kryesues): Edhe një mos po na kthejnë. Atëherë shkojmë pra me këtë përbërje. Nga PDK-ja Adrit Krasniqi, nga Lëvizja e Vetëvendosjes Selman Sokolaj, nga Bashkimi Demokratik Liridona Veçgishti, nga Komuniteti Boshnjak pra Zikreta Aliti, nga Drejtoria e Administratës, drejtori pra Bexhat Bytyqi dhe nga shoqëria civile Eroll Shabani. Të pranishëm jemi 33. Kush është për me këtë përbërje që të votohet? Unanimisht miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e radhës.

Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për emërimin e komisionit të ankesave për procespjesin e zgjedhjes së këshillave lokale.

Simir Krasniqi (Kryesues): Edhe në këtë pikë ftojme prezantuesin e pikës pra apo iniciuesin që ta prezantojë pikën e rendit të ditës. Për ju fjala drejtor.

Bexhat Bytyqi : Faleminderit kryesues. Edhe kjo pikë ka të bëjë me pikën paraprake. Domethënë këtu ka me u zgjedh komisioni për ankesa. Domethënë nuk kam çka me shtu, domethënë janë këto

pika. Tre anëtarë këtu kanë me u zgjedh. Kryesisht janë nga kuvendi domethënë komunal anëtarët duhet të jenë. Sipas rregullores domethënë lejohet vetëm anëtarëve të kuvendit. Tre nga ata.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor. Atëherë i marrim propozimet nga kuvendi i komunës pra anëtarë nga Partia Demokratike e Kosovës.

Arianit Berisha (PDK): Propozoj kolegun Driton Sallauka.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Arianit. Nga lidhja nga komuniteti turk.

Sevilaj Inci Abci (KDTP): Onur Kovaç.

Simir Krasniqi (Kryesues): Mundësisht kuotën ta plotësojmë.

Sevilaj Igci Hapçi (KDTP): Atëher Sevilaj Igci Hpaçi.

Simir Krasniqi (Kryesues): Nga Lidhja Demokratike.

Qemal Krasniqi (LDK): Astrit Temaj.

Simir Krasniqi (Kryesues): Kjo pra është përbërja propozim vendimi për emërimin e komisionit të ankesave për procesin e zgjedhjes së këshillave lokale. Nga Partia Demokratike Driton Sallauka, nga Lidhja Demokratike e Kosovës Astrit Temaj dhe nga komuniteti turk Sevilay Igci Hapçi.

Dafina Alishani (LVV): Më fal të pranishëm jam. Sipas çkafit i bëre këtë ndarje kështu. Nëse është ideja me i përfshirë të gjitha partitë që nuk kanë qenë përfshirë në vlerësim, atëherë pse PDK-ja me pas pjesë edhe në ankesa? Nëse jemi për të gjithë përfshirjen.

Simir Krasniqi (Kryesues): Kemi bërë gjithë përfshirjen dhe ka qenë më erët kështu dhe kemi shku që t'i përfshijmë të gjitha partitë. U konsultuan edhe me Lidhjen Demokratike që të jetë o te ankesat o te.

Dafina Alishani (LVV): Po ti nuk je përcaktuesi.

Simir Krasniqi (Kryesues): Nuk jam përcaktuesi, po në qoftë se ne shkojmë jashtë rregullores për përzgjedhjen, atëherë kthehet vendimi i jashtë ligjshëm.

Dafina Alishani (LVV): Po ju po referoni, veç pak, kadale, veç, ju po referoni që më herët është ka qenë praktika kështu, apo jo? Unë ju tregova në KPF qysh ka qenë praktika për komisione. Ka shkuar një emër prej pozitës dhe një prej opozitës, nëse do praktikat e kaluara. Nuk po kuptoj, sipas çkafit ju po determinoni kush jep emra apo jo. Për shembull, pse komuniteti turk po e pse jo komuniteti boshnjak? Nëse unë prapë thashë, heshta duke pasur parasysh që po i japim hapësirë partive të cilët nuk patën hapësirë në komisionin vlerësues. Nuk je ti ai që vepron ose vendos në emër të kuvendit. Të jesh pak i sinqertë dhe të lutna të jesh korrekt me kuvendarët.

Simir Krasniqi (Kryesues): Shumë korrekt Dafina jemi këtu edhe duhet ta dini që si opozitë, nëntë jeni edhe shumica është në pozitë në këtë pjesë edhe tash nuk e di se dy pozita me ta dhënë edhe në përzgjedhje edhe te ankesat juve, tash nuk ka logjikë kjo. Po s'është në rregull që tash përzgjedhja është çelsi është shumë i duhur edhe shumë adekuat për përzgjedhjen që e kemi bë.

Dafina Alishani (LVV): Bashkë me gjithë bërë logjika kryesore te komisioni i ankesave duhet me qenë dikush i opozitës. A e di pse? Për me ju monitoru pazaret e juaja, thjesht. Keni bërë pazar edhe në bashkësi lokale, i keni futur vetëm strukturat e juaja dhe i keni lënë përparsi atyre. Unë s'e di pse e keni hallin mos me lënë njerëzit me pas monitorim në punën e juaj. Puna jonë është me monitoru kryesues, nuk kemi punë tjetër.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ne kemi shkuar në mënyrën më të mirë të mundshme e kemi bërë çelësin që të gjitha partitë i kemi përfshirë edhe këto duhet ta dini që jeni nëntë edhe shumica është në pozitë në këtë pjesë. Atëherë të pranishëm jemi? 28. Kush është për? Kundër? 19 Për. Kundër 6. Abstenim? Nuk ka. Atëherë miratohet pika e rendit të ditës.

Shqyrtimi dhe miratimi propozim vendimit për caktimin e tarifës për shërbimin e varrimit varrezat e reja të Prizrenit në Landovic.

Simir Krasniqi (Kryesues): Ftojme që të prezantohet kjo pikë nga iniciatori drejtori i shërbimeve publike për ju fjala drejtor.

Islam Ukaj : Faleminderit kryesues, të nderuar drejtor asamblesë dhe të gjithë të pranishëm. Unë fillimisht dua një kronologji shkurt ta jap lidhje me propozimin e vendimit për caktimin e tarifës për shërbimet e varrimit. Unë e pashë edhe më herët, njëherë kërkoj falje për shkak që s'ka mundur me ju përgjigjur pyetjeve dhe për që më keni bërë në pikën ku ka qenë për drejtorinë e shërbimeve publike. Mua ka dashur të dalë urgjent për një rast dhe kërkoj shumë falje, por të gjitha pyetjet që më janë bërë dhe disa pyetje që më i ka shkruar drejtoresha Luljeta, unë do t'jua kthej përgjigje qoftë me email apo edhe në një mënyrë tjetër ose në seancën tjetër. Kërkoj edhe njëherë shumë falje. U diskutuam më herët në fillim për punët kontratës, por në këtë rast nuk është diskutimi për kontratë, por është diskutimi për caktimin e tarifës për shërbimet e varrimit. Unë kronologjinë të shkurtër do ta do ta shpjegoj. Mandej në qoftë se ka diçka më të thellë do të shpjegoj edhe Fejsali këtu është koordinatori që ka qenë në rrjedha e kësaj kësaj kontratës. Komuna e Prizrenit ka lidhur një kontratë me koncesioni PZ Group për projektin me partneritet publik-privat, ndërtimi i varrezave të reja në Lëndovicë. Viti i kaluar kjo kontratë është bërë e plotfuqishme pas lëshimit të dokumenteve dhe vërtetimit të datës efektive për procedimin e qetë. Meqënëse procedura për aplikim këtij projekti ka filluar që nga viti 2016, di një ngjarje dhe jo, e këndej, të gjithë dokumentet prezentuar nga koncesioni në fjalë, plani i biznesit, paramasat dhe paralogaritë, kanë pasuar një ndryshim si rezultat i parametrave ekonomikë dhe politikave makrofiskale. Si pasojë e këtij rezultati i inflacionit dhe miratimi i pagesës minimale, kushtet që ka aplikuar ky operator tash kanë kanë qenë shënuar kanë shënuar ngritje të mëtejshme. Për këtë qëllim, koncesioni PZ Group

ka bërë kërkesë te kryetari i komunës dhe te kuvendi komunal këtu, që për shikimin e tarifave të shërbimit. Për këtë qëllim, ky koncesion ka kërkuar që të ndryshojë, respektivisht të rritet tarifa e shërbimit në vlerë prej 406.76 cent dhe kontributi financiar vjetor i komunës të rritej në vlerë prej 65.300 euro. Koncesioneri në këtë në fjalë ka sqaruar dhe ngritjen e çmimeve në bazë të analizave të prezentuara duke mbështetë në normën e inflacionit, ku si burim është edhe enti i statistikave të Kosovës dhe vendim si dhe vendimi i qeverisë të Kosovës për përcaktimin e pagës minimale. Menaxhmenti komunal në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike pas analizimit të kërkesës së së prezantuar, propozon të ndryshohet tarifa për shërbimet e varrimit në vlerë prej 394 euro, si dhe kontributi vjetor i komunës të jetë 65.300 euro. Meqënëse kemi të bëjmë me një projekt shumë humanitar dhe të ndjeshëm në interes të qytetarëve të Prizrenit, kërkoj që ky projekt të përkrahë dhe pasi që është shumë i domosdoshme. Në qoftë se diçka keni lidhje me çështjen e kontratës apo për ndonjë pyetje tjetër, mund të përgjigjet edhe Fejsali që është e koordinatori i Drejtorisë të Shërbimeve Publike. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit drejtor për sqarime. E hapim debatin. Fjala për ju, Ilir Gashi.

Ilir Gashi (LVV): Drejtor, çka është kjo nguti kështu në lidhje me tarifat për varrim? Në vend se të nguteni ta funksionalizoni varrezat e reja të Prizrenit, vitin e kaluar ish nënkryetari tha tetor janë gati më së vonti. Edhe sa muaj kaluan prej muajit tetor e që nuk u hapën varrezat e reja. Qytetarët janë hall, leje pikëllimin që e kanë familjet, për rastet e vdekjes që i kanë, po kanë hallin edhe më të madh kur nuk kanë hapësirë ku me i varros. E në veçse të nguteni dhe të hapni hapësirën e re të varrezave, t'ia lehtësoni qytetarëve, ju po mundoheni ala pa e hap me ngarkuar buxhetin tash, sepse pjesa më e madhe paguhet prej prej buxhetit komunal, për varrim, vetëm se po e rëndoni gjendjen. Është më urgjente dhe emergjente funksionalizimi i varrezave të reja se sa çështja e tarifave. Dhe çështja tjetër është se për këtë ngritje të tarifave nuk jeni konsultuar me askënd. As nuk ka pasur diskutim publik, as nuk ka pasur takim me palët e interesit sikurse që janë bashkësitë fetare. Vetëm e bini të premtën në takim KPF-së që sot të hënën me votu këtu edhe me e kalu këtë pikë shpejt e shpejt. Faleminderit për dëgjim.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit. Karanfil Haxhillari. Drejtor, merri pyetjet, në fund ju përgjigjeni.

Karanfil Haxhillari (LVV): Unë edhe kur është votuar rregullorja, edhe për kontratë i kam pasur vërejtjet e mia, po që po del që kam pasur shumë të drejtë në ato vërejtje që i kam dhënë në atë kohë. Neve për momentin, Komuna e Prizrenit e ka një kontratë me Ekoregjonin për ceremoninë e varrimit, ku pagesa për një varrim bëhet sot 290 euro me kontratë e re. Ka qenë 220 euro, 260 tash 290 euro, i kushton ekoregjonit së bashku me Bashkësinë Islame për me e krye një ceremoni të varrimit. Kurse tash kjo shifër është 406 euro, pothuajse 406.76 euro për një ceremoni të varrimit, që i bjen pothuajse dyfish. Duke u nisë nga vetë kontrata me partneritet publiko-privat nënkuptohet që këtu përfiton edhe publikja edhe privati. Por këtu tash vetëm privati po fiton. Në këtë rast 406 euro komuna derisa deri sot prej kur ka filluar ky projekt në vitin 2018 deri sot është

paguar maksimum 290 euro. Sot ky privati kërkon që të është dyfish më shtrenjtë. Unë e kam pasur edhe kritikë drejtor edhe më herët, që një nen në këtë kontratë është i paligjshëm, ku ceket aty rezervimi i vendeve për varrim, e cila është në kundërshtim me ligjin, sepse ajo pronë është pronë e komunës dhe nuk mundet që konsicionarit në këtë rast t'i jepet hapësira që ai ta shet atë pronë, sepse është në kundërshtim me ligjin në fuqi. Prandaj, unë e di që ka kryer punë kompania. Mirëpo po e shohim që ka kohë, prej se kanë filluar këto punë, kjo kontratë do të na qetë shumë probleme qytetarëve të Prizrenit dhe sidomos buxhetit të komunës të Prizrenit. Unë e kam propozuar edhe atëherë, meqënëse është vendi i komunës, të paguhet ajo kompani për punët e kryme gjithçka që ka kryer dhe të vazhdohet njëjtë me marrëveshjen qysh është aktuale me ndërmarrjen publike komunale, që ajo ndërmarrja është e juaj, e komunës, dhe të vazhdohet e njëjta kontratë, duke mos e ngarkuar edhe buxhetin e komunës me 290 euro qysh është. Pra së bashku edhe me Bashkësinë Islame qysh ka funksionuar deri tash. Dhe tash na vjen pavarësisht kontratës dhe rregullores së kaluara në kuvend, tash po na vjen menjëherë shtrejtimi. Thuhet këtu për shembull kjo vlerë reflekton ndikimin e inflacionit të akumuluar ndër vite. Cilit inflacion të akumulohet ndër vite ku kjo kompani hala s'ka filluar me punu, hala s'ka filluar me këtë projekt me u marr. Qysh ka ka akumuluar se akumulohet diçka kur një kohë ti vazhdon e kryen punën dhe të akumulohet ai inflacion. Dhe parametrat financiar ekonomik aktual të projektit, derisa po mundet ndërmarrja publike Ekoregjioni bashkë me Bashkësinë Islame me 290 euro me kryer një ceremoni varrimi, pse nuk po mundet kjo kompani, ky konstitucionar me të njëjtin çmim me e kry këtë ceremoni të varrimit. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Karanfil. Fjala për ju Bajram Kastrati.

Bajram Kastrati (LDK): Faleminderit kryesues. Drejtor, mbas këtij miratimi që do ta bëjmë ne sot, a kemi një afat të caktuar kur mundet me fillu varrimi i të vdekurve në varrezat e reja?

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Bajram. A ka diskutues tjerë? Po, Dafina Alishani.

Dafina Alishani (LVV): Faleminderit kryesues. Unë dorën në zemër sot e morëm këtë kontratë edhe nuk po kam të qartë çfarë përgjegjësi ka komuna ndaj operatorit ekonomik, pyetja e parë. Pyetja e dytë, kush e përcakton inflacionin se një përqindje e paraqitur prej operatorit ekonomik mu dukë shumë e lartë. Duke pasur parasysh që as nuk ka pasur, domethënë ka qenë në pritje operatori dhe nuk ka pasur ndonjë investim aty për të cilën tash është në humbje. Nëse ju vazhdimisht po ankoheni që nuk ka buxhet. Çka ndodh nëse komuna nuk e paguan operatorin ekonomik për vdekjet që ndodhin në Prizren, apo dalim prapë edhe ankohejmë thojmë nuk ka buxhet edhe qysh mbetet tani pjesa e papaguar dhe pjesa e shërbimit. Edhe qysh ka mundësi nëse ndërmarrja publike po e bën me 290 euro, pse kjo lartësi ose kjo diferencë kaq e lartë me një operator ekonomik? Edhe a e keni bërë një analizë ju si komunë për këtë propozim të kësaj vlere? Edhe pyetja e fundit është, a keni pasur konsultim me bashkësinë islame? Sepse ju e dini shumë mirë që për pjesën e varrimit edhe rivarrimit duhet me pas një bashkëpunim me ta, siç qysh ka qenë edhe më herët. Në KPF kërkoja sqarim për këtë. Ju thatë që ata janë të vetëdijshëm, po unë u informova që Bashkësia Islame nuk e ka informatë për këtë çështje. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Falemimderit. Në qoftë se nuk ka diskutues të tjerë, atëherë fjalën e japim drejtorit të shërbimeve publike apo zyrtarit të shërbimeve publike, Fejsal Hoti.

Fejsal Hoti: Përshëndetje për të gjithë. Komuna Prizreni këtë projekt pothuajse ka filluar nga viti 2009. Po ja nisi këtë kronologjinë e ngjarjeve me vendimin e parë për ndarjen e pronës prej 57 hektarëve për qëllimin e vetëm për varrezat e qytetit. Ky projekt i ka nënshtruar shumë proceseve dhe analizave duke filluar së pari me studimin e fizibilitetit, përgatitjen e kontratës dhe dokumenteve të tjera relevante për prokurim. Në vitin 2016 ka përfunduar procedura e tenderimit dhe në bazë të ligjit për partneritetet publike-private është themeluar subjekti me qëllim të veçantë që del nga koncesionieri që ka ofertuar. Fjala është themeluar grupi Prizren Group, ku i ka prurë të gjitha dokumentacionet. Ky projekt ka qenë, unë domethënë, mbasi kam qenë edhe bartës i këtyre proceseve, është zvarritur për arsye të ndryshme, sepse pothuajse tri qeverisje janë marrë, po edhe ligji për partneritete publike-private ta imponon që këto projekte janë më afatgjatë, pasi që i nënshtrohen, qoftë proceseve në nivelin lokal ashtu edhe qendror. Sepse vendimet përfundimtare i merr Komiteti Ndërminterior për Partneritetet Publike-Private dhe normal instancat komunale. Dafina e përmendi a ka pasur analiza, po Dafina ka pasur, ka qenë studimin e fizibilitetit. Meqënëse është projekt humanitar, ka dalë si projekt jo shumë rentabil, pikërisht njerëz që janë marrë profesionist në këtë drejtim e kanë parë të udhës, për shkak se në aspektin ekonomik kthimi i normës së investimit është shumë i lartë, është desh të ndërhyjë në bazë të ligjit për financa publike, ndihma shtetërore që i jep këtij projekti. Sepse Karanfil këtu ka me investuar 2.5 milionë euro, nuk është si kompania publike që e ka të gatshëm, nëse duhet të ipin paramasat dhe paralogaritë, çfarë ka me investuar aty? 57 hektarë aty janë në gjendje të tmerrshme, ka me investuar të gjitha prej shërbimeve publike, hapësirave të ndryshme, rrafshime, krijimi trotuare, ndriçim publik, objekte edhe për Bashkësitë Islame dhe objektet administrative. Edhe kjo është kontratë 30-vjeçare, nuk mund me shkëput me ja dhënë Ekoregjionit. Çështja që ka lypur koncesioni këto mjete, kjo ka të bëjë, sepse është ofertuar në vitin 2014. Kur është ofertuar në 2014, paga minimale ka qenë 250€. Tash, fatmirësisht, qeveria e Kosovës e ka bërë 500 euro pagën minimale. Kumulativi që është përmendur inflacioni kumulativ është mbledhur ndër vite, e ka ardhur 1% i një mesatare 30% e materialeve të ndërtimit dhe nuk është, si thuani ju, 100% po është për tarifën e shërbimit është 60%, ndërsa për ndihmën shtetërore është 30%. Kontrata është e nënshkruar me 12.3.2025-ën. Dhe e ra ato, kontrata është hazër. Mirëpo para se me filluar me varrime, është koncesioneri edhe në bazë të kontratës që e ka obligative me negociu qoftë çmimin, qoftë ndryshimet, ka kërkuar paraprakisht që ka ndryshime të mëdhaja në trendet botërore, qoftë çmimeve, qoftë ka qenë edhe Covid-i, ka qenë edhe inflacioni, kanë qenë edhe shumë gjëra të tjera që kanë ndikuar, normal që i ka leverdi e vetë edhe kërkon. Mirëpo Komuna, menaxhimi komunal ka ardhur në përfundim që çmimi të jetë 394 euro për një shpenzim të varimit. Për sa i përket Bashkësisë Islame, unë me sa e di ka vendime të tjera edhe për ceremoninë, për ritet fetare që i jepet ndihmë Bashkësisë Islame, kjo s'ka të bëjë. Qytetarët nuk kanë me pasur domethënë kosto financiare për ato, komuna e Prizrenit, respektivisht qyteti i Prizrenit do të financohet nga mjetet buxhetore të Komunës, nëse kam harruar diçka kërkoj falje.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Fejsal, atëherë i marrim pra. Në qoftë se ka dikush ndonjë pyetje që nuk ka atëherë e hedhim në votim.

Bajram Kastrati (LDK): Pyetja ke, Fejsal pyetja ke se ndoshta u ngatërruam. Kur mundet me qenë varrimi i parë i qytetarit? Po më intereson qytetarit, po i intereson kur ke me filluar varrimet se fjala është edhe për varrezat e qytetit, edhe për varrezat e Arbanës, sidomos të Arbanës. Është shumë, shumë në gjendje alarmante varrimin në varrezat e Arbanës. Qytetarit po i intereson kur mundet me qenë një afat i fundit, ta dimë një muaj, dy, me ditë kur ke me filluar varrimet atje poshtë.

Fejsal Hoti : Koncesioneri i ka përgradit të gjitha dokumentet, është pranuar, është themeluar ekipi për menaxhimin e kontratës. Është një kontratë sa për informacione 30-vjeçare, që domethënë prej 2025-ës deri në 2055-ën, në bazë të analizave, që e ka paraqitur koncesioneri, parashihet në tri faza me investuar 18 plus 18 plus 18 hektar, domethënë për çdo 10 vite, edhe menjëherë pas aprovimit të kësaj tarife, gjërat qartësohen dhe shumë shpejt, shumë shpejt do të fillohet me ceremonitë e para. Kjo, ky projekt është në nivel të Kosovës është një projekt më të mirë, më i mirë, kisha me thënë në aspektin humanitar, ka me qenë më i përgjegjshëm, më i kujdesshëm dhe do të tentojmë komuna me ju ofruar qasje sa më të mirë qytetarëve për t'i kryejë këto ceremoni, qoftë edhe nëpërmes rregullimit të linjave urbane për qytetarë, por edhe gjëra të tjera që janë në interes të përgjithshëm. Faleminderit.

Simir Krasniqi (Kryesues): Faleminderit Fejsal për përgjigjet.

Haziz Hodaj (LDK): Po pyetja kjo shumë konkrete. Kur mund të fillojë vorrimin? Natyrisht që duhet me vdekë njëherë me me u vorros, po kur mund të fillojë vorrimin në vorrezat e për të cilat po bisedojmë. Edhe mos jep shumë premtime, se i dimë kompanitë çfarë i kemi, të papërgjegjshme totalisht. Po e merr shembull, po e merr shembull veç një kompani që menaxhon atje mbeturinat. Unë e di shumë mirë në këtë kuvend, na thojke ai që e prezantoi projektin, ka me u bë një park që njerëzit kanë me shkuar me pushu për qejf në ambientet ku hudhen mbeturinat, a në çfarë gjendje kemi. Kështu që në rregull është ajo që ti po thua, po mos premtu premtime që nuk mundesh ti vet me realizu, se varet prej dikujt tjetër. Konkretisht kur mundet me u fillu varrimin në ato varreza.

Fejsal Hoti: Ky është projekt me partneritet publik-privat. Ndoshta e kupton qëllimin për partnerin. Qëllimi i partnerit privat është sa më para me operuar edhe me pas fitimin e vet. Edhe tash, në momentin që ju e aprovoni këtu, unë e thashë qartësohen gjërat. Aty nuk mund me të garantoni mbas një jave mbas 10 ditë. Kontratën e ka të nënshkruar Haziz. Kontrata është e nënshkruar.

Simir Krasniqi (Kryesues): Edhe këtu e dimë që shumë shpejt varrezat e qytetit të Prizrenit vetëm ndoshta çështje muajsh apo ditësh që duhet të bëjmë një zgjidhje. Vetvetiu do t'ia imponon që sa më shpejt të filloj varrimin në Landovic. Se në në varrezat e qytetit të Prizrenit e dimë të gjithë që s'ka hapësirë, ndoshta edhe shumë pak çështje muajshë një ose dy muaj. Po, fjala për ju Dafina.

Dafina Alishani (LVV): Fejsal, partneriteti publiko-privat po bëhet për një çështje sociale. Mu këtu nuk po mund me e kuptu këtë këtë ide, sepse ju po thoni që është partneritet publiko-privat. Edhe unë po e shoh një prioritet që vetëm privati po shikohet këtu. Interesi i privatit po shikohet. Edhe të lutna, kur të thua paga për Bashkësinë Islame, është një linje tjetër. Bile ti, që je në Drejtori i Shërbimeve Publike, e din qysh ka ndodhur pagesa e Bashkësisë Islame. Jo, marrëveshja ka qenë me Ekoregjion, Ekoregjioni ka bërë memorandum bashkëpunimi me Bashkësinë Islame. Asamblistët e rinj nuk e dinë këtë çështje. Edhe mirë është me i informuar korrekt. Jo me thënë në kuvend që Bashkësia Islame ka pagesa të tjera që i merr prej komunës. Qytetari nuk ka marrëveshje tjetër. Këto pagesa që janë bërë për shpenzimet e varrimit, janë bërë përmes ndërmarrjes publike, ndërmarrja publike pastaj e ka bërë memorandumin me Bashkësinë Islame. Tash atë pagesën, a i bie që do të paguhet vetë prej qytetarit? A i paguan operatori ekonomik pjesën e Bashkësisë Islame? Nëse që kjo rritje po bëhet prej pjesës së buxhetit të komunës, ku mbetet pagesa e Bashkësisë Islame. Këto duhet me i ditë qytetarët. Mos të jetë pastaj para varrimit aty për aty me ja kërkuar operatorit ekonomik pagesën për Bashkësi Islame. Ose a kemi marrë ndonjë garacion që ky operator ekonomik ka me pas memorandumin me Bashkësinë Islame?

Fejsal Hoti: Qëllimi i partneriteteve publiko-private, gjithmonë është në funksion të interesit të përgjithshëm publik.

Dafina Alishani (LVV): E kemi parë te pazari, çfarë interesi keni. Kallëzom ti mua për këtë projekt, se partneritetet publiko-privat, ju keni formuar komisione ad hoc, ku i ka kaluar edhe afati i atij partneritetit edhe i keni dhënë me iniciativë të kryetarit. Ne e kemi parë qysh është interesi juaj për prona komunale. Kjo është një hapësirë shumë e madhe, por është edhe aspekt social. Edhe po tutna që neve kanë me na nemë qytetarët që nuk e kemi analizuar mirë edhe vetëm për shkak të urgjencës se nuk ka vend në varreza po bëjmë kështu veprime të cilat kanë me ngarkuar komunën dhe qytetarin.

Fejsal Hoti : Unë e thashë Dafinë, ky proces është tejzgjatur. Kanë po edhe ato i tregojnë edhe partneritetet publike private si të tilla janë të tej zgjatur ne edhe sepse kalojnë nëpër nivelin qendror i nderuar, kalon nëpër nivelin qendror. Ata e dijsa edhe burokracinë se pesë ministra mbledhën e duhet njëherë me u aprovuar e mbasandej një pëlqim mbasandej me u aprovuar kontrata. Ju e dini, ndoshta ju nuk e dini po për një periudhë lokacioni i komunës i këtyre varrezave ka kaluar në AKP. Në mënyrë të njëanshëm edhe komuna është detyruar është detyruar që me bë kërkesë të zyrës së kryeministrit respektivisht agjencionit kosovar të pronave dhe ata e kanë lejuar me një pëlqim, mirëpo si kusht ka qenë 20% i punëtorëve me paguar. Komuna 570.000 euro me sa e di unë, i ka paguar punëtorëve të kush ka qenë kësaj kompanie KBI progresi, nuk e di kush e ka pasur edhe ka shkuar një periudhë shumë e gjatë deri te ajo. Pastaj çështjet edhe ka pasur edhe që të tjera. Ndoshta ndonjë pushtet e ka përlonguar edhe ka ardhur si rezultat i këtyre sendeve.

Dafina Alishani (LVV): Se kur është votuar rregullorja për varreza, neve na është thënë që brenda shumë afatit të shkurtë ka me filluar, domethënë aktivizimi i asaj atyre varrezave aty. Rregullorja është votuar para disa muajve. Edhe të gjithë asamblistët për shkak të urgjencës, edhe për shkak

të insistimit të Bajramit që ka qenë zë i fuqishëm për këtë çështje, e kemi votuar unanimitisht rregulloren, veç me aktivizu varrezat. Kanë kaluar muaj të tanë dhe ne ende nuk kemi edhe shumë është legjitime pyetja, çfarë afati pritet aktivizimi i asaj. Jo, s'bën shumë shpejt, se në tetor na keni thënë.

Fejsal Hoti: Patjetër. Unë mendoj se të gjitha dilemat ishin nëse aprovohet ky vendim dhe mendoj se s'jam as kryetar e komune.

Simir Krasniqi (Kryesues): Të pranishëm jemi 31 anëtarë të kuvendit. Kush është për miratimin e propozim-vendimit, përcaktimin e tarifës për shërbimin e varrezat e reja të Prizrenit në Landovicë. 23 për. Kundër? Nuk ka. Abstenim ? 4. Miratohet pra pika e 11-të e rendit të ditës. Ju faleminderit për pjesëmarrjen. Shihemi në seancat e radhës. Këtu e mbyllim seancën.

**Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi**



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT

Nr. 001/011 –

Më: __ qershor 2026

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2, shkronja d) dhe nenit 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, si dhe nenit 27 paragrafit 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit Nr. 01/011-5643, të datës 15 tetor 2008, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më datë __ qershor 2026, miratoi këtë:

**PROPOZIM-VENDIM
PËR SUBVENCIONIMIN E TRANSPORTIT URBAN**

Neni 1

Miratohet Vendimi që ka për qëllim të përcaktojë kushtet dhe procedurat e subvencionimit të transportit urban në Komunën e Prizrenit.

Neni 2

Transporti urban do të subvencionohet nga Komuna e Prizrenit në euro për kilometër (€/km), të cilat do të llogariten në bazë të rrendeve të udhëtimit të cilat janë të vërtetuara nga organi kompetent.

Neni 3

Subvencionimi bëhet në vlerë prej 1.20 € për kilometër (€/km). Ky subvencion është i planifikuar të zbatohet për një periudhë (5) pesë vjeçare me mundësi vazhdimi.

Neni 4

Drejtoria e Shërbimeve Publike emëron një komision për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të arritura në departamentin e transportit pas thirrjes publike për subvencionimin e transportit urban.

Neni 5

Drejtoria e Shërbimeve Publike ka përcaktuar që në kuadër të programit të subvencionimit të përfitojnë disa kategori të caktuara për bileta ditore dhe mujore. Këto kategori përfshijnë: nxënësit, studentët, pensionistët, personat e dalë nga lufta dhe familjarët e tyre, personat me nevoja të veçanta, policia, ushtria, zjarrëfikësit, punëtorët e arsimit dhe shërbyesit civil.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Shërbimeve Publike dhe organet tjera përkatëse.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit
Simir Krasniqi**

A r s y e t i m

Subvencionimi i transportit publik të udhëtarëve në zonat urbane, ka për qëllim përmirësimin e kushteve të transportit publik duke ofruar shërbime më të sigurta, më efikase dhe më të aksesueshme për qytetarët. Ky subvencionim synon të lehtësojë qasjen më të mirë në transport për kategoritë më të ndjeshme sociale dhe për të rritur përdorimin e transportit publik, duke ulur kështu edhe ndotjen mjedisore dhe dendësinë e trafikut në zonën qytetit të Prizrenit.

Mënyra e subvencionimit:

Subvencionet i jepen direkt operatorëve të transportit për linjat e transportit urban. Kështu, operatorët mbështeten financiarisht për të ofruar bileta falas për kategoritë e caktuara.

Subvencionimi i transportit të udhëtarëve urban është domosdoshmëri për të garantuar ofrimin e shërbimeve efikase, të sigurta dhe të përballueshme për qytetarët. Kjo masë e subvencionimit ka për qëllim dhe synon jo vetëm përmirësimin e kushteve të transportit, por edhe mbështetjen sociale për kategori të caktuara të qytetarëve në tërësi.

1. Pensionistet, kategoritë e dala nga Lufta dhe familjarët e tyre, personat me aftësi të veçanta, policia, ushtria, zjarrëfikësit, punëtorët e arsimit dhe shërbyesit civil, përfitojnë biletat falas në të gjitha linjat e transportit urban.
2. Nxënësit e Shkollave të Mesme të Ulëta përfitojnë nga subvencionimi në transportin urban bileta ditore dhe mujore do të jetë falas.

Përmes subvencionimit të transportit urban sigurohet:

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit në transport të udhëtarëve – Investimet në transportin publik mundësojnë që operatorët e transportit të kësaj fushe të investojnë në mjetet e tyre për të ofruar shërbime sa më të mira dhe të qëndrueshme, duke ndikuar edhe në mbrojtjen e mjedisit.
- Lehtësimi i ngarkesës ekonomike për qytetarët – Çmimet e reduktuara për biletat ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e kostos së jetesës për shumë familje, veçanërisht në kohë sfidash ekonomike.
- Zhvillimi i qëndrueshëm urban – Inkurajimi i përdorimit të transportit publik ndihmon në uljen e përdorimit të veturave private, çka ndikon në zvogëlimin e ndotjes së ajrit, bllokimeve në trafik dhe konsumit të energjisë.

Për të arritur këto objektiva, Komuna Prizrenit konkretisht Drejtoria e Shërbimeve Publike e konsideron të arsyeshme dhe në interes të përgjithshëm publik ndarjen e fondeve për subvencionimin e transportit publik, si pjesë e angazhimit për një qytet më të qasshëm, më të drejtë dhe më të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët e saj.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

SKUPŠTINA OPŠTINE PRIZREN

Br. 001/011 –

Dana: __ juna 2026

Na osnovu člana 12 stav 2, tačka d) i člana 40 stav 2 Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, člana 17 stav 3 Zakona br. 04/L-179 o drumskom prevozu, kao i člana 27 stav 1 Statuta opštine Prizren br. 01/011-5643, od 15. oktobra 2008. godine, Skupština opštine Prizren, na svojoj sjednici održanoj __ juna 2026. godine, odobrila je ovu:

ODLUKU ZA SUBVENCIONISANJE URBANOG TRANSPORTA

Član 1

Usvaja se Odluka, koja ima za cilj utvrđivanje uslova i postupaka za subvencioniranje gradskog prevoza u opštini Prizren.

Član 2

Gradski prevoz će subvencionirati Opština Prizren u eurima po kilometru (€/km), što će se obračunavati na osnovu reda vožnje koji je ovjerio nadležni organ.

Član 3

Subvencija se daje u iznosu od 1,20 € po kilometru (€/km). Planirano je da se ova subvencija provodi u periodu od pet (5) godina s mogućnošću produženja.

Član 4

Direktorijat javnih službi imenuje komisiju za pregled i procjenu zahtjeva koje je departman za saobraćaj primio nakon javnog poziva za subvencije za gradski prevoz.

Član 5

Direktorijat javnih službi utvrdila je da će u okviru programa subvencija određene kategorije imati koristi od dnevnih i mjesečnih karata. Ove kategorije uključuju: učenike, studente, penzionere, ratne veterane i njihove porodice, osobe sa posebnim potrebama, policiju, vojsku, vatrogasce, prosvjetne radnike i državne službenike.

Član 6

Za sprovođenje ove odluke staraće se: gradonačelnik, Direktorijat javnih usluga i drugi nadležni organi.

Član 7

Ova odluka stupa na snagu 30 dana od dana slanja nadzornom organu, u smislu člana 8, u vezi sa članom 9 Zakona br. 08/L-284 o administrativnom preispitivanju opštinskih akata i nakon objavljivanja na službenim jezicima na službenoj web stranici opštine.

**Predsedavajući Skupštine
Simir Krasniqi**

A r s y e t i m

Subvencionimi i transportit publik të udhëtarëve në zonat urbane, ka për qëllim përmirësimin e kushteve të transportit publik duke ofruar shërbime më të sigurta, më efikase dhe më të aksesueshme për qytetarët. Ky subvencionim synon të lehtësojë qasjen më të mirë në transport për kategoritë më të ndjeshme sociale dhe për të rritur përdorimin e transportit publik, duke ulur kështu edhe ndotjen mjedisore dhe dendësinë e trafikut në zonën qytetit të Prizrenit.

Mënyra e subvencionimit:

Subvencionet i jepen direkt operatorëve të transportit për linjat e transportit urban. Kështu, operatorët mbështeten financiarisht për të ofruar bileta falas për kategoritë e caktuara.

Subvencionimi i transportit të udhëtarëve urban është domosdoshmëri për të garantuar ofrimin e shërbimeve efikase, të sigurta dhe të përballueshme për qytetarët. Kjo masë e subvencionimit ka për qëllim dhe synon jo vetëm përmirësimin e kushteve të transportit, por edhe mbështetjen sociale për kategori të caktuara të qytetarëve në tërësi.

1. Pensionistet, kategoritë e dala nga Lufta dhe familjarët e tyre, personat me aftësi të veçanta, policia, ushtria, zjarrëfikësit, punëtorët e arsimit dhe shërbyesit civil, përfitojnë biletat falas në të gjitha linjat e transportit urban.
2. Nxënësit e Shkollave të Mesme të Ulëta përfitojnë nga subvencionimi në transportin urban bileta ditore dhe mujore do të jetë falas.

Përmes subvencionimit të transportit urban sigurohet:

- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit në transport të udhëtarëve – Investimet në transportin publik mundësojnë që operatorët e transportit të kësaj fushe të investojnë në mjetet e tyre për të ofruar shërbime sa më të mira dhe të qëndrueshme, duke ndikuar edhe në mbrojtjen e mjedisit.
- Lehtësimi i ngarkesës ekonomike për qytetarët – Çmimet e reduktuara për biletat ndikojnë drejtpërdrejt në uljen e kostos së jetesës për shumë familje, veçanërisht në kohë sfidash ekonomike.
- Zhvillimi i qëndrueshëm urban – Inkurajimi i përdorimit të transportit publik ndihmon në uljen e përdorimit të veturave private, çka ndikon në zvogëlimin e ndotjes së ajrit, bllokimeve në trafik dhe konsumit të energjisë.

Për të arritur këto objektiva, Komuna Prizrenit konkretisht Drejtoria e Shërbimeve Publike e konsideron të arsyeshme dhe në interes të përgjithshëm publik ndarjen e fondeve për subvencionimin e transportit publik, si pjesë e angazhimit për një qytet më të qasshëm, më të drejtë dhe më të qëndrueshëm për të gjithë qytetarët e saj.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

PRİZREN BELEDİYE MECLİSİ

No: 001/011 –

Tarih: __ Haziran 2026

03/L-040 Sayılı Yerel Öz Yönetim Kanununun 12. maddesi 2. fıkrası (d) bendi ve 40. maddesi 2. fıkrası, Karayolu Taşımacılığı Hakkında 04/L-179 Sayılı Kanununun 17. maddesi 3. fıkrası ve ayrıca 15 Ekim 2008 tarihli 01/011-5643 sayılı Prizren Belediyesi Tüzüğü'nün 27. maddesi 1. fıkrasına dayanarak, Prizren Belediye Meclisi __ Haziran 2026 tarihinde yapılan toplantıda aşağıdaki Kararı almasını önerir:

**KENT İÇİ TOPLU TAŞIMA SÜBVANSİYONU HAKKINDA
K A R A R I**

Madde 1

Prizren Belediyesi sınırları içerisinde kent içi toplu taşıma sübvansiyonuna ilişkin şart ve usulleri belirlemeyi amaçlayan bu karar onaylanır.

Madde 2

Kent içi toplu taşıma, Prizren Belediyesi tarafından kilometre başına euro (€/km) üzerinden sübvansiyon edilecektir. Bu hesaplama, yetkili organ tarafından onaylanmış sefer tarifelerine göre yapılacaktır.

Madde 3

Sübvansiyon miktarı kilometre başına 1.20 € (€/km) olarak belirlenmiştir. Bu sübvansiyonun (5) beş yıllık bir süre için uygulanması ve devam ettirilme imkânı öngörülmektedir.

Madde 4

Kamu Hizmetleri Müdürlüğü, kent içi toplu taşıma sübvansiyonu için yapılan kamu çağrısı sonrasında ulaşım departmanına ulaşan başvuruların incelenmesi ve değerlendirilmesi amacıyla bir komisyon oluşturur.

Madde 5

Kamu Hizmetleri Müdürlüğü, sübvansiyon programı kapsamında günlük ve aylık biletlerden yararlanacak belirli kategorileri belirlemiştir. Bu kategoriler şunlardır: öğrenciler, üniversite öğrencileri, emekliler, savaş gazileri ve aile fertleri, engelli bireyler, polis, asker, itfaiyeciler, eğitim çalışanları ve kamu görevlileri.

Madde 6

Bu kararın uygulanmasından Belediye Başkanı, Kamu Hizmetleri Müdürlüğü ve diğer ilgili kurumlar sorumludur.

Madde 7

Bu karar, 08/L-284 sayılı Belediye İşlemlerinin İdari İncelemesine İlişkin Kanunun 8. maddesi ile bağlantılı olarak 9. maddesi uyarınca denetim organına gönderilmesinden itibaren 30 gün sonra yürürlüğe girer ve belediyenin resmi internet sayfasında resmi dillerde yayımlandıktan sonra geçerlilik kazanır.

Meclisi Başkanı
Simir Krasniqi

Gerekçe

Kentsel alanlarda yolcu taşımacılığının sübvansede edilmesi, vatandaşlara daha güvenli, daha verimli ve daha erişilebilir hizmetler sunarak toplu taşıma koşullarını iyileştirmeyi amaçlamaktadır. Bu sübvansiyon, özellikle hassas sosyal grupların ulaşım erişimini kolaylaştırmayı, toplu taşıma kullanımını artırmayı, çevre kirliliğini ve Prizren şehir merkezindeki trafik yoğunluğunu azaltmayı hedeflemektedir.

Sübvansiyon Yöntemi:

Sübvansiyonlar doğrudan kent içi toplu taşıma hatlarını işleten operatörlere verilir. Bu sayede operatörler belirli kategorilere ücretsiz bilet sunabilmeleri için mali olarak desteklenir.

Kent içi yolcu taşımacılığının sübvansede edilmesi, vatandaşlara etkin, güvenli ve ekonomik hizmet sunumunun sağlanması açısından bir gerekliliktir. Bu önlem sadece ulaşım koşullarını iyileştirmeyi değil, aynı zamanda belirli vatandaş kategorilerine sosyal destek sağlamayı da amaçlamaktadır.

1. Emekliler, savaş gazileri ve aile fertleri, engelliler, polis, asker, itfaiyeciler, eğitim çalışanları ve kamu görevlileri, tüm kent içi hatlarda ücretsiz biletlerden yararlanır.
2. Alt ortaöğretim öğrencileri (ilköğretim ikinci kademe) kent içi ulaşımında günlük ve aylık biletlerden ücretsiz olarak yararlanır.

Kent içi ulaşımın sübvansede edilmesi ile aşağıdakiler sağlanır:

- Yolcu taşımacılığı hizmet kalitesinin artırılması – Toplu taşımaya yapılan yatırımlar, operatörlerin araçlarını geliştirmesine olanak tanır ve daha kaliteli, sürdürülebilir hizmet sunumunu sağlar; aynı zamanda çevrenin korunmasına katkıda bulunur.
- Vatandaşlar üzerindeki ekonomik yükün azaltılması – Bilet fiyatlarının düşürülmesi, özellikle ekonomik zorluklar döneminde birçok aile için yaşam maliyetini doğrudan azaltır.
- Sürdürülebilir kentsel gelişim – Toplu taşımanın teşvik edilmesi, özel araç kullanımını azaltarak hava kirliliğini, trafik sıkışıklığını ve enerji tüketimini düşürür.

Bu hedeflere ulaşmak amacıyla Prizren Belediyesi, özellikle Kamu Hizmetleri Müdürlüğü aracılığıyla, toplu taşıma sübvansiyonuna bütçe ayrılmasını kamu yararı açısından gerekli ve uygun görmektedir. Bu, daha erişilebilir, daha adil ve daha sürdürülebilir bir şehir oluşturma taahhüdünün bir parçasıdır.



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti
Kuvendi i Komunës së Prizrenit
Nr. 001/011 –
Më: ___ 2026

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

RREGULLORE
PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E PRIZRENIT

Në pajtim me dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja c) dhe nenit 17, shkronja f), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8 shkronja a), nenit 15 shkronja f) dhe nenin 19 paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 15 dhe 34 të Ligjit Nr. 04/L-60 për Mbeturina, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.08/L-071 si dhe nenit 27 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15 tetor 2008, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më ____ 2026, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E PRIZRENIT

Neni 1 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e ofrimit të shërbimeve publike dhe mënyrën e menaxhimit të mbeturinave, duke përfshirë mbledhjen e mbeturinave të përziera, mbeturinave të biodegradueshme komunale, si dhe mbledhjen e ndarë të letrës, metalit, qelqit, plastikës, tekstilit, mbeturinave problematike dhe atyre të vëllimshme. Po ashtu, rregullorja përcakton shpërndarjen hapësinore të pikave të riciklimit, metodën e llogaritjes së sasisë së mbeturinave për periudha të caktuara kohore, si dhe mënyrën dhe kushtet e përcaktimit dhe llogaritjes së tarifave për amvisëri dhe biznese.

Neni 2 QËLLIMI

1. Kjo rregullore përcakton çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunale, si dhe përcakton vlerën (shumën) e taksës për mbeturina, me qëllim të krijohet një sistem i qëndrueshëm financiar me cilësi të lartë, dhe ekonomikisht i efektshëm i mbledhjes së mbeturinave komunale në të gjithë komunën e Prizrenit, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së mjedisit dhe mbrojtjes së interesit publik.
2. Me këtë rregullore përcaktohet sistemi, mënyra e mbledhjes, ndarjes, përpunimit, riciklimit të mbeturinave, lloji, numri i kontejnerëve, mënyra e shpërndarjes dhe vendosjes së tyre, mirëmbajtja e vendeve ku grumbullohen mbeturinat dhe mënyra e transportimit të tyre.
3. Qëllimi i sistemit të grumbullimit të mbeturinave komunale është që të siguroj mundësinë e përdorimit të shërbimit publik të mbledhjes së mbeturinave të përziera komunale dhe mbeturinave komunale të biodegradueshme. Gjeneruesit e mbeturinave inkurajohen t'i dorëzojnë mbeturinat ndaras, në mënyrë që të zvogëlohet sasia e mbeturinave të përziera komunale dhe atyre të biodegradueshme.
4. Rregullorja, në përputhje me legjislacionin mjedisor, identifikon qartë përgjegjësitë e secilit subjekt të përfshirë në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.

Neni 3 FUSHËVEPRIMI

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje janë obligative për të gjithë qytetarët, bizneset, kompanitë publike përgjegjëse për mbeturina dhe operatorët tjerë, si dhe për të gjithë ata që kanë të bëjnë me mbeturina brenda territorit të komunës së Prizrenit.
2. Kjo rregullore definojnë kushtet për menaxhimin e integruar të mbeturinave, në minimizimin, ndarjen, ruajtjen, shkarkimin, grumbullimin, transportimin, deponimin, riciklimin dhe taksën për mbeturina, me qëllim ruajtjen e mjedisit jetësor në territorin e Komunës së Prizrenit, duke bashkëpunuar ngushtë me qytetarët për ngritjen e vetëdijes dhe rritjen e përgjegjshmërisë për një qytet më të pastër dhe më të shëndetshëm.

Neni 4 PËRKUFIZIMET

- 1.1. Mbeturinë** - substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedhë apo është i detyruar ta hedhë.
- 1.2. Menaxhimi i mbeturinave** – aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, përfshirë mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinave, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve.
- 1.3. Gjeneruesi i mbeturinave**- subjekti fizik apo juridik që krijon mbeturina.
- 1.4. Operator** – personi juridik i cili, në përputhje me ligjin, menaxhon dhe kontrollon, është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të tyre.
- 1.5. Kompania shërbyese** – kompania e cila kryen shërbimin e grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave komunale.
- 1.6. Leje përkatëse mjedisore** – nënkupton leje mjedisore, lejen mjedisore e integruar, ose leje mjedisore komunale, të përkuftuara sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e mjedisit dhe ligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes.
- 1.7. Person** - person fizik ose juridik i cili është i involvuar drejtpërdrejt ose tërthorazi në proceset e menaxhimit të mbeturinave.
- 1.8. Konsumatori** – personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime të caktuara.
- 1.9. Ripërdorimi** - çdo operim me të cilin një produkt apo komponent, që nuk është mbeturinë, përdoret përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin është destinuar.
- 1.10. Mbledhja** – mbledhja dhe transportimi i mbeturinave, duke përfshirë klasifikimin paraprak sipas llojeve dhe magazinimin e tyre për qëllim të bartjes deri te objekti për trajtim ose deponim të mbeturinave.
- 1.11. Mbledhja e ndarë** - nënkupton mbledhjen kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë sipas llojeve, të klasifikuar sipas natyrës dhe përbërjes, për të lehtësuar trajtimin specifik.

- 1.12. Prodhuesi i mbeturinës** - çdo person veprimtaria e të cilit krijon /prodhon mbeturinë, ose çdonjëri që merret me para-procesim, përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjes së mbeturinës.
- 1.13. Zotëruesi i mbeturinës** - prodhuesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinën.
- 1.14. Mbeturina komunale** - mbeturina nga amvisëritë dhe nga aktivitete të tjera që, për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.
- 1.15. Mbeturina e parrezikshme** - mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.
- 1.16. Mbeturina komerciale** - mbeturinat që vijnë nga objektet që përdoren për qëllime tregtare, biznesi, sporti, edukimi apo rekreacioni, por nuk përfshijnë mbeturinat industriale.
- 1.17. Mbeturina inerte** - mbeturinat që nuk pësojnë ndryshime të rëndësishëm fizik, kimike dhe biologjike në vendet ku deponohen, si:
- Mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen dhe nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet të tjera dhe nuk ndikojnë ndjeshëm në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.
 - Kullimi dhe përmbajtja ndotëse e tyre, përfshirë mbetjet ekotoksike, duhet të jenë të papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- 1.18. Mbeturinë e vëllimshme** - mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.
- 1.19. Qendrat grumbulluese** – lokacione për grumbullimin e mbeturinave të ndara sipas llojeve të përcaktuara.
- 1.20. 3R** – reduktim, ripërdorim, riciklim.
- 1.21. Amvisëritë jo-rezidente**- persona fizikë ose juridikë që kanë vendqëndrim në territorin e Komunës së Prizrenit për më pak se 6 muaj.

Neni 5

PËRGJEGJËSITË DHE DETYRAT E KOMUNËS

1. Përgjegjësitë e komunës për menaxhimin e mbeturinave janë:

- Hartimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave.
- Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale.
- Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar.
- Zhvillimi i procesit të kontraktimit për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave.
- Spektori për menaxhimin e mbeturinave, mbikëqyr dhe udhëzon ofruesit e shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe deponimin e mbeturinave.
- Kryerja e monitorimit mjedisor të deponisë sanitare.
- Menaxhimi i mbeturinave komunale nga konstrukt-demolimi, si dhe i mbeturinave inerte, komerciale dhe të vëllimshme.

8. Identifikimi i pikave ilegale (të zeza) të hedhjes së mbeturinave dhe largimi i tyre.
9. Përcaktimi i lokacioneve, numrit dhe llojit të kontejnerëve në bashkëpunim me operatorin ose palët e treta.
10. Mbikëqyrja dhe përcaktimi i orarit dhe dinamikës së mbledhjes së mbeturinave.
11. Promovimi i zvogëlimit të sasisë së mbeturinave (3R, kompostimit shtëpiak etj.)
12. Promovimi i ngritjes së vetëdijes publike dhe pjesëmarrja aktive të qytetarëve në implementimin e menaxhimit të mbeturinave.
13. Mbikëqyrje dhe planifikimi buxhetor për funksionimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave.
14. Përpilimi i raporteve për menaxhimin e mbeturinave, përfshirë:
 - 14.1.1 Faturimin;
 - 14.1.2 Shkalla e inkasimit;
 - 14.1.3 Sasinë e mbeturinave të grumbulluara dhe të deponuara.
15. Shqyrtimi i ankesave dhe parashtrësive të taksapaguesve lidhur me menaxhimin e mbeturinave.
16. Përcaktimi i taksës dhe mënyrës së arkëtimit të mjeteve financiare.
17. Raportimi në AMMK-Ministrinë e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, sipas Ligjit me nr. 04L/060 për mbeturina, për SMM çdo 31 mars të vitit pasues.
18. Sigurimi i kushteve për veprim dhe operim për operatorët publikë dhe privatë.
19. Monitorimi i të dhënave për amvisëritë që pranojnë shërbime komunale të grumbullimit të mbeturinave, këto të dhëna (regjistra) përmbajnë informacione për përdoruesit e shërbimeve, adresën dhe të dhëna të tjera të nevojshme, dhe duhet të përditësohen rregullisht nga kompania shërbyese.
20. Grumbullimi, transporti dhe deponimi i mbeturinave të vëllimshme, dy herë në vit, pa pagesë:
 - a) java e parë e muajit maj (aksion pranveror)
 - b) java e parë e muajit nëntor (aksion vjeshtor).

Neni 6

LLOJET E MBETURINAVE

1. Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbeturina, llojet e mbeturinave janë:
 - a) Mbeturina komunale;
 - b) Mbeturina komerciale;
 - c) Mbeturina industriale;
 - d) Mbeturina medicinale.
2. Mbeturinat nga paragrafi 1, pika a) e këtij neni, varësisht nga shkalla e rrezikshmërisë, janë:
 - a) Mbeturina inerte, të cilat nuk ndizen, nuk shkaktojnë reaksione fizike ose kimike, nuk treten, nuk pësojnë zbërthim biologjik në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedis dhe shëndetin e njeriut;
 - b) Mbeturina të vëllimshme- mbeturina me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet

- dhe makineritë;
- c) Mbeturina të parrezikshme, të cilat nuk paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin;
 - d) Mbeturina të amvisërisë;
 - e) Mbeturina të veçanta nga mbetjet animale;
 - f) Mbeturina të rrezikshme.

Neni 7

SISTEMI I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE KOMUNALE

1. Mbeturinat komunale duhet të mblidhen, grumbullohen, trajtohen dhe menaxhohen në përputhje me dizpozitat e Ligjit për Mbeturina dhe me këtë rregullore.
2. Grumbullimi, transporti dhe deponimi i mbeturinave bëhet nga operatori i licencuar për menaxhimin e mbeturinave. Mbeturinat grumbullohen nga amvisëritë, institucionet, bizneset, hotelet, restorantet dhe hapësirat publike.
3. Komuna, përmes komisionit përkatës, bën përzgjedhjen dhe caktimin e vendeve dhe pikave grumbulluese të mbeturinave, si dhe përcaktimin e hapësirave për ndërtimin e qendrave të mëdha grumbulluese. Pikat grumbulluese caktohen sipas planit për menaxhimin e mbeturinave.
4. Menaxhimi i mirë i mbeturinave nënkupton mbulueshmëri të shërbimit në tërë territorin e komunës, si dhe ofrimin e shërbimit të rregullt, cilësor dhe efikas.
5. Ngritja e vetëdijësimit publik ka për objektiv rritjen e vetëdijes shoqërore për menaxhimin e mbeturinave, përmes punës me komunitetin, rininë, nxënësit dhe të gjitha palët e interesit, duke rritur kënaqshmerinë e qytetarëve.
 - a. Të gjitha institucionet edukativo-arsimore që funksionojnë në territorin e komunës duhet të edukojnë nxënësit dhe studentët në përputhje me rregullat dhe ligjet përkatëse të trajtimit të mbeturinave.

Neni 8

KATEGORIZIMI I GJENERUESVE TË MBETURINAVE

Gjeneruesit e mbeturinave kategorizohen si më poshtë:

1. Konsumatorët e amvisërive:
 - i. Shërbimi derë me derë;
 - ii. Shërbimi përmes kontejnerëve të përbashkët publikë.
2. Konsumatorët komercialë/ industrialë:
 - i. Dyqanet e vogla zejtare dhe shërbyese;
 - ii. Subjekte të mesme deri të mëdha komerciale me kosto të ulët të shërbimit;
 - iii. Subjekte të mesme deri të mëdha komerciale me kosto të lartë të shërbimit.
3. Institucionet:
 - i. Konsumatorët e vegjël institucionalë;
 - ii. Konsumatorët e mesëm dhe të mëdhenj institucionalë;
 - iii. Konsumatorët e mëdhenj institucionalë, të shërbyer me kontratë.

Detajizimi i mëtejshëm i këtyre kategorive gjendet në Shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 9

TË DREJTAT E GJENERUESVE TË MBETURINAVE

1. Të gjithë gjeneruesit që krijojnë mbeturina kanë të drejtë të kenë qasje në shërbimet publike për hedhjen e mbeturinave.
2. Të gjithë gjeneruesit e mbeturinave kanë të drejtë ankese ndaj shërbimit të ofruar, në organet relevante në kuadër të komunës ose te kompanitë përgjegjëse shërbyese për bartjen e mbeturinave.

Neni 10

OBLIGIMET E GJENERUESVE TË MBETURINAVE

- 10.1 Gjeneruesit e mbeturinave obligohen të paguajnë për shërbimin e ofruar në bazë të taksës/tarifës së miratuar nga Komuna, sipas parimit “NDOTËSI PAGUAN”.
- 10.2 Të gjithë gjeneruesit e mbeturinave janë të obliguar të regjistrohen në listat e shërbimit të konsumatorëve për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave.
- 10.3 Gjeneruesit e mbeturinave duhet të respektojnë orarin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, të përcaktuara nga komuna/kompania shërbyese.
- 10.4 Gjeneruesit e mbeturinave duhet t’i mundësojnë operatorit qasje në vendin e dorëzimit të mbeturinave.
- 10.5 Çdo gjenerues me banim individual/rezidencial obligohet që hedhjen e mbeturinave ta bëjë përmes shportave/kontejnerëve për grumbullimin e mbeturinave.
- 10.6 Gjeneruesit e mbeturinave obligohen:
 - a. Amvisëritë që shërbehen derë më derë duhet t’i ndajnë dhe t’i vendosin mbeturinat sipas sistemit të përcaktuar nga Komuna;
 - b. Në banimet kolektive, ku shërbimi bëhet në pika grumbulluese me kontejnerë, mbeturinat duhet të ndajnë dhe të vendosen sipas sistemit të përcaktuar nga Komuna.
- 10.7 Çdo biznes obligohet të posedojë shporta/kontejnerë për grumbullimin e mbeturinave që i gjeneron.
- 10.8 Gjeneruesit e mbeturinave të veçanta, si spitalet, ambulancat dhe objektet e tjera për shërbime mjekësore, duhet të përdorin sistem të ndarë të kontejnerëve, për ndarjen e mbeturinave medicinale dhe mbeturinat tjera.
- 10.9 Gjeneruesit e mbeturinave obligohen që mbeturinat e tyre t’i hedhin në vendet e caktuara nga Komuna për mbledhjen e mbeturinave, ndërsa mbeturinat e rrezikshme t’i ndajnë dhe t’i dorëzojnë në pikat mbledhëse përkatëse.
- 10.10 Çdo gjenerues obligohet që t’i largojë mbeturinat e krijuara gjatë procesit të ndërtimit, meremetimit apo demolimit të objekteve nga hapësirat publike.
- 10.11 Çdo gjenerues i mbeturinave duhet të respektoj rregullat e shkarkimit të përcaktuar sipas planit të menaxhimit të mbeturinave.
- 10.12 Çdo gjenerues duhet të bëjë përpjekje për zvogëlimin e sasisë së mbeturinave (përmes

- kompostimit shtëpiak dhe formave të tjera).
- 10.13 Ndërmarrjet prodhuese që gjenerojnë mbeturina obligohen që Komunës së Prizrenit t'ia dorëzojnë planin e menaxhimit të mbeturinave, të cilat i gjenerojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
- 10.14 Çdo gjenerues obligohet të paraqesë ndryshimin e të dhënave (si p.sh. shitja e pronës, trashëgimia dhe dokumentet e tjera përkatëse të përditësuara).
- 10.15 Gjeneruesit e mbeturinave duhet të regjistrohen në regjistrin e shërbimeve të konsumatorëve për mbeturina.
- 10.16** Shërbimet e veçanta, (largimi i mbeturinave të vëllimshme dhe mbeturinave të tjera që nuk largohen gjatë shërbimit të rregullt) bëhen me pagesë, përveç rasteve të përcaktuara në këtë rregullore.
- 10.17 Bizneset të cilat ushtrojnë veprimtari të ndryshme obligohen të mbajnë të pastër hapësirën para objektit dhe përreth tij.
- 10.18 Bizneset që gjenerojnë paketime kartoni obligohen që, përveç kontejnerit për mbeturina tjera, të posedojnë edhe kontejner të veçantë për ndarjen e paketimeve, i cili duhet të jetë i vendosur afër lokalit dhe duhet të jetë me rrjetë me hapësirë të dukshme. Bizneset të cilat obligohen të posedojnë kontejner të veçantë janë;
- a) Marketet;
 - b) Pemëshitësit;
 - c) Depot;
 - d) Dyqanet me shumicë;
 - e) Dyqanet me pakicë të cilët gjenerojnë shumë paketime;
 - f) Qendrat tregtare;
 - g) Dyqanet e veshmbathjeve apo produktet tjera të ngjashme që gjenerojnë shumë paketime.
- 10.19 Dyqanet me teknikë të bardhë dhe produkte teknologjike.
- 10.20 Bizneset që gjenerojnë vajra si mbeturinë obligohen të posedojnë kontejnerë të veçantë për ndarjen e tyre, si:
- a) Restorantet;
 - b) Garazhet/autoserviset për rregullimin e automjeteve apo mjetet tjera motorike
- 10.21 Bizneset, që gjenerojnë mbetje nga djegia(hi) obligohen të posedojnë kontejnerë të veçantë, si:
- a) Furrat e bukës me dru ose thëngjill;
 - b) Qebaptoret, të cilët përdorin zgarë me dru dhe thëngjill.
 - c) Restorante të cilat shfrytëzojnë furra/ skara me dru ose thëngjill;
 - d) Biznese të tjera të ngjashme të cilat gjenerojnë këtë lloj të mbeturinave.
- 10.22 Bizneset që gjenerojnë mbeturina të kompostueshme obligohen të posedojnë kontejner të veçantë, si;
- a) Marketet;
 - b) Pemëshitësit;
 - c) Tregjet.
- 10.23 Bizneset që gjenerojnë goma si mbeturinë obligohen të posedojnë kontejnerë të veçantë, si:
- a) Vullkanizerët;

- b) Bizneset të cilat bëjnë përpunimin apo shitjen e gomave;
 - c) Mekanikët.
- 10.24 Bizneset që gjenerojnë mbetje shtazore obligohen të posedojnë kontejnerë të veçantë, si:
- a) Mishtoret;
 - b) Thertoret;
 - c) Fabrikat për përpunimin e mishit dhe të ngjashme.
- 10.25 Çdo gjenerues duhet të bashkëpunojë me autoritetet publike dhe kompanitë përgjegjëse për ruajtjen e një mjedisi të pastër.
- 10.26 Çdo gjenerues duhet të respektojë rregullat e përcaktuara në Planin për Menaxhimin e Mbeturinave.
- 10.27 Çdo gjenerues duhet të respektojë obligohet që të largojë mbeturinat të cilat krijohen gjatë procesit të ndërtimit, meremetimit apo demolimit të objekteve apo hapësirat ose vendet publike.
- 10.28 Çdo gjenerues i mbeturinave nga ndërtimi obligohet të njoftojë njësinë për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Prizrenit për aktivitetet e demolimit apo meremetimit.

Neni 11 REGJISTRIMET E GJENERUESVE

1. Kompania shërbyese për grumbullimin, transportin dhe deponimin e mbeturinave duhet të ketë listën e plotë dhe të përditësuar të amvisërive, bizneseve dhe institucioneve në Komunën e Prizrenit, të cilat marrin shërbim të rregullt në kuadër të programit për menaxhimin e mbeturinave.
2. Gjeneruesit që nuk janë në listën e kompanisë shërbyese janë të obliguar të regjistrohen.
3. Kategorizimi për ngarkesën e faturës nënkupton:
 - a. Kategoria e parë: **amvisëritë rezidente** (vendbanim i përhershëm);
 - b. Kategoria e dytë: **amvisëritë jo-rezidente** (me vendbanim të përkohshëm, që jetojnë jashtë territorit të Komunës së Prizrenit, të dëshmuar me kartelën vjetore të shpenzimeve të energjisë elektrike);
 - c. Kategoria e tretë: **amvisëritë e tjera** që nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme.

Neni 12 TAKSA PËR MBETURINA

1. Faturimi i taksës për mbeturina për amvisëri apo njësi banimi bëhet në baza mujore nga kompania publike K.R.M “Ekoregjioni” SH.A. Fatura i dorëzohet gjeneruesit të mbeturinave përmes inkasantëve, më se largu deri në ditën e dhjetë (10) të muajit pasues, ndërsa pagesa kryhet nga gjeneruesi të kompania “Ekoregjioni” SH.A – Prizren.
2. Komuna i cakton taksat për mbeturina, varësisht nga lloji i tyre.
3. Gjeneruesi i mbeturinave obligohet të paguajë faturën e taksës për mbeturina.
